

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5967
30, 31 dhjetor 2019 dhe
1, 2 e 3 janar 2020
çmimi 1 €

FLET PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHOQIPËRISË, ILIR META

Shqipëria dhe Kosova
duhet ta forcojnë
bashkëpunimin dhe t'i
rrezojnë barrierat



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NGA TË PRITURA NË TË PAPRITURA

Në numrin ekskluziv dhe festiv të gazetës "Epoka e re" mund të lexoni intervista me drejtues të institucioneve të shtetit, me liderë të partive, me përfaqësues të institucioneve të sigurisë (të Policisë dhe të FSK-së), pastaj shkrime nga ekonomia, kultura, muzika dhe sporti

SHKRUANJË:

Jakup KRASNIQI
Blerim REKA
Behxhet SHALA
Edita TAHIRI
Bedri ISLAMI
Milazim KRASNIQI
Ibrahim GASHI
Belul BEQAJ
Lisen BASHKURTI
Valon MURATI
Sadik Rr. KRASNIQI
Adri NURELLARI
Ardian SYLA etj...

Po në këtë numër mund të lexoni për ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur në Kosovë gjatë vitit 2019 dhe në botë

Për numrin festiv të gazetës "Epoka e re" ka folur edhe Bernard Challandes, trajner i Përfaqësueses së Kosovës në futboll



"EPOKA E RE" TË
GJITHË QYTETARËVE
UA URON VITIN E RI
2020!

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Një muaj nga tërmeti i 26 tetorit, Viti i Ri e gjen Shqipërinë ndryshe

Dy ditë para 107-vjetorit të Ditës së Pavarësisë, Shqipëria është goditur nga një tërmet i fuqishëm i cili ka lënë të vdekur 51 persona dhe shumë të tjerë të plagosur. Pas këtij tërmeti Shqipërisë i kanë dhënë ndihmë vendet mike dhe vendet fqinje, edhe Kosova, e cila është solidarizuar si asnjëherë më parë me vëllezërit dhe motrat nga shteti shqiptar. Kosova, përpos me ekipet e kërkim-shpëtimit, i ka dalë në ndihmë Shqipërisë edhe me mjete financiare, me ushqim, me veshmbathje dhe me strehim



PRISHTINË, DHJETOR/JANAR (ER) - Më 26 dhjetor është bërë një muaj nga tërmeti tragjik i 26 nëntorit i cili ka tronditur Shqipërinë. Mëngjesin e të martës së 26 nëntorit, në orën 03:54 minuta, Shqipëria është lëkundur në mënyrë të tmerrshme nga një tërmet me magnitudë 6.4 të shkallës rihter. Tërmeti ka zgjatur mbi 30 sekonda, duke tronditur Durrësin, Thumanën e Tiranën, tri zonat më të goditura, por është ndier në të gjithë Shqipërinë, por edhe në Kosovë. Në Durrës dhe Thumanë shumë ndërtesa janë kthyer në gërmadha, ndërsa 51 qytetarë janë nxjerrë prej aty të pajetë. Në mesin e të vdekurve nga tërmeti janë edhe vëllezërit Isa e Shemsedin Abazi nga Livoçi i Epërm i Gjilanit, të cilët kishin shkuar për të punuar në Shqipëri. Ekipet e kërkimshpëtimit nga Kosova, Greqia dhe vendet e tjera të rajonit dhe të Bashkimit Evropian janë sensibilizuar menjëherë, duke zbarkuar në Shqipëri, duke gërmuar nën rrënoja për shpëtim jetësh, prej ku kanë arritur të nxirrin të gjallë 45 persona.

Ky ishte tërmeti më i fuqishëm i dekadave të fundit në Shqipëri dhe që la pas shumë viktima e shkatërrim. Tashmë, një muaj pas tërmetit, thuhet se është bërë bilanci i dëmeve të shkaktuara, njerëzit janë akomoduar nëpër hotele, banesa sociale dhe çadra dimërore, ndërsa është duke vazhduar puna për mbledhjen e fondeve për nisjen e procesit të rindërtimit.

Shumë vende kanë ofruar ndihmën e tyre për rindërtimin dhe, siç ka deklaruar kryeministri Edi Rama, pritet të nisë së shpejti. Ky Vit i Ri e ka gjetur Shqipërinë ndryshe. Edhe atmosfera festive nuk është e njëjtë. Dritat dhe zbukurimet nuk kanë munguar, kryesisht në kryeqytetin e Shqipërisë, si mënyrë për ta rikthyer shpresën dhe optimizmin.

Kosova u solidarizua me Shqipërinë

Me të kuptuar se epiqendra e këtij tërmeti ka qenë në Shqipëri, institucionet e Kosovës kanë dhënë urdhër për nisjen e menjëhershme të njesisë së

kërkimshpëtimit të Gardës Kombëtare të Kosovës për në zonat e prekura nga tërmeti. Gjithashtu, Shqipërisë i kanë dalë në ndihmë edhe njesiset e Policisë së Kosovës, zjarrfikësve dhe të KEK-ut. Përpos kësaj, Qeveria e Kosovës ka ndarë 500 mijë euro ndihmë për Republikën e Shqipërisë. Ndërsa lidhshipi politik i Kosovës u ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjarëve të viktimave, madje shumica prej tyre kanë vizituar vendet të cilat janë prekur nga tërmeti. Madje presidenti Hashim Thaçi kishte shpallur një ditë zie në nderim të viktimave të tërmetit. Pas këtij tërmeti shkatërrues, përpos strehimit të vëllezërve dhe motrave nga Shqipëria, qytetarët e Kosovës kanë furnizuar qytetarët e prekur nga tërmeti me veshmbathje dhe

ushqim. Po ashtu, organizata të ndryshme dhe qytetarë kanë grumbulluar mjete financiare për ta ndihmuar Shqipërinë. Në këtë kontekst, ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, së bashku me familjen e tij kanë ndarë 1 milion euro për t'u dalë në ndihmë të prekurve nga tërmeti. Ndërsa biznesmeni nga Shqipëria, Samir Mane, ka dhuruar të premtën 1.2 milion euro për të dëmtuarit nga tërmeti, kurse biznesmeni tjetër shqiptar, Shefqet Kastrati, ka vendosur të dhurojë 1.5 milion euro. Në anën tjetër, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama kanë dekoruar me medalje ekipet nga Kosova, të cilat kanë qenë pjesë e operacionit të kërkim-shpëtimit.

ShBA-ja dhe Gjermania i ofruan mbështetje Shqipërisë

Qeveria e Shteteve të Bashkuara nëpërmjet USAID-it ka mbështetur Shqipërinë pas tërmetit. "Me financim të USAID-it, Kryqi i Kuq po shpërndan artikuj jetikë

humanitarë, si batanije dhe paketa higjienike, në vendet e prekura më shumë. Zyra për Ndihmë të Jashtme në raste fatkeqësish e USAID-it ka sjellë edhe një ekspert fatkeqësish natyrorë në Shqipëri, për të ndihmuar në vlerësimin e dëmeve dhe identifikimin e nevojave prioritare për ndihmë humanitare", ka njoftuar Ambasada e ShBA-së në Tiranë. Ndërsa Gjermania ka ndarë 4 milionë euro për rimëkëmbjen e Shqipërisë pas tërmetit.

Erdogani premtoi ndërtimin e 500 banesave për të prekurit nga tërmeti

Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, ka premtuar se do t'i ndërtojë 500 banesa për banorët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri. Pas këtij premtimi, kryeministri Edi Rama ka vizituar Turqinë, ku për t'i dalë në ndihmë shtetit shqiptar, Erdogan kishte organizuar një konferencë të donatorëve. Një konferencë e donatorëve është organizuar edhe në Itali.

Gëzuar Vitin e Ri 2020!

Stafi i gazetës "Epoka e re" të gjithë shqiptarëve anëmbanë botës ua uron Vitin e Ri 2020! Ju urojmë shëndet, gëzim e hare, paqe, shpresë e mirëqenie, dashurie e mirësi për njëri-tjetrin! Gëzuar edhe për shumë mote!



Flet presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

Shqipëria dhe Kosova duhet ta forcojnë bashkëpunimin dhe t'i rrëzojnë barrierat



Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se Shqipëria dhe Kosova çdoherë kanë qenë dhe do të mbeten të parat në krah të njëra-tjetrës. Në intervistën dhënë për numrin festiv të gazetës "Epoka e re", ai ka theksuar se Shqipëria dhe Kosova duhet t'i plotësojnë të gjitha boshllëqet apo mangësitë që vijnë për shkak të karakteristikave të ndryshme të potencialeve apo të burimeve të zhvillimit ekonomik. "Shqipëria dhe Kosova në të gjitha fushat duhet të forcojnë, pa më të voglin hezitim, bashkëpunimin dhe t'i rrëzojnë të gjitha barrierat administrative dhe burokratike", ka thënë Meta. Për vitin 2020 ai ka uruar për një Shqipëri me negociata të hapura me Bashkimin Evropian dhe për një Kosovë pa regjim vizash me BE-në

konkretizimit të tyre. Shqipëria dhe Kosova në të gjitha fushat duhet të forcojnë pa më të voglin hezitim bashkëpunimin dhe t'i rrëzojnë të gjitha barrierat administrative dhe burokratike. Kjo është në interesin reciprok të të dy vendeve që kanë vetëm një aspiratë: bashkimin e tyre në Bashkimin Evropian.

"Epoka e re": Cili është qëndrimi juaj për nismën e ashtuquajtur "minishengen" dhe si i vlerësoni deklaratat e kryeministrit Rama për figurat kryesore politike të Prishtinës?

Presidenti Meta: Çdo platformë rajonale bashkëpunimi, që është gjithëpërfshirëse dhe jopërfshirëse, që udhëhiqet nga partneriteti dhe jopaternalizmi, që sjell kohezion dhe jo konfuzion, e aq më tepër përçarje, dhe që ka vetëm për qëllim integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, është e mirëpritur. Ky duhet të jetë një parakusht për të promovuar dhe konsideruar iniciativë rajonale premtuese dhe të dobishme. Çdo iniciativë që provokon debate të panevojshme nuk e ndihmon bashkëpunimin tonë. Askush nuk ka pse keqpërdoret për ta defaktorizuar Kosovën. Prishtina ka udhëheqësit e saj të zgjedhur me votën e qytetarëve të saj. Shqipëria, për fat të keq, nuk ka se çfarë t'i mësojë Kosovës, as sa i përket shtetit ligjor, as sa iu përket zgjedhjeve e pluralizmit politik, apo qoftë sa i përket demokracisë. Shteti i Kosovës është jo vetëm tërësisht funksional, por edhe një shembull i demokracisë në rritje, në një rajon që ende vuan nga autoritarizmi dhe pamundësimi i zgjedhjeve tërësisht të lira.

"Epoka e re": Në Kosovë edhe disa muaj pas zgjedhjeve ende nuk janë formuar institucionet e reja? Cili është mesazhi juaj për dy fituesit e këtyre zgjedhjeve, LV-së dhe LDK-së?

Presidenti Meta: Si fitues të zgjedhjeve parlamentare uroj që Lëvizja Vetëvendosja dhe Lidhja Demokratike e Kosovës në partneritet dhe përgjegjshmëri të vendosin sa më parë për krijimin e institucioneve të reja qeverisëse. Kosova i ka të gjitha mundësitë të jetë një shembull i mirëqeverisjes në rajonin tonë.

"Epoka e re": Cili është urimi juaj për Shqipërinë dhe për Kosovën për vitin 2020?

Presidenti Meta: Uroj për një Shqipëri me negociata të hapura me Bashkimin Evropian dhe për një Kosovë pa regjim vizash me BE-në, shumë më pranë saj dhe NATO-s.

EPOKA E RE

Sadik ZEQRIRI

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se marrëdhëniet mes dy vendeve tona duhet të jenë më komplementare me njëra-tjetrën. Ai ka thënë se Shqipëria dhe Kosova duhet t'i plotësojnë të gjitha boshllëqet apo mangësitë që vijnë për shkak të karakteristikave të ndryshme të potencialeve apo të burimeve të zhvillimit ekonomik. "Ju e dini qëndrimin tim për taksën e Kalimashit. Kjo është një taksë mjaft e gabuar dhe dekurajuese, duke pasur parasysh se sa i rëndësishëm është për Shqipërinë dhe për Kosovën ky qarkullim pa pengesa midis qytetarëve tanë. Por edhe për tregtinë, po të kemi parasysh se sa e kushtueshme është, sidomos për t'i vënë në funksion të Kosovës edhe portet e Shqipërisë në të ardhmen", është shprehur presidenti Meta.

Ai ka theksuar se Shqipëria dhe Kosova në të gjitha fushat duhet ta forcojnë, pa më të voglin hezitim, bashkëpunimin dhe t'i rrëzojnë të gjitha barrierat administrative dhe burokratike. Për vitin 2020 ai ka uruar për një Shqipëri me negociata të hapura me Bashkimin Evropian dhe për

një Kosovë pa regjim vizash me BE-në. Meta në këtë intervistë ka folur edhe për tërmetin që goditi Shqipërinë dhe për formimin e institucioneve të reja të Kosovës.

"Epoka e re": Z. President, Shqipëria muajin e kaluar u godit nga një tërmet i fuqishëm, me pasoja tepër tragjike, me 51 humbje të jetëve të njerëzve, me mijëra banesa e prona të shkatërruara. Sa e ka marrë veten Shqipëria dhe shqiptarët pas kësaj fatkeqësie?

Presidenti Meta: Shqipëria nuk ishte goditur nga një tërmet kaq shkatërrues prej një kohe të gjatë. U bënë përpjekje të mëdha dhe u zgjua një solidaritet i jashtëzakonshëm. Pasojat e rënda që la pas tërmeti treguan dobësitë tona në përballimin e këtyre situatave emergjente dhe besoj kemi nxjerrë mësimet e duhura se si t'i përmirësojmë masat dhe reagimet në të ardhmen. Aktualisht jemi të përqendruar në sigurimin e strehimit dhe shërbimeve të tjera të domosdoshme për të gjithë njerëzit që kanë humbur shtëpitë e tyre. Në të njëjtën kohë, jemi duke llogaritur dëmet dhe nivelin e sigurisë së mijërave shtëpive dhe ndërtesave të dëmtuara. Besoj se shumë shpejt do të kemi një plan veprimi konkret për rindërtimin

dhe rikuperimin e të gjitha pasojave që la pas ky tërmet shkatërrimtar.

"Epoka e re": Është parë një solidarizim i paparë i institucioneve të Kosovës dhe qytetarëve të saj me këtë tragjedi që e goditi Shqipërinë. Çka do të thotë për shqiptarët kjo?

Presidenti Meta: Kosova ishte e para që reagoi menjëherë duke na ardhur në ndihmë. E kam shprehur dhe nuk kursehem ta përsëris falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për ndihmën dhe solidarizimin maksimal e të jashtëzakonshëm të institucioneve të saj, në veçanti të qytetarëve të Kosovës, në ato çaste dramatike për Shqipërinë. Tërmeti i 26 nëntorit tundi si asnjëherë më parë themelet e shumë ndërtesave në Shqipëri, por tregoi se themelet e solidaritetit mbarëshqiptar janë më të forta se kurrë. Zemrën bujare të Kosovës e dëshmuar veçanërisht edhe ata qytetarë të saj që, në pamundësi ekonomike, shprehën solidaritetin duke ndarë edhe varfërinë e tyre me banorët e prekur nga ky tërmet. Shqipëria dhe Kosova çdoherë kanë qenë dhe do të mbeten të parat në krah të njëra-tjetrës dhe ne kurrë nuk do ta harrojmë këtë solidaritet dhe këtë ndihmë të jashtëzakonshme.

"Epoka e re": A duhet të shërbejë ky rast për qeveritë e të dy vendeve që ta thellojnë bashkëpunimin dhe t'i largojnë ato barrierat që vështirësojnë lëvizjen e shqiptarëve? Dhe ku mendoni se Shqipëria dhe Kosova duhet ta forcojnë bashkëpunimin më shumë?

Presidenti Meta: Marrëdhëniet mes dy vendeve tona duhet të jenë më komplementare me njëra-tjetrën. Shqipëria dhe Kosova duhet t'i plotësojnë të gjitha boshllëqet apo mangësitë që vijnë për shkak të karakteristikave të ndryshme të potencialeve apo të burimeve të zhvillimit ekonomik. Në këtë drejtim duhet të krijojmë sa më shumë lehtësira. Ju e dini qëndrimin tim për taksën e Kalimashit. Kjo është një taksë mjaft e gabuar dhe dekurajuese, duke pasur parasysh se sa i rëndësishëm është për Shqipërinë dhe për Kosovën ky qarkullim pa pengesa midis qytetarëve tanë. Por edhe për tregtinë, po të kemi parasysh se sa e kushtueshme është sidomos për të vënë në funksion të Kosovës edhe portet e Shqipërisë në të ardhmen. Më vjen keq kur konstatoj se mes dy vendeve tona ka aq shumë marrëveshje bashkëpunimi në fusha të ndryshme por që, për fat të keq, janë ende shumë larg

Ngjarjet që e përcollën

Përgatiti: Faton DËRMAKU

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Republika e Kosovës në vitin 2019 është ballafaquar me sfida të shumta në rrafshin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Ftesat nga Gjykata Speciale për drejtuesit kryesorë të UÇK-së, dorëheqja e Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë disa prej ngjarjeve që e kanë karakterizuar Kosovën gjatë vitit 2019.

ARSIMI HYN NË GREVË PËR PAGA

14 janar - Të gjitha institucionet arsimore në Kosovë kanë hyrë në grevë të përgjithshme, me kërkesat për ngritje të pagave për 30 për qind. Kjo grevë, e cila ka vazhduar për tri javë, ishte ndërprerë pas arritjes së marrëveshjes që një pjesë e kërkesave të mesimdhënësve të përfshihet në Ligjin për paga.

NDËRRON JETË ZËVENDËSMINISTRI I DIASPORËS, ARIAN DACI

26 JANAR - Një ortek bore rënë në Brezovicë ia ka marrë jetën Arian Dacit, zëvendësministrit të Diasporës, djalit të ish-kryetarit të Akademisë së Shkencave, Nexhat Daci, i cili ka qenë duke shkruar me këtë datë. Ariani ka qenë i pasionuar pas skijimit.

SHKARKOHET MINISTRI NENAD RIKALLO

2 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka liruar nga detyra ministrin e Bujqësisë, Nenad Rikallos. Këtë vendim Haradinaj e ka marrë pasi PSD-ja në opozitë ia ka vënë qeverisë pesë kushte për t'u bërë pjesë e votimit të buxhetit të shtetit, ndër të cilat ka qenë edhe shkarkimi i Rikallos.

HARADINAJ SHKARKON MINISTRIN SERB, KISHTE FYER VIKTIMAT E MASAKRËS SË REÇAKUT

9 PRILL - Kryeministri Ramush Haradinaj ka shkarkuar ministrin e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ivan Teodosijević, pas fyerjeve të viktimave të masakrës së Reçakut. Për shkak të këtyre fyerjeve, më 5 dhjetor Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënua Teodosijevićin me dy vjet burgim. Dënimi i Teodosijevićit ka ngjallur reagime të shumta në Serbi. Po ashtu, Haradinaj më 25 mars e ka shkarkuar zëvendësministren serbe të Drejtësisë, Vesna Mikiq, për shkak të deklaratave kundër NATO-s.

KTHEHEN 110 SHTETAS TË KOSOVËS, 87 MBESIN ENDE NË SIRI

20 PRILL - Institucionet e Kosovës kanë kthyer 110 qytetarë të cilët kanë qenë në zonat e konfliktit në Siri. Drejtuesit e institucioneve të rendit dhe të drejtësisë kanë bërë me dije se prej 110 të kthyerve, prej tyre janë katër luftëtarë, 32 gra dhe 74 fëmijë. Ata kanë thënë se edhe 87 qytetarë nga Kosova gjenden në Siri.

MBAHET SAMITI I BERLINIT, PJESE E TIJ THAÇI DHE HARADINAJ

30 PRILL - Në Gjermani është mbajtur Samiti i Berlinit, në të cilin kanë marrë pjesë presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Nikoqirë të këtij samiti kanë qenë kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Në këtë samit, në të cilin ka marrë pjesë edhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq, është kërkuar heqja e taksës, por Haradinaj nuk kishte pranuar. Pas Samitit të Berlinit ishte paraparë që të mbahet ai i Parisit, por që ka dështuar.

MBAHEN ZGJEDHJET PËR KRYETARË NË KATËR KOMUNAT VERI-ORE

9 MAJ - Në katër komunat me shumicë serbe (Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan) janë mbajtur zgjedhjet e jashtëzakonshme, pasi kryetarët e këtyre komunave kishin dhënë dorëheqje për shkak të taksës 100 për qind. Garën në komunat e veriut e kanë fituar ata të cilët kanë dhënë dorëheqje.

KUVENDI MIRATON REZOLUTËN QË E FAJËSON SERBINË PËR GJENOCID

16 MAJ - Me 79 vota për, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar rezolutën për "gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë". Për



hartimin e kësaj rezolute kanë punuar përfaqësuesit e të gjitha partive politike, përveç grupit të Listës Serbe.

HARADINAJ TAKOHET ME KANCELAREN MERKEL

6 qershor - Kryeministri Ramush Haradinaj është pritur në takim nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel. Haradinaj pas takimit kishte thënë se Kosova është e gatshme për një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht detyruese për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, që përfshinë njohjen e ndërsjellë në kufijtë ekzistues.

KOSOVA SHËNON 20-VJETORIN E ÇLIRIMIT, MARRIN PJESE CLINTONI, ALBRIGHTI DHE CLARKU

12 qershor - Republika e Kosovës ka shënuar 20-vjetorin e çlirimit. Në këtë ngjarje historike kanë marrë pjesë personalitete të



VETËVENDOSJA FITON ZGJEDHJET, PDK-JA OPOZITËN

6 TETOR - Republika e Kosovës ka mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në këto zgjedhje fituese ka dalë Lëvizja Vetëvendosje, e pasuar nga LDK-ja dhe PDK-ja. LV-ja ka fituar 26.27 për qind të votave, apo 29 deputetë, LDK-ja 24.54 për qind apo 28 deputetë, PDK-ja 21.23 për qind apo 24 deputetë, koalicioni AAK-PSD

11.51 apo 13 deputetë, Lista Serbe 6.40 për qind apo 10 deputetë, koalicioni Nisma-AKR-PD 5.002 për qind apo 6 deputetë dhe minoritetet e tjera joserbe 10 deputetë. Befasia e këtyre zgjedhjeve ka qenë PSD-ja, e cila nuk ka arritur të sigurojë asnjë ulësë në Kuvendin e Kosovës, edhe pse ka garuar në një listë zgjedhore me AAK-në.

ndryshme nga mbarë bota. Mysafirë specialë të kësaj ngjarje kanë qenë tre protagonistët e çlirimit të Kosovës: ish-presidenti amerikan Bill Clinton, ish-sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright dhe ish-komandanti suprem i forcave të NATO-s, Wesley Clark. Me këtë rast, në nderim të kontributit të sekretares Albright, në Prishtinë është zbuluar busti i saj.

KUSHTETUESJA E SHPALLË JOKUSHTETUES EKIPIN NEGOCIATOR

27 QERSHOR - Ekipi negociator i Kosovës për bisedime me Serbinë është shpallur jokushtetues nga Gjykata Kushtetuese, pas kërkesës për interpretim të Ligjit për dialogun nga LDK-ja dhe LV-ja. Pas vendimit të Kushtetueses, ky delegacion ka pushuar aktivitetin e vet, pjesë e të cilit nuk kanë qenë vetëm LDK-ja dhe LV-ja. Bashkëkryesues të ekipit negociator kanë qenë Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj.

SHQIPËRIA MBAN ZGJEDHJET LOKALE PA OPOZITËN

30 QERSHOR - Në Shqipëri janë mbajtur zgjedhjet lokale edhe pse presidenti Ilir Meta i kishte shtyrë për 13 tetor. Në 61 bashki qytetarët kanë votuar për kryetarët e tyre, megjithëse këto zgjedhje janë mbajtur pa partitë kryesore opozitare në vend. Në 31 prej 61 bashkive, Partia Socialiste ka garuar pa asnjë kundërkandidat, ndërsa në 30 të tjerat kanë garuar kandidatë të pavarur apo kandidatë të partive të vogla.

PËRURORHET NDËRTESA E AMBASADËS AMERIKANE NË PRISHTINË

4 KORRIK - Në Prishtinë është përuaruar ndërtesa e Ambasadës së ShBA-së që ka shënuar njëkohësisht edhe manifestimin qendror në Kosovë me rastin e 243-vjetorit të pavarësisë së Amerikës. Në ceremoninë e përuimit të kësaj ndërtese ka marrë pjesë kongre-



Kosovën në vitin 2019



sisti Eliot Engel dhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës.

TRI UNIVERSITETEVE PUBLIKE U TËRHIQEN AKREDITIMET

16 KORRIK - Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka tërhequr akreditimin për tri universitete publike, duke nxitur reagimin e këtyre institucioneve, por edhe të Qeverisë së Kosovës. Ky këshill ua ka hequr akreditimin për vitin akademik 2019/2020 Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, "Isa Boletinit" në Mitrovicë dhe "Haxhi Zekës" në Pejë.

HARADINAJ JEP DORËHEQJE NGA POZITA E KRYEMINISTRIT, SHKAK FTESA NGA SPECIALJA

19 KORRIK - Ramush Haradinaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit të Kosovës. Dorëheqja e tij ka ardhur pas ftesës që ka pranuar nga Gjykata Speciale për intervistim në lidhje me veprimtarinë e tij në UÇK. Ai ka thënë se këtë vendim e ka marrë duke mos dashur ta "poshtërojë" Kosovën, duke u intervistuar në detyrën e kryeministrit. Intervistimi i tij në Hagë ka ndodhur më 24 korrik.

ISA MUSTAFA RIMERR "TIMONIN" E LDK-SË

3 GUSHT - Isa Mustafa është rizgjedhur kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke marrë shumicën e votave nga 354 delegatë të kësaj partie. Votimi i Mustafës është bërë me

votim të hapur, pasi Fatmir Sejdiu nuk kishte arritur t'i fitonte votat e mjaftueshme për të hyrë në procedurën e votimit.

SHPËRNDAHET KUVENDI I KOSOVËS

22 GUSHT - Me 89 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për shpërndarjen e legjislaturës së gjashtë, duke e çuar vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Vendimi i deputetëve për shpërndarjen e Kuvendit ka pasuar me dorëheqjen e Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit, pas ftesës nga Gjykata Speciale.

PRESIDENTI VENDOS QË MË 6 TETOR TË MBAHEN ZGJEDHJET PARLAMENTARE

26 GUSHT - Pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga posti i kryeministrit dhe pas konsultimit me partitë politike, presidenti Hashim Thaçi ka marrë vendim që zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbahen më 6 tetor. Këtë vendim Thaçi e ka marrë duke u bazuar në kompetencat ligjore dhe kushtetuese.

THAÇI TAKOHET ME TRUMPIN, MACRONIN DHE PERANDORIN E JAPONISË

25 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në Nju Jork është takuar me presidentin e ShBA-së, Donald Trump dhe Zonjën e Parë, Melania Trump. Po ashtu, Thaçi më 11 shtator është takuar me presidentin e Francës, Emmanuel Macron. Gjatë vitit 2019, konkretisht më 22 tetor, Thaçi ka marrë pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të perandorit Naruhito në Japoni. Në Japoni,

Thaçi është takuar edhe me kryeministrin Shinzo Abe.

GRENELLI, I DËRGUAR I TRUMPIT PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI

4 TETOR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka zgjedhur ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, të dërguar të administratës së vet në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Grenelli do t'i udhëheqë përpjekjet e ShBA-s, për t'u ndihmuar Kosovës dhe Serbisë për arritjen e një marrëveshjeje zyrtare të paqes, e cila do të mund të rezultojë me njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë. Grenelli, pas marrjes së kësaj pozite, ka vizituar Kosovën dhe Serbinë. Përpos Grenellit, edhe Mathew Palmer do të merret me dialogun Kosovë - Serbi. Ai tashmë është duke ushtruar funksionin e përfaqësuesit të posaçëm amerikan për Ballkanin.

KURTI, OSMANI, VESELI DHE HARADINAJ, MË TË VOTUARIT NË ZGJEDHJET E 6 TETORIT

6 TETOR - Lideri i LV-së dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti, ka qenë lideri më i votuar në zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka arritur t'i marrë 183 952 vota. Pas Kurtit, kandidatja e LDK-së për kryeministër, Vjosa Osmani, ka arritur të marrë 176 016 vota, i pasuar nga lideri i PDK-së dhe kandidati për kryeministër, Kadri Veseli, me 145 881 vota. Ndërsa lideri i AAK-së dhe kandidati për kryeministër nga koalicioni AAK-PSD, Ramush Haradinaj, ka marrë 76 163 vota.

KOSOVA TËRHEQ KËRKESËN PËR ANËTARËSIM NË INTERPOL

15 TETOR - Kryeministri në detyrë,

Ramush Haradinaj, ka kërkuar tërheqjen e kërkesës së Kosovës për anëtarësim në Interpol dhe shtyrjen e kësaj kërkesë për vitin e ardhshëm. Kjo kërkesë është bërë pas rrethanave të krijuara në vend pas dorëheqjes së Haradinajt. Kosova kishte aplikuar për pranim në Interpol në janar të vitit 2019 dhe ishte pranuar nga Komiteti Ekzekutiv i Interpolit.

EKSPERTËT ZVICERANË PUBLIKOJNË RAPORTIN PËR ASTRIT DEHARIN

24 TETOR - Prokuroria Themelore në Prizren ka pranuar ekspertizën nga Zvicra për vdekjen e aktivistit Astrit Dehari, në të cilën thuhet se "një hetim i ri është i nevojshëm për t'i qartësuar rrethanat e vdekjes së Astrit Deharit".

MAXHUNI LARGOHET NGA AKI-JA, VJEN GASHI

6 NENTOR - Shpend Maxhuni ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit të AKI-së. Për këtë dorëheqje, Maxhuni e ka informuar kryeministrin në detyrë, Ramush Haradinaj. Pas dorëheqjes së Maxhunit, Haradinaj dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, më 25 nëntor kanë emëruar Kreshnik Gashin drejtor të AKI-së dhe Burim Ramadanin inspektor të përgjithshëm në këtë agjenci.

VESELI DHE SHUMË EPRORË TË UÇK-SË FTOHEN NGA GJYKATA SPECIALE

7 NENTOR - Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka marrë ftesë nga Gjykata Speciale për intervistim, por nuk e ka bërë me dije se në çfarë cilësie. Intervistimi i tij ishte paraparë të mbahet më 4 dhjetor, por ishte shtyrë më 10 dhjetor. Ftesë nga Gjykata Speciale gjatë vitit 2019 kanë pranuar edhe eprorë të lartë të UÇK-së, duke përfshirë: Azem Sylën, Sokol Bashotën, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin, Bislim Zyrapin, Naim Malokun, Lulzim Kabashin, Smajl Latifin, Faton Mehmetajn, Isni Kilajn, Zafir Berishën etj.

KOSOVA, NDËR SHTETET E FUNDIT NË TESTIN PISA

3 DHJETOR - Janë publikuar rezultatet e testit PISA për vitin 2018. Në këto rezultate ka dalë se Kosova nuk ka shënuar përmirësim të madh. Tri vjet pas testimit të parë, PISA e ka radhitur Kosovën të katërtën nga fundi në listën mes 79 vendeve të botës.

AHMETI JEP DORËHEQJE, PSD-NË E DREJTON MOLLIAQAJ

15 DHJETOR - Shpend Ahmeti ka dhënë dorëheqje nga pozita e

kryetarit të Partisë Socialdemokrate (PSD) pas rezultetit zhgënjyes në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Pas dorëheqjes së Ahmetit, Dardan Molliqaj është zgjedhur kryetar i ri i PSD-së. Po ashtu, nga strukturat drejtuese të PSD-së janë larguar edhe Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Dardan Sejdiu, Shqipë Pantina etj.

SAMITET PËR MINISHENGENIN MBAHEN PA KOSOVËN

21 DHJETOR - Përfaqësues të lartë shtetërorë të katër vendeve ballkanike, nga Shqipëria, nga Mali i Zi, nga Maqedonia e Veriut dhe nga Serbia, gjatë vitit 2019 kanë mbajtur tre samite në lidhje me themelimin e të ashtuquajturit minishengenin ballkanik. Samiti i parë është mbajtur më 10 tetor në Novi Sad, i dyti më 9 nëntor në Ohër, i treti më 21 dhjetor në Tiranë. Në këta tre samite nuk ka marrë pjesë Kosova për shkak të qëndrimeve të Serbisë dhe të presidentit serb Aleksandër Vuçiq në raport me masakrën e Reçakut. Këta samite, sidomos ai i Tiranës, ka ngjallur reagime të shumta, sidomos në Kosovë. Reagimet kanë ardhur si kritika ndaj kryeministrit Edi Rama.

ALI AHMETI RIZGJEDHET KRYETAR I BDI-SË

21 DHJETOR - Kongresi i Katërt Zgjedhor i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) ka rizgjedhur Ali Ahmetin në krye të kësaj partie edhe për katër vjetet e ardhshme. Në punimet e këtij kongresi kanë marrë pjesë mbi 800 delegatë. Përpos Ahmetit, delegatët e këtij kongresi kanë zgjedhur edhe anëtarët e organeve të reja partiake. Të pranishëm në këtë kongres kanë qenë përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare dhe me gjerë.

KONSTITUOHET KUVENDI I KOSOVËS, KONJUFCA KRYEPARLAMENTAR

26 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës, i dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit, është konstituuar. Në seancën konstituive është bërë betimi i deputetëve, është zgjedhur kryetari i Kuvendit dhe nënkryetarët. Glauk Konjufca është zgjedhur kryetar i Kuvendit, ndërsa Arbërie Nagavci, Kujtim Shala, Memli Krasniqi, Sllavko Simiq dhe Fikrim Damka janë zgjedhur nënkryetarë të këtij institucioni. Kuvendi është konstituuar pa një marrëveshje në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së, të cilat, për ta formuar qeverinë, janë duke negociuar që nga 6 tetori, kur janë mbajtur zgjedhjet parlamentare.



VESELI RIZGJEDHET KRYETAR I PDK-SË

7 MAJ - Kadri Veseli është rizgjedhur kryetar i PDK-së. Rizgjedhja e tij është bërë në Konventën e Shtatë të kësaj partie, e cila është mbajtur në

Prishtinë. Zgjedhja e kryetarit të PDK-së është bërë me votim të hapur nga rreth 700 delegatë, të cilët kanë marrë pjesë në këtë konventë.

Flet për "Epokën e re", Ramush Haradinaj

Askush s'mund t'i

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se shqiptarët asnjëherë nuk kanë qenë më të fuqishëm se tani. Në këtë intervistë dhënë për numrin festiv të gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Kosova dhe Shqipëria, si dy shtete në Ballkan, e bëjnë më të avancuar pozitën e popullit shqiptar në këtë pjesë të Evropës. Duke folur për përplasjet e fundit me kryeministrin shqiptar Edi Rama, ai ka thënë se pak ka rëndësi se çka ndodh me të dhe me Ramën. Sipas tij, ata janë të përkohshëm, ndërsa populli dhe atdheu janë të përhershëm. Haradinaj ka thënë se askush nuk mund t'i përçajë dhe t'i dobësojë shqiptarët



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR-
"Epoka e re": Z. Haradinaj, si po e përmbyll Kosova këtë vit?

Haradinaj: Nuk ka qenë vit i lehtë, ka qenë vit me plot sfida. Një nga sfidat ishte dorëheqja e qeverisë dhe shkuarja në zgjedhje, të cilat kanë përfunduar me sukses. Tani është me rëndësi ndërtimi i institucioneve. Ndërkohë, Kosova është më e konsoliduar sesa ka qenë ndonjëherë në historinë e vet. Zbatimi i rendit dhe ligjit po ndodh në të gjithë vendin, çështja e 'Trepçës' është zgjidhur, pavarësia energjetike është arritur, kemi filluar unifikimin e tregut me Shqipërinë në energji, ushtria jonë po merr rritje dhe prodhuesit e vendit po marrin frymë më lirshëm për shkak të taksës ndaj Serbisë. Pra, kanë arritur të konsolidohen dhe të jenë më të qëndrueshëm sesa kanë qenë në të kaluarën.

"Epoka e re": A keni menduar se këtë vit do ta përmbyllini me dorëheqje?

Haradinaj: Kur kam dhënë dorëheqje në fund të korrikut kam pritur se pas dy apo tre muajve nuk do të vijë më në këtë zyrë. Pra, kam pritur se menjëherë pas zgjedhjeve do të krijohen institucionet e vendit. Pas zgjedhjeve të

suksesshme kam pritur se procesi i konstituimit të institucioneve të ndodhë më shpejt.

"Epoka e re": Ka pasur deklarime nga njohësit e çështjeve kushtetuese, se pas dorëheqjes ju është dashur ta lëshoni zyrën e kryeministrit?

Haradinaj: Tani shihet se a kanë qenë në rregull ato pretendime. Imagjinojeni funksionimin e shtetit, funksionimin e të gjithë resorëve se sa të ndjeshëm janë. Ende nuk e ndien qytetari i Kosovës që s'ka qeveri të re. Pra, dobësimi i aspekteve qeverisëse do të ishte fatal për Kosovën në këtë kohë të tranzicionit. Do të ishte kthim prapa, sepse në mezi e kemi krijuar këtë gjendje.

"Epoka e re": Megjithatë, në mbledhjen e parë të qeverisë, pas dorëheqjes suaj, pati hezitime të merreshin vendime, duke pretenduar se ato mund të jenë kundër kushtetuese. Kurse tash është rikthyer qeveria dhe po mban mbledhje e po merren vendime. Pse ndodhi kjo?

Haradinaj: Hezitimi mund të ketë qenë edhe çështje e hidhërimit politik sepse unë dhashë dorëheqje duke e çuar vendin në zgjedhje, duke ndërprerë pushtetin për kolegët e mi në qeveri. Pra, ka pasur disa hidhërime, por nuk ka

hezitim të bazës kushtetuese apo ligjore për veprim. Një qeveri në dorëheqje ushtron detyra qeverisëse deri në ardhjen e qeverisë së re. Qeverisja nuk parashihet me vakum.

"Epoka e re": Për shkak të taksës ndaj Serbisë, Kosova gjatë këtij viti është përballur me një presion nga ndërkombëtarët. Madje jeni kritikuar për këtë, se po e izoloni Kosovën?

Haradinaj: Kosova ka qenë e izoluar, nuk mund ta izolosh më shumë sesa ka qenë. Qasja e përshtatshmërisë e ka lënë Kosovën si të paaftë. Kthimi te vetvetja ka rezultuar me një Kosovë që është më sovranë, që qeveriset vetë dhe që duhet për ta respektuar. Nuk është se taksë e ka izoluar Kosovën, taksë e ka kthyer në tavolinë Kosovën si palë të barabartë.

"Epoka e re": A ka ndikuar taksë në procesin e liberalizimit të vizave?

Haradinaj: Ne i kemi përmbushur të gjitha kushtet për liberalizim, tani kjo është çështje politike e zhvillimeve të brendshme të Evropës dhe nuk lidhet me taksën. Ne kriteret i kemi përmbushur. Vendet lidere të BE-së, si Gjermania, e kanë marrë iniciativën për të ecur përpara. Nuk ka ndodhur izolim për shkak të taksës, përkundrazi Kosova është

imponuar me këtë fuqi të veten të marrë vendime sovranë.

"Epoka e re": Kur mendoni se mund të ndodhë liberalizimi? Ju keni përmendur Krishtlindjet, ndërsa tash vitin tjetër?

Haradinaj: Nuk do të shkojë në pakufi kjo çështje. Mua më vjen keq prej qytetarëve që po na bëhet një e padrejtë e tillë nga Evropa. Nuk duhet të mbahen të izoluar dy milionë njerëz të Kosovës kur Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet. Këtë e ka konstatuar Komisioni i BE-së dhe për këtë ka votuar Parlamenti i BE-së, ndërsa tani është Këshilli i BE-së që duhet të vendosë. Nëse Këshilli i BE-së nuk e vendos në rend dite në mbledhjen e parë të vitit që vjen, atëherë vërtet janë duke u sjell keq me Kosovën dhe me qytetarët e saj. Nëse nuk hyjmë në agjendë në mbledhjen e parë të Këshillit të BE-së, që mbahet diku në fund të shkurtit apo në fillim marsit, atëherë dihet se po bëhet kjo me qëllim dhe dihet që është agjendë për të na mbajtur të izoluar. Për këtë duhet të na tregojnë pse po ndodh kjo.

"Epoka e re": Ka pasur shqetësime se liberalizimi mund të ndërlihet me procesin e dialogut me Serbinë. Mund të ndodhë kjo?

Haradinaj: Edhe liberalizimi i

vizave është kontratë Kosovë - BE. Ata i kanë vendosur kushtet, ne i kemi plotësuar ato, ndërsa atyre u ka mbetur marrja e vendimit në Këshill. Çdo temë e ka rëndësinë e vet, por liberalizimi është një kontratë në vete. Ata mund të arsyetohen në mënyra të ndryshme për të mos na dhënë liberalizimin, por është e pakuptimtë t'ua bëjnë këtë të padrejtë dy milionë evropianëve.

"Epoka e re": Përveç dhënies së datave për liberalizim të vizave, jeni kritikuar shumë edhe për shpenzime gjatë qeverisjes suaj, duke i prekur edhe rezervat shtetërore?

Haradinaj: Nuk po shpjegohet drejt se çka është buxheti në Kosovë. Buxheti implementohet, është një planifikim vjetor i parave të Kosovës që duhet për t'i dërguar diku. Pra, buxheti është kontratë njëvjeçare. Më 31 dhjetor të gjitha mjetet që nuk kanë hyrë në punë e nxjerrin humbës qytetarin, sepse ato mjete nuk kanë shkuar atje ku është dashur të shkojnë. Për shembull, nëse kryetarit të Prizrenit i teprojnë paratë, në Prizren e lavdërojnë, duke thënë se nuk i harxhoi paratë, kurse prizrenasit janë humbës, sepse ato para kanë qenë të dedikuara të shkojnë për ta. Apo një ministër që nuk i ka futur paratë në punë, ai resor është



përçajë shqiptarët



humbës. Këtu te ne të lavdërojnë, duke thënë se ky i ka ruajtur paratë, ndërsa kur i fusin në punë, thonë i harxhoi. Për këtë ne bëjmë alokime e rialokime dy-tri herë gjatë vitit. Pastaj rezerva është paraparë të hyjë në punë gjatë një viti. Nuk bartet në vitin tjetër. Nëse nuk e implementon rezervën është pazotësi, sepse edhe rezerva është menduar për diçka. E kuptoj dëshirën për ta kritikuar Qeverinë Haradinaj për shpenzime, sepse hera e parë është që po bëhet transparent çdo shpenzim. Pra, qytetarët e dinë për çdo cent se ku ka shkuar.

"Epoka e re": Gjatë këtij viti cili ka qenë momenti më i vështirë për ju si kryeministër i vendit?

Haradinaj: Ka pasur vështirësi. Unë kam paralajmëruar qysh në fillim të mandatit një kurs të ri politik. Moment i vështirë për mua ka qenë të ballafaqohem me BE-në në dhjetor të vitit 2017, në takimin e Këshillit të MSA-së me Mogherinin, për dialogun dhe tema të tjera. Kursi i saj për Kosovën ka qenë tepër gabim. Dialogu i saj ka qenë për ndarjen e Kosovës. Nga aty ka filluar një thyerje e madhe me të. Moment tjetër i vështirë ka qenë t'i shtysh njerëzit që të prodhojnë energji në Kosovë. Gjatë kësaj qeverie nuk është rritur asnjëherë çmimi i

energjisë, ju e dini se më herët kemi protestuar në shesh, sepse çdo tre muaj u rritke tarifa e energjisë. Pra, nuk ka qenë ky një moment i lehtë, sepse kam hyrë në luftë me rrjete të fuqishme të shitjes së energjisë të cilat nuk të falin aq lehtë.

"Epoka e re": A e keni pasur përkrahjen e duhur nga partnerët e koalicionit në këto vendime?

Haradinaj: Ne bashkë kemi rrugëtuar. Në momente të caktuara ka ndodhur njëfarë dobësimi i qëndrimeve të tyre. Duhet të dimë se lëkundjet në qëndrime janë të dëmshme sepse pastaj i japim shpresë palës tjetër se, nëse të dobëson, edhe të mund. Për këtë çështje jam mërziur me partnerët e mi në raste të caktuara, sepse nuk kanë qenë të qëndrueshëm. Në këto tema duhet me u matë para se me hy. Po ta hiqim taksën më dëm do t'i kishim bërë Kosovës sesa mos ta kishim vënë.

"Epoka e re": Çfarë raporte keni me presidentin e vendit, kryetarin e PDK-së dhe kryetarin e Nismës?

Haradinaj: Kemi një ftohje raportesh me presidentin sepse ju i dini ato diskutimet e hershme rreth mënyrës së dialogut dhe idesë për korrigjim të kufijve. Pra, kemi pasur probleme serioze në një kohë, sepse presidenti ka qenë

shumë aktiv në këto angazhime. Ndërsa, siç e dini, unë kam qenë në anën e kundërt. Megjithatë, kemi ruajtur komunikim institucional. E kemi rastin e tërmetit në Shqipëri, ku kemi funksionuar si institucione. Ka edhe raste të tjera që komunikojmë. Natyrisht që komunikoj edhe me z. Veseli, z. Limaj.

"Epoka e re": Me këto qëndrime rreth taksës, ia keni lehtësuar apo vështirësuar punën pasardhësit tuaj?

Haradinaj: Sot Kosova është tjetër vend. Kur kam qenë unë mandatar para dy vjetësh ka qenë problematike gjendja në vend, si rendi, ligji, siguria në veri dhe shumë probleme të tjera. Tash Albin Kurti e ka livadh, le të flasë çfarë të dojë, sepse Kosova është funksionale. Vonesat për krijimin e qeverisë së re nuk sjellin ndonjë problem në Kosovë. Natyrisht se është mirë që sa më shpejt ta bëjë qeverinë e re, por kështu nuk ka qenë kur e kam marrë unë mandatin. Kosova ka ndryshuar fort për dy vjet të qeverisjes sime.

"Epoka e re": Mendoni se ai do ta ketë më lehtë se ju?

Haradinaj: Ju po e shihni edhe vetë. A ka ndonjë shqetësim në Kosovë? Çdo gjë është funksionale në këtë vend, si në jug e veri, ashtu edhe në lindje e perëndim. Ai të dalë e të thotë çfarë të dojë publikisht. Merret me Sanxhakun, me Maqedoninë, me Tiranën, mos të flasim për të tjerat. Ka nge kryeministri i ardhshëm, i cili do të vijë dhe do të merret me shëndetësi, arsim dhe t'i ndalë harxhimet e paarsyeshme e ta çkapë shtetin qysh po thotë. Por, prapëseprapë Kosova po funksionon.

Tani Kosova është tjetër. Kjo është dëshmuar edhe në ditën e zgjedhjeve. Kjo teoria se po e çkapim shtetin, e shteti është aq me dinjitet në zgjedhje, nuk shkon. Ju e patë çfarë dinjiteti treguan institucionet ditën e zgjedhjeve. Nuk është lënduar vullneti i qytetarit, nuk ka asnjë raport që thotë se është lënduar vullneti i qytetarit prej pushtetit. Opozita është trajtuar me respekt gjatë gjithë kohës së qeverisjes time. Asnjë diskriminim apo ndëshkim nuk iu ka bërë opozitës në këtë mandat. Përkundrazi, e kemi respektuar gjatë gjithë mandatit. E kemi respektuar ditën e zgjedhjeve dhe e kemi respektuar rezultatin. Kjo është Kosova që e kemi krijuar bashkë. Kjo është meritë e pozitës dhe opozitës. Pra, është meritë edhe e pozitës e cila ka ditur të sillte asisoj që t'i japë hapësirë opozitës që të vijë deri te fitoja. Ka vende të tjera që nuk e lejojnë opozitën të vijë deri te fitorja. Ne i shohim këto

në të dyja anët e Kosovës. Këtu nuk e ka penguar dikush opozitën për të fituar, për t'u rritur dhe që të ndihet e lirë. Dua ta përmend rastin Dehari si ka ardhur kjo qeveri, unë dhe ministri Abelard Tahiri e kemi pranuar familjen Dehari, duke i thënë çfarë dëshiron. Kemi paguar paratë për ekspertizë jashtë vendit, aty ku ka dashur familja. Kjo qeveri ka qenë njerëzore dhe u ka kushtuar vëmendje temave me interes nacional.

"Epoka e re": Meqenëse po i përmendeni punët që i keni bërë, pse nuk morët vota më shumë?

Haradinaj: Kam prishur shumë plane dhe kam bërë shumë armiq gjatë dy vjetëve të qeverisjes sime. Kemi dalë kundër shumë erërave të fuqishme. Unë nuk jam shumica sot, por kam bërë punë për shumicën. Nuk kam qenë as në kohën e luftës për liri shumicë, por kemi bërë punë për shumicën. E vërtetë është ajo që thotë Surroi, se UÇK-ja nuk ka qenë shumicë. Por, si pakicë kam kryer mision në shërbim të shumicës. AAK-ja sot nuk është shumicë, por ka kryer punë në funksion të shumicës për qindra vjet. Jo çdoherë duke i takuar shumicës i kryen punët e shumicës. Ka shumë raste kur nuk je në shumicë por kryen punë për shumicën. Kjo i ka ndodhur Kosovës gjatë kësaj qeverie. Pra, nuk kam synuar ta përvetësoj shumicën, por t'i kryej disa punë që i mbesin këtij vendi. Asnjë resurs i Kosovës nuk është sot i kontestuar prej ndonjë vendi tjetër ose prej dikujt që pretendon se ka hise në Kosovë. Ushtria, energjia dhe taksa, këto janë punët që ne i kemi bërë.

"Epoka e re": Në këtë performancë jo të mirë të AAK-së në zgjedhje, a ka ndikuar dhe koalicioni me PSD-në?

Haradinaj: Ne kemi pasur vështirësi sepse, kuptohet, unë kam dalë kundër plot mekanizmave dhe institucioneve relevante për parime. Unë nuk e kam marrë me të mirë kategorinë e atyre që kanë predikuar se duhet të shkohet për të luftuar në Lindje. Unë nuk jam kundër fesë islame, ose kundër besimtarëve islamë. Unë kam dalë herët kundër talibanëve dhe e kam paguar çmimin atëherë dhe e paguaj edhe sot. Mirë që falë asaj vetëdije më pak djem e vajza iu kanë vrarë Kosovës në Siri. Mirëpo kur është ardhur momenti i vështirë, unë ata i kam sjell mbrapa në Kosovë. I vetmi vend në botë është Kosova që i ka kthyer mbrapa qytetarët e vet nga Siria. Pra, kam dalë kundër krejt zhvillimeve që kanë qenë kundër interesave të vendit dhe këto më kanë kushtuar.

"Epoka e re": Kosova dhe Shqipëria kohët e fundit nuk janë në një vijë për disa çështje. Çka po ndodh?

Haradinaj: Krejt shqiptarët, pavarësisht feve, krahinave, partive politike, jemi vëllezër e motra. Ne jemi një. Por, për interesa nacionale nuk kam qare pa u pozicionuar. Dhe kur pozicionohem nuk e bëj për inat të njërit apo për hatër të njërit, sepse për interes nacional janë vrarë Shkëlzeni, Luani dhe familja ime i ka kaluar ato që i ka përjetuar. Kur kam dalë kundër ndarjes dhe kundër asaj se 'Trepça' t'i mbetet Serbisë nuk mërzitem se kush hidhërohet. Aty është burimi i ndasive që kemi. U kërkujmë falje të gjithë shqiptarëve që i mërziu tash me këtë gjuhë që përdoret. Me dhimben shqiptarët e Shqipërisë, vëllezërit e motrat e jugut, sepse ne kur i kemi vendosur taksë Serbisë, është dashur që Shqipëria ta fitojë tregun në Kosovë. Kur Kosova iu heq si treg Serbisë, në vend se Shqipëria ta marrë këtë treg, shqiptarët mes vete kanë vendosur taksë në rrugë, e cila është 42 euro për kamion e 5 euro për makinë. Pra, ne kemi vendosur bllokadë që mos me u lidh këto ekonomi. I vetmi treg përmes të cilit ka mundur të forcohet Shqipëria dhe të bëhet ekonomia më e madhe, është tregu i Kosovës. Mirëpo në atë kohë Shqipëria ia ndaloi vetes një treg, duke vendosur taksë. Ato miliona që i merr me taksë në rrugë, ka mundur t'i marrë duke e pushtuar tregun e Kosovës.

"Epoka e re": A ka rrezik që këto raporte vëllazërore të dëmtohen nga këto përplasje?

Haradinaj: Ne jemi të përkohshëm, unë dhe z. Rama, dhe të gjithë. Vetëm populli dhe atdheu janë të përjetshëm. Pra, nuk ka lidhje çka ndodh me mua dhe Ramën, apo me ndonjë Ramush apo Ramë tjetër. E rëndësishme është që Kosova ka shpëtuar të mos ndahet. Po ashtu, e rëndësishme është që shqiptarët, kudo që janë, kurrë më të zotë nuk kanë qenë. Kemi dy shtete në Ballkan, kemi pozicion të avancuar në Ballkan. E di që askush nuk mund t'i dobësojë shqiptarët, as me përçarje e as duke i nxitur kundër njërit-tjetrit. Ne mund të bëjmë më shumë si dy vende që të integrohem mi më shumë. Ashtu siç kemi bërë në energji, me marrëveshjen për unifikim të tregut, duhet të bëjmë edhe në ekonomi. Heqja e taksës në rrugën e kombit nuk bëhet vetëm për t'ua kursyer disa para qytetarëve të Kosovës, ajo bëhet që ta lidhim tregun. Po thonë se ka taksë gjithkund, ne kemi nevojë për treg të njërit-tjetrit, jo për taksë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.



Viti i çudirave në Kosovë



Bedri ISLAMI

2019-shi, pa dyshim, ka qenë viti më i çuditshëm i pasluftës në Kosovë. Ndodhën të gjitha që nuk mund të ishin llogaritur. Taksa 100 për qind ndaj prodhimeve serbe, deri-diku edhe boshnjake, u bë mollë sherri jo vetëm në mes të Qeverisë së Kosovës dhe shtetit serb, që gjeti sebeb t'i ndërpresë bisedimet, që edhe ashtu do t'i kishte ndërprerë, por edhe mes shefit të qeverisë dhe diplomatëve ndërkombëtarë, e më përtej saj, mes dy qeverive simotra, asaj të përtej Drinit dhe kësaj, të vjetrës, këndeje Drinit. Dy shefat e qeverive u kënaqën duke sharë njëri-tjetrin, bënë qejf si ata fëmijët kur gjuhen me topa bore, pastaj e shtuan tonin dhe puna shkoi deri aty ku nuk e merr vesh as drejt e as i biri. Rama, si zëdhënës i pashallur i ndërkombëtarëve, i binte lehtë me bërryl Ramushit dhe i thoshte: "Hiqe, bre, Ramush, se do të hiqen vizat". Më kujtohet një episod, kur pas disa ditësh qëndrimi në Rambuje, i lodhur dhe i mërzitur, pasi për herë të parë pas 10 vjetëve kaloi në margjinë, Rugova, ende pa lexuar as draftin e parë, i binte me bërryl Thaçit dhe i thoshte, "nënshkruaje, bre Hashim, e të kthehem në shtëpi".

Kjo puna e bërrylit u bë mullar. Secili ia fut bërrylin shoqit dhe të gjithë të tjerët bëjnë sikur nuk e vërejnë. Isa Mustafa kërkoi t'ia ngjeshë Albin Kurtit. Isa është ujk i vjetër, ka shkollën e dikujt tjetër dhe i merr punët ngadalë. Kurti, më agresiv, i do gjërat më shpejt, se tre muaj me qeveri e pa qeveri janë pak si shumë, dhe ia fut bërrylin në fb Isë Mustafës dhe ky ia kthen. Votuesit ia futën bërrylin PDK-së, të lodhur prej saj, por edhe ajo vetë e lodhur nga pushteti. Në një orë, jo më shumë, kjo e fundit, nën drejtimin e Veselit vendosi se do të kalojë në opozitë. Kurrë kaq shpejt nuk ka ndodhur, por edhe nëse do të kërkonte pushtet, askush nuk ia jepte. Të gjithë, ashtu si në tragjedinë e famshme, "Të shtatë kundër Tebës", u bënë si një kor antik dhe thanë, "jo koalicion me PDK-në". Secili, edhe Nisma, edhe AAK, shpejtoi t'i lajë duart e veta nga bashkëqeverisja me PDK-në dhe menduan se, duke ia futur bërrylin, PDK-ja do të

jetë macja e zezë e ata vetë do të jenë zbardhur. "Nisma" ka dalë nga PDK-ja, AAK-ja ka dalë nga gjithkund.

Pastaj u bënë përlëshje e debate për kufirin. Dikush thoshte se do të synojë ta bëjë korigjimin e kufirit, ky ishte Thaçi, i cili, si duket, edhe një herë ua futi bërrylin të gjithëve dhe Kurti duhet të jetë i lumtur që, edhe këtë herë rivali i tij Thaçi ishte president dhe nuk u fut në fushatë. Nëse do të ishte ndryshe, askush nuk e di se si do të ishin shifrat. Thaçi është nuhatës i mirë i politikës, më i afti që ka Kosova mirëpo, si duket, dy forca politike, si askush tjetër kaq haptas, po duan t'ia shkurtojnë ditët e presidencës dhe t'ia afrojnë edhe një herë ditët e pushtetit. E kam thënë një herë dhe e them përsëri, ua kam thënë edhe figurave të njohura të LV-së, se "Thaçi, që më 1 janar, në mëngjes, e di se ku do të jetë më 31 dhjetor në mbrëmje".

Ta lëmë Thaçin në shejtaninë e tij. Thaçi nuk është i rrezikshëm për kundërshtarët kur gjëmon, por kur të buzëqesh. Nëse i ka qeshur këto ditë Isa Mustafës dhe Albin Kurtit, të dy duhet ta dinë se ai po luan lojën e tij.

Haredinaj, njeriu që, nga të gjithë liderët e Kosovës, e kam më për zemër, nuk e ndien se si kolegët e vet në Tiranë po e futin në një lojë që nuk është e tij dhe nuk ka pse të jetë. Herëherë, përmes tij, flet Ilir Meta, që ka hallet e tij, dhe herë të tjera flet Berisha, që nuk e di fundin e tij. Lulzim Basha nuk ka zë as për vete e jo për Ramushin. Nuk njoh politikan më të sinqertë, por edhe më të papritur. Nuk e di se kush ia ka mbushur mendjen se e shpëtoi Kosovën, kur asnjë ditë nuk ishte e rrezikuar. Thaçi, edhe me Ramën bashkë, miq që

herë-herë i japin krahun njëri-tjetrit dhe jo larg do t'ia ndiejnë edhe bërrylin, edhe po të duan, nuk kanë tagër me shit Kosovën. Nëse ky, Thaçi, merr Luginën e Preshevës, pa dhënë asgjë nga Kosova, do të jetë lideri i viteve, ndryshe, të mos futet në një pyll pa sëpatë dhe t'ia lë ahishtat dikujt tjetër, si ndodhi me definimin e kufijve me Malin e Zi. Demarkacion quhet, por lëvizja e kufirit është.

Viti 2019 ishte viti i befasive. Gjykata Speciale po thërret një nga një të gjithë ata që ngritën duart për ta miratuar. Asokohe patën ngritur një dorë, tani do të ketë, ndoshta, edhe nga ata që do të lidhin dy duart. Shefi i qeverisë, sapo e thirrën, dha dorëheqje, por prapë është shef i qeverisë. Lideri i opozitës shkoi, po ashtu. Pastaj të tjerë e të tjerë. Dikush ka filluar t'ia fusë bërrylin shokut të vjetër, me mendje se do t'i hiqet bërryli nga fati i tij. LDK-ja fërkon duart se në fund të fundit është edhe punë e saj kjo çështja e dosjeve. Ia patën filluar herët, që në vitin 1998, të shtojnë shënime dhe shefi i tyre ishte një korozi, si i thonë në jug, Ekrem Kryeziu i Prizrenit.

Nejse, Dhoma e Specializuar, që po bëhet gati të hapë shumë dhoma, ka punën e vet, Kosova ka punën tjetër.

Zgjedhjet e 6 tetorit u mendua se ishte fillesa e së mbarës dhe fundi i një viti të ngatërruar. Albin Kurti, lideri karizmatik i LV-së, si ishte pritur, i fitoi zgjedhjet, por jo si ishte pritur. Një fitore në zgrip, që ngriti peshë zemrat e militantëve të zjarrtë të LV-së dhe, si duket, ose nuk mjafton për të krijuar qeverinë, ose Kurti po bën llogari të tjera. Kurti është lideri më i lexuar dhe më i artikuluar në Kosovë e, besa, edhe jashtë saj.

Pragmatist në atë masë që duhet, njohës i mirë i teorive të kohës moderne, por edhe të historisë, i lidhur me luftën, më shumë si ide sesa veprimtari praktike, ia doli ta merrte "pronësinë" e luftës, që nuk e mbajti dot PDK-ja dhe që e kishte lëshuar prej kohësh Thaçi. Shqipëria, kjo e këndeje Drinit, mbajti frymën. Rezultati doli kur ende njerëzit nuk kishin fjetur më 6 tetor. Nuk kishte ndodhur kurrë. Habitërisht, "hajdutët" e votave, si i kishin akuzuar me javë e muaj, i zhvilluan zgjedhjet e qeta, nuk u hasmëruan me askënd, vodhën më pak se të tjerët në emra të përveçëm dhe e lëshuan qeverinë. Por, nuk ka ende njeri ta marrë. Habia e 6 tetorit u kthye në habinë e funddhjetorit, ku askush nuk troket me forcë te porta e presidentit, duke i thënë "ma jep mandatin". Ndodh e kundërta, presidenti i thërret dhe ata nuk shkojnë. Ndoshta e kanë mësuar atë që shkrova në fillim të shkrimit. Nga Thaçi ruaju jo kur zemërohet, por kur të buzëqesh. Sepse tash 20 vjet në politikë, jam i bindur se qesh me vete kur dëgjon e shikon se si grinden për një post presidencial, që ai, dy herë e zgjidhi për pak minuta... një herë për vete dhe një herë duke ia premtuar Pacollit.

Në Shqipërinë e këndeje Drinit u gëzuan që fitoi Albini. Megjithëse shumë janë të habitur se çfarë e lidh atë me Berishën, dy skajet e një litari të politikës, përsëri e deshën dhe shumë vazhdojnë ta duan... megjithëse, kur një lider, në tre muaj, nuk bën dot një qeveri, pyetja tjetër, për drejt, është se si do ta bëjë Kosovën. Megjithatë, unë besoj se do të bëjë diçka ndryshe, nëse e lë Isa Mustafa, i cili askush nuk e di se nga e ka

kokën... thonë se buka e vjetër nuk harrohet, ashtu si dashuria e parë... e Isa e ka pasur dashurinë e parë për politikën jashtë Kosovës.

Ndoshta Kurti ka menduar se do të jetë e lehtë të ndërtohet një qeveri me Isa Mustafën, mirëpo jo gjithmonë hesapet e shtëpisë të dalin në pazar. Fitorja e tij, që Mustafa ia përmend përditë, me vetëm një deputet më shumë, është aq e paktë sa nuk është pritur, por edhe aq shpresëdhënëse sa nuk është menduar. Shumë njerëz, megjithëse e kanë ditur se nuk janë veç 240 mijë vota, e kanë pritur si një fitore plebishitare.. mirëpo, ja që nuk paska qenë kështu dhe LV duhet të zbresë nga qielli. Se Isa dhe dikush tjetër, shpejt e shpejt mund t'ia tjetërsojnë një grusht deputetësh, si ndodhi më parë dhe, më pas, rrëmuja do të jetë më e madhe.

Mirë më shkruan një mik i veçantë, se "ka edhe shqiptarë që e duan Kosovën më shumë brenda Serbisë sesa brenda Shqipërisë". Kurti duhet të zgjedhë mes dy gjërave: ose një koalicion më të gjërë, nëse Mustafa nuk bie dakord dhe gjen "gozhdën e Nastradinit" te posti i presidentit, dhe, kur them më të gjërë ai, Kurti, e di më mirë se unë, ose të shkojë drejt zgjedhjeve të reja parlamentare.

Kosova qeveri ka e qeveri nuk ka. Ka shef qeverie në largim dhe shef qeverie që dihet se kush mund të jetë e nuk po vjen. Ka tregtarë që vajtuan se u mbyll kufiri me Serbinë, por që kanë gjetur deriçka për të futur mall si të duan. Kosova nuk e ka luksin të rrijë pa qeveri dhe koha e gjatë që po shkon është nga ata që gërryjnë themelin e shtetit.

Viti 2019 po mbyllet. Gjërat lëvizën dhe tani kanë mbetur. Një vit i ri erdhi. Do t'i shtyjë ai? Kush e di!





Çka na pret në 2020-n?

TREKËNDËSHI I NDËRVARËSISË GLOBALE

Trumpi do të luftojë për mandatin e dytë, Johnsoni për mandatin e parë - jashtë BE-së, Merkelu do të mbetet pa mandat e Macroni do të luftojë për mandat evropian. Gjermania do t'i hap kufijtë për punëtorët ballkanikë, por do t'i mbyllë për emigrantët aziatikë e afrikanë. Ballkani do të zbrazet nga ballkanasit e do të mbushet nga joballkanasit. Vështirë që, në maj, Samiti i Zagrebit për Ballkanin Perëndimor do ta shpërndajë mjegullën e Brukselit nga rajoni. Dialogu Kosovë - Serbi, edhe sikur të rinisë në fillim të vitit, vështirë do të përfundojë në fund të tij



Shkruan: Blerim REKA

Parashikimet gjeopolitike për vitin 2020 paralajmërojnë një vit të ndryshueshëm, në të cilin stabiliteti global do të varet nga përplasjet tregtare, energjetike dhe ekologjike. As në vitin që vjen nuk do të tejkalohen dallimet rreth këtyre tri çështjeve midis tresheve të mëdha: ShBA-së, Rusisë, Kinës, pa përfshirë këtu as BE-në. Po aq i paparashikueshëm do të jetë viti që vjen, shkaku i zgjedhjeve presidenciale në ShBA dhe ndryshimeve në BE dhe NATO. Ndërkaq në Ballkan, duke qenë një vit elektoral, priten kriza të reja qeveritare dhe ndalje reformash evropiane, për çka mjegulla e Brukselit do ta mbulojë edhe sivjet diellin ballkanik.

Do të hyjmë, pra në një vit me shumë të panjohura. Pos enigmës presidenciale amerikane, viti në të cilin po hyjmë do të sjellë ndryshime edhe në BE dhe NATO. Për të parën herë BE-ja do të zvogëlohet për një anëtar dhe NATO do të shtohet për një më shumë. Në pritje të presidentit të ri amerikan dhe tërheqjes së Merkelit, dy presidentë të tjerë në detyrë do ta maksimalizojnë lidhësin e tyre politik: Putini (në rrafshin global) dhe Macroni (në atë evropian). Ndërkaq ai kinez, Xi Jinping, do ta marrë primatin global tregtar, pas formalizimit të "marrëveshjes tregtare Kinë - ShBA: 50-50".

Amerikanët do ta inaugurojnë regjimin e ri tregtar edhe me Kanadanë dhe Meksikën, për ta zëvendësuar marrëveshjen e

vjetër për tregti të Amerikës Veriore (NAFTA) dhe do t'i vazhdojnë tarifatat tregtare ndaj BE-së, sikur edhe sanksionet ndaj kompanive evropiane - pjesë e projektit të gazsjellësit rus "Nord Stream 2". Kjo, para së gjithash, mund t'i trazojë marrëdhëniet me Gjermaninë, portës hyrëse detare evropiane të këtij gazsjellësi të Putinit, që anashkallon transitin tokësor ukrainas.

SCOTEXIT vs. BREXIT

Kryeministri britanik Boris Johnson, edhe pse e ruajti postin, i mbetet ta ruajë Britaninë e Madhe si unike. BREXIT hapi rrugën për daljen nga BE-ja, por SCOTEXIT do të shpie drejt daljes së Skocisë nga Mbretëria e Bashkuar. Pas daljes britanike, pritet dobësimi i vijës atlantike në BE dhe forcimi i krahut "sovrani evropian". Kjo do t'i shkojë përshtati "politikës neutrale" të Putinit, i cili në vitin që vjen do ta maksimalizojë diplomacinë energjetike me dy gazsjellësit për Evropë ("Nord Stream 2" dhe "Turkish Stream"), për t'u mos varur nga transiti ukrainas, e duke e bërë të varur Evropën nga gazi rus. Ashtu siç do ta bëjë të varur Kinën për 30 vjetet e ardhshëm, me gazsjellësin rus prej 400 miliardë dollarësh. Gazi do ta lidhë Kinën me Rusinë, po aq sa Kinën, tregtia me ShBA-në. Do të krijohej kështu një trekëndësh i ndërvarësisë globale midis tri fuqive të mëdha. Nëse gjatë Luftës së Ftohtë siguria globale varej nga dy blloqe, tash e tutje ajo do jetë tri-bloqiste.

Makronizmi si Neo-Degollizëm?

Në vitin kur Trumpi do të luftojë për mandatin e dytë, Johnsoni për mandatin e parë jashtë BE-së, e Merkelu do të mbetet pa

mandat, Macroni do të luftojë për mandat evropian. Ai do të katapultohet në lider të vetëm evropian dhe do ta rikthejë formulën e para gjysmëshekulit të Degolit për BE-në me: "Francën lart, Gjermaninë poshtë dhe Britaninë jashtë". Idenë e tij për "Armatën Evropiane" shumëkush e sheh konkurrencë të NATO-s. Viti 2020 prandaj do të jetë edhe vit i përplasjeve midis dy koncepteve: sigurisë euroatlantike dhe sigurisë evropiane.

Deri në fund të vitit që vjen Franca do ta finalizojë strategjinë e saj për reformën e BE-së, për ta shpalosur në janarin e vitit 2021, kur merr kryesimin e BE-së: me një konventë evropiane për një traktat të ri të BE-së, që do ta zëvendësojë aktualin e Lisbonës. Forcimi i brendshëm i BE-së, krahas atij të jashtëm, si aktor global, do të jetë thelbi i kësaj reforme të Macronit. Viti që vjen mund ta sjellë Macronin në fronin evropian si një lider i ardhshëm i BE-së, pas Merkelit.

Në gjashtëmujorin e parë Kroacia, si kryesuese e BE-së, vështirë se do të mund ta shtyjë përpara prospektin integruar të vendeve të rajonit. Komisioni i ri Evropian do të balancojë midis dy strategjive kundërshtuese për zgjerim: asaj franceze, (kundër) dhe asaj të 9 shteteve anëtare (pro). Si rëndom, do të gjendet një kompromis: nëse jo tërësisht të ndalet zgjerimi, atëherë ai do të kushtëzohet e prolongohet, pa garanci për anëtarësim të plotë. Vështirë që në maj Samiti i Zagrebit për Ballkanin Perëndimor do t'i çajë bllokadat e disa shteteve anëtare që janë kundër zgjerimit të BE-së. Sindroma e pritjes së gjatë të Turqisë para portave të Brukselit, duket skenar real edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në gjashtëmujorin e dytë Gjermania do ta kryesojë BE-në, duke shtyrë përpara idenë e saj për Ballkanin si tampon zonë strehuese për refugjatët jovevropianë që synojnë Evropën. Nga 1 marsi, me Ligjin e ri të punës, Berlino do t'i hapë kufijtë për punëtorët ballkanikë, por do t'i mbyllë për emigrantët aziatikë e afrikanë. Kështu, Ballkani do të zbrazet nga ballkanasit, e do të mbushet nga joballkanasit. Turqia, që ishte kampi pranues për 4 milionë refugjatë, (me 6 miliardë eurot e BE-së), nuk do të pranojë më refugjatë të rinj. Madje në fund të vitit që e lamë, presidenti turk, Rexhep Taip Erdogan, paralajmëroi se nuk do të pranojë më

emigrantë të ri, pas valës së re prej 120 mijë emigrantëve siri-anë që iknin nga ofensiva e fundit e Asadit. Duke pasur parasysh që pas stacionimit ushtarak në Siri, (vendnija e emigrantëve aziatikë), Rusia u ankorua edhe në Libi, (porta afrikane e emigrantëve për në Evropë), ajo do t'i kontrollojë këto dy porta emigrantësh me destinim Evropën. Se çfarë bombe demografike destabilizuese për Evropën ishin emigrantët në vitin 2016, tashmë u pa dhe kjo pritet të përsëritet në BE edhe në vitin që vjen. Prandaj, me mbylljen e kufirit turk për emigrantët e rinj dhe hapjen e kufirit libian, Brukseli me ndihmën e FRONTEX-it do të kërkojë në Ballkan hapësirë të re strehuese për refugjatët aziatikë dhe afrikanë. Problemi i refugjatëve do ta dominojë agjendën e BE-së edhe në vitin që vjen, aq më shumë që vetëm gjatë shtatë vjetëve të fundit, sipas UNHCR-së, numri i refugjatëve në botë ishte rritur për 70 për qind. Presioni i refugjatëve mund të jetë bombë e kurdisur për stabilitetin evropian, ku Ballkani mbetet porta hyrëse e tyre për BE.

Shqipëria kryesuese e OSBE-së, Maqedonia e Veriut anëtare e NATO-s

Në Ballkan viti 2020 do të jetë vit elektoral. Shqipëria do ta kryesojë OSBE-në, por me jostabilitet të brendshëm politik që mund të shpie në zgjedhje të parakohshme. Maqedonia e Veriut do të bëhet anëtarja e 30 e NATO-s, por me zgjedhje të parakohshme, sikur edhe Serbia. Zgjedhjet në Ballkan rëndom prodhojnë kriza qeveritare. Kjo u pa në Shqipëri e në Kosovë dhe mund të përsëritet edhe në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Vështirë se zgjedhjet e 12 prillit në Maqedoni (nëse nuk shtyhen) do të nxjerrin një qeveri stabile, sepse asnjë parti nuk do ta fitojë shumicën. Thjesht, sepse nuk mbetet kush të votojë, e ata që mbeten, janë lodhur nga votimi. As koalicionet ndëretnike nuk do të krijojnë qeveri të sigurt, sepse votat do të shpërndahen barabartë si te partitë maqedonase, po ashtu edhe tek ato shqiptare. Pra, sërish një vit elektoral ballkanik, me kriza qeveritare dhe me ngadalësim të agjendës evropiane të reformave.

Nëse fillimi i 2020-shtit do ta gjejë Kosovën me qeveri të re, dialogu Kosovë - Serbi ndoshta edhe do të mund të rinisë në fillim të vitit, por vështirë do të përfun-

dojë në fund të tij. Ky dialog do të jetë i një formati të ri e me parime të reja, por vështirë që normalizimi midis dy shteteve do të finalizohet për 12 muaj. Trumpi do të preferonte një "Kemp Dejvid Ballkanik", para fillimit të fushatës presidenciale, por tetë vjet të "Dialogut të Brukselit", vështirë do të mund të finalizohen me tetë muaj të "Dialogut të Uashingtonit". Nëse as më 2020 nuk do të normalizohen marrëdhëniet ndërshtetërore Kosovë - Serbi, Rusia do të mund të aktivizojë xhokerin e pëshpëritur jozyrtarisht, për tregtinë diplomatike me ShBA: të këmbimit të ulësës së Kosovës në OKB, për njohjen e Krimesë, si pjesë të Rusisë.

"Unioni Ballkanik", zëvendësim i Unionit Evropian me Unionin Euro-Aziatik

E vetëdijshme që Ballkani nuk është buzë kufijve të saj, Rusia nuk do ta përdorë strategjinë aneksuese (si në Gjeorgji e Ukrainë), por do të vazhdojë ta mbajë rajonin nën influencën e vet. Në vend të pushtimit ushtarak, Moskë do ta vazhdojë mbajtjen e konflikteve të ngrira në Ballkan, si pretekst për involvimin e vet diplomatik, që pastaj ta prolongojë integrimin e plotë euroatlantik të rajonit. Në vend të hard power (ushtrisë), Rusia do të fuqizohet në Ballkan me smart power, (vëllazërinë sllave dhe vijën ortodokse) dhe sharp power (luftën hibride, lajmet e rreme dhe sulmet kibernetike). Fundja, Ballkani as që ishte pjesë e ish-Bashkimit Sovjetik, që tash Rusia duhet ta rikthejë, por mbeti korridori transitor për gazsjellësin e saj "Turkish Stream", që do ta fillojë qarkullimin vitin që vjen. Për Rusinë, Serbia do të mbetet sateliti kyç rajonal, shkaku i bazës së saj në Nish, si korridor energjetik dhe si bërthamë penguese e për Ballkanin euroatlantik. Si i vetmi shtet nga rajoni, në Unionin Euro-Aziatik, Serbia do të vazhdojë të mbetet promotore ballkanik e dy strategjive ruse: politikës "neutrale" (karshi NATO-s) dhe "Minishengenit ballkanik" (si zëvendësim për BE-në). Në shkurt, me samitin përmblyllës në Beograd, Serbia do ta bëjë përpjekjen e fundit që me këtë "Union Ballkanik" t'i mbyllë derën Unionit Evropian dhe ta hapë atë për Unionin Euro-Aziatik. Mirëpo, një rrëshqitje aq e thellë e Ballkanit vështirë që do të lejohej nga ShBA-ja.

Flet zëvendëskryetari i PDK-së, njëherësh edhe zëvendëskryeministër, Enver Hoxhaj

Është në interes të Kosovës të

Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh edhe zëvendëskryeministër, Enver Hoxhaj, ka thënë se viti 2020 do të varet shumë prej vendimeve të cilat do të merren në Kosovë. Në intervistën dhënë për numrin festiv të gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është në interes të Kosovës që të përmbyllet dialogu me Serbinë, të ngrehet flamuri në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe të përmbyllet shtetndërtimi i Kosovës. Sipas Hoxhaj, Kosova nuk është në vitin '99 dhe as partnerët tanë nuk janë në vitin '99. "As Kosova nuk është në vitin 2008 kur e kemi shpallur pavarësinë, as konteksti global nuk është i njëjtë sikurse ka qenë në vitin 2008", ka thënë Hoxhaj

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR-

"Epoka e re": Z. Hoxhaj, në cilësinë e zëvendëskryeministrit në detyrë, sa ka arritur qeveria, në të cilën edhe PDK-ja ishte pjesë e saj, t'i përmbushë prioritetet për vitin që po lëmë?

Hoxhaj: Gjatë këtij viti janë kryer disa prej prioritetëve që i kemi pasur para vetes si Qeveri e Kosovës, ato të cilat kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve. Një pjesë e vendimeve natyrisht që kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes ekonomike apo sociale në Kosovë. Marrë në tërësi, viti 2019 ka qenë më shumë vit i stagnimit dhe i një ambienti stagnues sa i takon vendimmarrjes në qeveri për shkak se kishim dorëheqjen e kryeministrit Haradinaj, pastaj zgjedhje të parakohshme dhe pothuajse gjysma e vitit ka shkuar në një situatë politike të jashtëzakonshme të mbajtjes së zgjedhjeve, të numërimit të votave, të përsëritjes së numërimit të votave, të një certifikimi të vonshëm të rezultetit zgjedhor, si dhe kemi një situatë ku thuajse pas tre muajsh kemi arritur ta konstituojmë Kuvendin e Kosovës, por nuk e dimë si do të jetë e ardhmja e mandatit të ri qeverisës të dalë pas zgjedhjeve të 6 tetorit.

"Epoka e re": A keni pritur këtë vit një qeveri në dorëheqje?

Hoxhaj: Nuk kemi pritur se do të ketë dorëheqje të kryeministrit Haradinaj, përkundër situatës jo të mirë në raport të tij me ftesën që mori për intervistë nga Gjykata Speciale. Z. Haradinaj e ka pasur mbështetjen e plotë që ta vazhdojë mandatin e kryeministrit dhe ne nuk kemi menduar që viti 2019 do të jetë një vit ku mund të ketë dorëheqje të kryeministrit dhe shkuarje në

zgjedhje të parakohshme dhe ta konsumojë pothuajse tërë vitin një proces i ri elektoral i parakohshëm.

"Epoka e re": Sa keni qenë i kënaqur me punën e ministrave të PDK-së?

Hoxhaj: Veçanërisht ministrat e PDK-së kanë bërë një punë të mirë, por nuk dua t'i përjashtoj edhe kolegët e tjerë, mirëpo çdo qeveri matet jo vetëm në atë çfarë bën në kuptimin e asaj prej punëve të cilat janë të domosdoshme që duhet të përfundojnë, por qeveritë maten prej temave të mëdha nacionale. Mendoj se vendimi që kemi marrë si Qeveri e Kosovës që ta transformojmë FSK-në në një ushtri të plotë, një proces i cili ka qenë jetik për Kosovën dhe i cili është stërzgjatur ka qenë një vendim i mirëfilltë, pastaj mënyra se si kemi bërë përpjekje që të ballafaqohemi me Serbinë, që ta ndjekim një politikë të ballafaqimit me vendosjen e taksës ka qenë një rrugë e duhur, por mbajtja e saj në fuqi pa e përkthyer në një mbështetje të mirëfilltë ndërkombëtare është kthyer në disfavor. Dhe, po ashtu, mungesa e një politike aktive tonën që ta përmbyllet temën e liberalizimit të vizave e lë këtë temë edhe më tutje në tavolinë, ndërsa sektorë të ndryshëm i kanë kryer punët që do të duhej të bëheshin sipas planifikimit.

"Epoka e re": Si PDK, a keni qenë të kënaqur me partnerët e koalicionit qeverisës?

Hoxhaj: Ne kemi pasur bashkëpunim të mirë me z. Haradinaj. Ai e ka pasur mbështetjen tonë politike, por mes partnerëve të koalicionit në vitin 2019 ka qenë një lloj rivaliteti i brendshëm, ku shpeshherë nuk e kemi ditur se realisht kush është në qeveri



dhe kush është në opozitë. Unë nuk dua që t'i shoh institucionet e vendit në një frymë të tillë, ku rivaliteti shpesh shndërrohet në një situatë të komplikimit të tejskajshëm të situatave politike. Fakti që nuk kemi mbërritur që ta çojmë mandatin deri në fund, përkundër ftesës së Gjykatës Speciale dhe faktit që të tre partnerët e koalicionit janë me këtë rezultat zgjedhor dhe kemi mbetur në opozitë, janë parametra matës që gjërat nuk kanë shkuar mirë siç është dashur të shkonin.

"Epoka e re": Ky rivalitet u bë se kush e bëri ushtrinë dhe kush e vendosi taksën ndaj Serbisë?

Hoxhaj: Jo, është bërë më shumë me perceptimin e kryeministrit Haradinaj, se mund të marrë më shumë mbështetje elektorale, gjë që u pa se është e kundërta. Kjo është parë më shumë me një frymë e cila e ka përfshirë Kosovën, Ballkanin dhe Evropën, pra në nivel global u pa një lloj populizmi, ku njerëzit mund të kënaqen me tituj të fuqishëm në media apo me postime në rrjetet sociale. Ne kur kemi

shkuar në vitin 2017 në zgjedhje kemi deklaruar se do ta bëjmë një qeveri të vendimeve të mëdha, meqë qeveria e z. Mustafa ishte bllokuar në vendimmarrje, sidomos sa i takon demarkacionit. Mendoj se disa punë janë kryer, por nuk kam ndonjë vlerësim superlativ, sepse pritjet tona kanë qenë krejt të tjera.

"Epoka e re": Çfarë ndodhi me liberalizimin e vizave?

Hoxhaj: Nuk mendoj se liberalizimi i vizave ndërlidhet me mospunën tonë. Mendoj se si qeveri dhe fakti që edhe partnerët e koalicionit dhe ata që kanë kundërshtuar ratifikimin dhe, po ashtu, ata që e kanë shpikur si temë, në fund e kanë votuar. Çdokush duhet ta dijë se ne si Kosovë kemi plotësuar çdo standard të mundshëm për liberalizimin e vizave.

"Epoka e re": Liberalizimi nuk ka pasur ndërlidhje me taksën?

Hoxhaj: Absolutisht jo, mirëpo mënyra se si BE-ja e ka trajtuar Kosovën dhe mënyra se si disa shtete anëtare e kanë trajtuar Kosovën ka qenë e padrejtë dhe

ka dëmtuar edhe kredibilitetin e BE-së në Kosovë. Prandaj ne i kemi kryer të gjitha punët që janë vlerësuar prej Komisionit Evropian. Parlamenti Evropian ka miratuar raportin dhe mandej vendimmarrja është bllokuar te shtetet anëtare, më shumë për shkak të politikave të tyre të brendshme populiste dhe më shumë për shkak të mosinteretit që të merren me tema serioze në Ballkan, por nuk mund të fajësohet askush në Kosovë në vitin 2019 për atë që Kosova nuk i ka përmbushur standardet për liberalizim.

"Epoka e re": Nuk ka qenë mirë as politika e jashtme.

Hoxhaj: Kosova në këta dy vjet nuk ka pasur politikë të jashtme. Politika e jashtme nuk bëhet me deklarata. Politika e jashtme bëhet me veprime konkrete në nivel rajonal, në nivel evropian dhe në nivel global. Vetëm fakti se si Tirana dhe kryeministri Rama janë sjell gjatë kohëve të fundit në raport me minishengenin dhe mungesa e komunikimit në mes të dy Ministrive të Jashtme, mungesa e komunikimit mes kryeministrit Rama



përmbillet dialogu me Serbinë



dhe kryeministrit Haradinaj dhe shkuarja e tij në Novi Sad, ku ne nuk kemi pasur asnjë informatë, shkuarja e tij në Ohër ku ne kemi marrë një lloj ftese, por pa kuptuar se cilat janë qëllimet e një termi të tillë apo qëllimi politik si minishengen. Po ashtu, edhe ftesa për presidentin pa një komunikim paraprak serioz, sepse në diplomaci nuk ke nevojë të prodhosh tituj, fillimisht flet zyrtarisht. Kjo tregon se ne kemi problem edhe në nivel rajonal me politikën tonë të jashtme. Minishengeni, si termi më i ri, tregu i përbashkët rajonal si term pak më i vjetër dhe unioni doganor, po ashtu si term më i vjetër, e kanë një histori dhe historia e tyre është që fillimisht politika serbe me ambicie që ta dominojë rajonin, e ka shpikur idenë e unionit doganor në shkurt të 2016-s. Diçka që unë e kam kundërshtuar i pari dhe haptas pas disa dokumenteve jozyrtare që kanë qarkulluar nga diplomatët serbë në Bruksel dhe disa qendra evropiane. Mandej ideja që të plasohet një treg i përbashkët rajonal që ne e kemi kundërshtuar dhe së fundi minishengeni

janë në kontinuitet i cili ka karakterizuar politikën rajonale të Serbisë në tre-katër vjetët e fundit dhe mospjesëmarrja jonë ka qenë e drejtë. Ne në asnjë mënyrë nuk duhet ta ndajmë sovranitetin tonë me një shtet si Serbia që nuk e njeh pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, me Bosnjën e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Së këndejmi, kur kemi parasysh se vetë Serbia në tetor të 2019-s ka nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë me komunitetin euroaziatik që udhëhiqet prej Rusisë, ku të gjitha shtetet e këtij komuniteti euroaziatik kanë marrëveshje të tregtisë së lirë me Serbinë. Ne, po ashtu, nuk duam ta ndajmë një sovranitet tonin me një kundërshtar strategjik të Kosovës në nivel global sikurse është Rusia. Prandaj, qëndrimet tona kanë qenë të matura. Mund të them se ne kemi bërë disa analiza në 2016-n, 2017-n, por edhe në 2019-n, se cila është kostoja ekonomike dhe cili është dëmi politik nëse Kosova i bashkohet një iniciative të tillë që është kryekëput kundër interesave të Kosovës dhe shqiptarëve në Ballkan.

"Epoka e re": Po thirrja e Ramës që Kosova duhet të ishte pjesë e tavolinës?

Hoxhaj: Unë nuk dua që të flas se çfarë duhet të bëjë kryeministri i Shqipërisë. Unë i shoh shqiptarët kudo në rajon si faktorë në ngritje dhe në ardhje. Pra, nuk duhet të krijohet situata ku ne kemi mospajtime Tiranë dhe Prishtinë. Kur ne e zhvillojmë këtë bisedë unë edhe më tutje jam zëvendëskryeministër i Kosovës. Përshkrimi im i punës, në bazë të Kushtetutës dhe në bazë të ligjeve në fuqi dhe mandatit qytetar që kam marrë, është që t'i mbroj interesat e shtetit tim. Prandaj, mendoj se unioni doganor, tregu i përbashkët rajonal dhe minishengeni janë e njëjta gjë dhe janë në kundërshtim me çdo gjë çfarë ka ndjekur Kosova në politikën e saj rajonale. A kemi mundur që ne të jemi më aktivë?! Mendoj se po. Mendoj se është dashur që të bisedohet me Maqedoninë, me Shqipërinë dhe duhet të bisedohet me Malin e Zi para se të mbahet samiti, meqë neve na duhen këto tri shtete për të pasur një lloj trekëndëshi rajonal që mbështet interesin tonë në rajon. Sikurse

duhet të bisedohet edhe me partnerët tanë evropianë dhe amerikanë se a është vërtet në interes të Evropës dhe a është në interes të ShBA-së që një treg i tillë të jetë zgjatje e Rusisë në Ballkan dhe një treg i tillë të jetë zgjatje dhe bërje e Serbisë, një lloj faktori më të rëndësishëm edhe politik edhe ekonomik në Ballkan. Ne nuk duhet t'i shohim këto gjëra me naivitet, por duhet të krijohen partneritete, aleanca dhe duhet të veprohet në baza ditore që të ushtrohet politika e jashtme dhe të ketë një mendim të plotë gjeopolitik rajonal.

"Epoka e re": Mesazhi juaj për 2020-n?

Hoxhaj: Mendoj se viti 2020 do të varet shumë prej vendimeve të cilat do të merren në Kosovë, se sa ne do të arrijmë të projektojmë politikë të jashtme. Janë disa tema të rëndësishme që janë në tavolinë, që janë të rëndësishme për të ardhmen e vendit. Unë e di që tema e dialogut me Serbinë nuk është një temë popullore; e di që Serbia po silltet edhe në 2019-n sikurse që sjell në 1999-n; e di që presidenti serb, Vuçiq, e ka një gjuhë, diskurs politik me

qëllime të njëjta sikurse që e ka pasur në vitin '99 kur ka qenë ministër për Informim i Millosheviqit. Por, përkundër kësaj, politika dhe bërja e politikës në demokraci është një kontekst kompleks. Mendoj se është në interes të Kosovës që ta përmbysim dialogun me Serbinë, ta ngrehim flamurin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ta përmbysim shtetndërtimin e Kosovës sepse as Kosova nuk është në '99-n dhe as partnerët tanë nuk janë në vitin 1999, as Kosova nuk është në vitin 2008 kur e kemi shpallur pavarësinë, as konteksti global nuk është i njëjtë sikurse ka qenë në vitin 2008. Ne nuk do të duhej në pafundësi, për shkak të mungesës së vullnetit dhe mungesës së besimit, të mos e marrim temën e dialogut mbi supet tona dhe si një elitë politike dhe shtetërore duhet ta përmbysim këtë proces. Mendoj se tek pasi të ulemi në tavolinë ne mund ta dimë nëse marrëveshja është e favorshme për Kosovën dhe nëse përmbush interesat strategjike të Kosovës, por nuk duhet t'i themi jo tavolinës.

ÇKA DHE PSE NUK SHKOI MIRË TE SHQIPTARËT ANDEJ DHE KËNDEJ DRINIT



Shkruan: Behxhet
SH. SHALA - BAJGORA

Shekulli i shqiptarëve apo... jemi popull euforik që funksionojmë sipas ligjeve të fizikës, përkatësisht sipas "Ligjit të Ilamarinës". Nxehemi shpejt, ndërsa ftohemi edhe më shpejt! Kemi kapacitet përshtatjeje në çdo rrethanë, në çdo temperaturë, në kushte normale, por edhe në kushte ekstreme, prandaj kjo mund edhe të jetë arsyeja pse kemi mbijetuar (jo jetuar) në këta 2 000 vjetët e fundit, pa u asimiluar dhe duke e ruajtur kodin gjenetik e të parëve tanë e që nuk ndodhi kështu me disa popuj të tjerë të cilët u asimiluan 100 për qind, siç janë fqinjët tanë bullgarët që nuk ishin sllavë, por se u sllavizuan krejtësisht. Gjatë kohës së gjatë të luftës për mbijetesë, pjesën më të madhe e kaluam të robëruar, prandaj edhe nuk patëm mundësi të kemi një zhvillim normal sepse kryesisht i shërbyem pushtuesit dhe shumë pak popullit shqiptar. Periudhat e robërisë ishin shumë të gjata, llogariteshin me qindra vite nën Perandorinë Romake, Bizantin, nën Perandorinë Otomane, bullgare, greke, italiane, jugosllave, sovjetike, kineze dhe, së fundi, nën vartësi kolonialiste të gjithë atyre që, kinse, na përkrahin, por se e bëjnë të kundërtën. Në këto rrethana ishte problem të kishim një arsim cilësor e që është bazë e zhvillimit të përgjithshëm, më shumë prodhoni analfabetë funksionalë dhe jofunksionalë se intelektualë! Në kohën kur shumë shtete dhe vende shënonin të arritura të mëdha në fushën e arsimit, shqiptarët në Kongresin e Manastirit në vitin 1908 e sajuan një alfabet, ku gjysma e shkronjave ishin të huaja. Mos harroni se po në atë kohë vendet dhe shtetet me të cilat kufizoheshin trojet shqiptare (nuk kishte shtet shqiptar), shënonin dhe festonin dhjetra dhe qindra vite të universitetit! Për aq kohë sa ata nxirrnin ekspertë të të gjitha fushave, ne nuk kishim as edhe një alfabet apo një abetare që të na mësojë shkrim-lexim! Ata pak intelektualë shqiptarë, të konvertuar kom-


bëtarisht dhe fetarisht, kontributin më të madh e dhanë për perandoritë dhe kolonizatorët, duke kontribuar edhe në formimin dhe mëkëmbjen e shteteve të tjera, në ndërkohë kur ne nuk kishim shtet as edhe në gjurmë. Gjatë "mbretërimit" të një "mbreti" krejtësisht analfabet dhe pa as edhe një ditë tradite mbretërore, shumica e intelektualëve dhe patriotëve shqiptarë u përdoqën dhe u vranë. Çka mund të pritej tjetër prej një Zogu, i parë apo i fundit i cili erdhi dhe mbeti në pushtet me ndihmën e Serbisë, xhandarmëria e të cilit paguhej nga buxheti i mbretërisë serbo-kroato-slllovene, që i fali tokat më të bukura shqiptare dhe që duke e vjedhur pasurinë e popullit të varfëruar shqiptar, me ta dëgjuar krismën e parë të revoles së Musolinit, ia mbathi jashtë vendit duke i shpenzuar pamëshirshëm në Greqi, Egjipt, Afrikë të Jugut, Mbretëri të Bashkuar, Spanjë e gjetiu. Pastaj, goditjen më të madhe që i dhanë Shqipërisë dhe shqiptarëve ishin komunistët e udhëhequr nga Enver Hoxha që e zhveshën shqiptarin nga çdo vlerë njerëzore, kombëtare, politike, shpirtërore, kulturore etj., për ta shndërruar njeriun në një qenie mekanike, të kurdisur të

jetojë nën kushte të dhunimit të dinjitetit të skajshëm dhe duke mos zgjedhur mjete, vetëm për të mbijetuar! Në kohën e regjimit komunist në Shqipëri, intelektualët e vërtetë, ose u vranë ose kaluan vite e vite nëpër burgje dhe internime, kurse pjesa e intelektualëve butakë u shkrinë në makinerinë vrasare të regjimit komunist duke i gëzuar të gjitha të mirat, edhe në kohën e Enver Hoxhës sikur edhe në kohën e të konvertuarit, por asnjëherë demokracitë të vërtetë, diktatorit të tretë të Shqipërisë, doktorit nga Tropoja, Sali Berishës. Realisht përgjegjësinë kryesore për gjendjen e mjerë të shqiptarëve, pasojat e së cilës i ndiejmë edhe sot, andej dhe këndej Drinit e kanë tre persona që e kanë sunduar thuaja 85 për qind të kohës që nga shpallja e Pavarësisë, më 28 nëntor 1912; Ahmet Zogu, Enver Hoxha dhe Sali Berisha. Përveçse nuk e përmbushën detyrimin kushtetues dhe moral, bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të vetëm, ata copëtuan tokën ekzistuese, përdoqën dhe vranë të gjithë intelektualët dhe patriotët shqiptarë që nuk ishin në shërbim të tyre, u shndërruan në vazalë të të tjerëve dhe u bënë dhunues të shqiptarëve, pa dallim se ku jetonin.

Kjo ishte e kaluara, po si është gjendja sot: Edhe sot shqiptarët vuajnë nga një ves që tashmë e kanë bërë traditë dhe mënyrë e të jetuarit, përçarjes dhe përdorimit të fjalës së fundit, të parën apo si kryefjalë, bëhet fjalë për lehtësinë e pabesueshme të të shpallurit tradhtar! Madje këtë më së lehti e bëjnë djarrakohësit apo ata që në një apo mënyrë tjetër ndërlidhen me tradhtinë, të trashëguar apo të fituar si mundësi dhe nevojë për ta mbuluar të kaluarën apo për ta arsytuar të tashmen. Kjo dukuri përçohet që nga nivelet e larta të pushtetit, për të keqpërdorur pastaj si ushqim shpirtëror për nivelet më të ulëta.

Shqipëria: Është atdhe, mëmëdhe dhe shtet i të gjithë shqiptarëve, pavarësisht se ku jetojnë. Shqiptarët nuk kanë atdhe dhe shtet tjetër, përjashtuar këtu kosovarët e shpifur që duan ta ndajnë padrejtësisht popullin shqiptar. Shqipëria në rrethana normale duhet të jetë Piemont (bashkues apo strumbullar) i të gjithë shqiptarëve e që nuk e luajti këtë rol asnjëherë në historinë e saj ndonëse Kushtetuta e Shqipërisë e përligj dhe e bën të detyrueshëm paternalizmin ndaj çdo shqiptari e që në historinë e saj kurrë nuk e luajti atë rol. As "mbreti" Zog, as Enver Hoxha e as

Sali Berisha. Madje, në shumë raste, këta tre diktatorë përçanë deri në armiqësi organizmin e dobësuar dhe të molisur shqiptar duke arrestuar, dënuar, internuar dhe vrarë shqiptarë. Nga Lufta e Dytë Botërore, Shqipëria doli e shkatërruar në çdo mënyrë ku afërsisht 80 për qind ishin analfabetë, pa infrastrukturë, pa arsim, pa shërbime shëndetësore, e mbyllur hermetikisht dhe 100 për qind e varur nga sovjetikët, jugosllavët dhe kinezët. Mirëpo, nëse bëni një krahasim midis Shqipërisë së viteve 1945, 1990 dhe 2019, edhe me vendet e rajonit atëherë lehtësisht vërtetohet se Shqipëria është zhvilluar më së shumti në aspektin e ndërtimit të infrastrukturës, ndërtimeve, përmirësimit të kualitetit të jetës (migrimi ka luajtur rol vendimtar si dhe paratë e pista apo nga krimi i organizuar). Kështu kishte ndodhur edhe në Itali sikur edhe në ShBA, më heret. Në aspektin e ruajtjes dhe forcimit të identitetit kombëtar, nuk ka ndonjë përparim, kurse në raport me shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginë, është vërejtur, sidomos nga një pjesë e klasës intelektuale, një qëndrim racist dhe nënçmues. Nëse shtetet e rajonit, çdo anëtar i të popullit që i takon, pavarësisht ku jeton, në mënyrë automatike ua ka njohur shtetësinë duke i lëshuar pasaportën, Shqipëria nuk e ka bërë këtë ndonëse kishte premtuar Sali Berisha. Politika shqiptare më shumë ka qenë e përqëndruar drejt shteteve fqinje nëse edhe ato kanë qenë armiqësisht të disponuara ndaj Kosovës. Çdo udhëheqës i Shqipërisë i ka pasur "shqiptarët e vet", në vendet jashtë Shqipërisë me të cilët ka manipuluar, varësisht sa u janë dashur. Dihet se kush nga liderët shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Luginës kanë qenë të afërt me Sali Berishën, Fatos Nanon e tash Edi Ramën e kush ishin dhe janë kundër tyre. Nga kjo situatë përfituan kryesisht disa kosovarë që tradicionalisht ishin në shërbim të Jugosllavisë dhe Serbisë e që e fituan shtetësinë shqiptare, duke vazhduar ende t'i shërbejnë Serbisë! Është i qartë roli i Sali Berishës, para, gjatë dhe pas përfundimit të luftës sikur edhe i Fatos Nanos. Së fundi, pasi u fuqizua në skenën politike shqiptare Edi Rama e që fillimin e kishte të mirë, u ngjallë një shpresë se më në fund e kemi një



zë të përbashkët që e përçon në botë vullnetin politik të shqiptarëve sikur që denjësisht mbron interesin kombëtar dhe shtetëror. Edi Rama që nga fillimi u përballë me një opozitë destruktive, të kompromituar dhe palçerisht të korruptuar e që udhëhiqej nga Lul Basha që shërbente si ogji i kopesë politike të Sali Berishës. Kjo, mbase, ndikoi që Edi Rama, nga një situatë e të vepruarit normal në politikë, u transformua në një personalitet arrogant që, sidomos në raport me mediet, shakthësinë oratorike e keqpërdori deri në nënçmim. Pas përafritimit të qëndrimeve me Hashim Thaçin dhe Aleksandar Vuçiqin, në Kosovë i ranë ndjeshëm aksionet politike të cilat, në vend se të bëjë përpjekje t'i rikthejë, arriti që ta humbë përkrahjen krijtësisht sidomos për këtë Minishengenin në kohën që paturpësisht po na mohohet shengeni normal, për të cilën atësinë po e marrin Vuçiqi dhe Rama, ndonëse më kujtohet mirë se shumë vite më parë për këtë kishin folur Fatmir Sejdiu, ish-president dhe Zarife Jahjaga, asnjëherë presidente reale. Është interesant që aktualisht Edi Rama po sulmohet ashpër nga dy kategori opinionesh dhe "personalitetesh" në Kosovë nga ata që i kanë shërbyer Serbisë dhe ende janë pjesë e këtyre projekteve e që maksimalisht e kanë materializuar këtë dhe nga idealistë kombëtarë që nuk kanë përfituar asgjë, por se këtë e bëjnë nga qëllimet më të mira. Të dyja këto opinione e shpallin Edi Ramën tradhtar të kombit shqiptar, Esat Pashë Toptan etj. e që unë nuk pajtohem me këto cilësime. Sepse, edhe po të dojë e unë mendoj se nuk do ta bëjë kurrë këtë, një person pavarësisht fuqisë që e ka nuk mund të marrë vendime për një popull dhe për një shtet. Edi Rama duhet ta pastrojë fjalorin dhe duhet ta kuptojë se nuk është i mandatar nga askush të jap cilësime si gënjeshtar, plehra, budalla, këndues maje plehu etj. Derisa të merret me këto cilësime vetëm sa do ta ushqejë palën tjetër të përgjigjet me të njëjtën monedhë. Nëse Edi Rama nuk qenka udhëheqës ideal për Shqipërinë dhe shqiptarët, merreni me mend atëherë alternativën që po ofrohet përmes protestave të dhunshme - Lul Bashën, si dash i gjyshit digjital, Sali Berishës! Edi Rama duhet t'i vejë kapak gojësi sikur edhe liderët kosovarë që nuk sillen aspak më qytetëruar se Edi Rama! Edi Rama duhet ta kuptojë se Shqipëria pa Kosovën kurrë nuk do të bëhet shtet për së mbari dhe se, gjithashtu, pa Kosovën nuk ka fare ardhmëri. Nëse Shqipëria llogaritet se është truri i Shqipërisë dhe shqiptarisë, Kosova pa asnjë dyshim ka qenë, është dhe do të mbetet zemra e Shqipërisë dhe shqiptarisë. Lexojeni historinë dhe do të bindeni për këtë! Përkundër të gjithave, Shqipëria asnjëherë më parë nuk ka qenë më mirë se që

është tani!
Kosova: Ishte dhe mbeti eksperiment i ndërkombëtarëve, kurse tani është shndërruar në monetë për barazim midis shteteve sikur edhe për ndërtim të paqes! Bashkësia ndërkombëtare asnjëherë nuk e kishte seriozisht që Kosova të bëhet shtet i pavarur dhe sovran! Po ta kishte këtë qëllim qysh në vitin 1999 (ka qenë më së lehti) do të shpallej pavarësia. Po ta kishte seriozisht nuk do ta shndërronte Kosovën shtet me integritet territorial të ndarë sikur edhe do t'i njihte sovranitetin e saj në tërë territorin e Kosovës. Këtë nuk e ka bërë, nuk e bën as sot sikur që nuk do ta bëjë as në të ardhmen derisa Kosova ta paguajë një çmim të caktuar, qoftë përmes Asociacionit me kompetenca ekzekutive të Serbisë në Kosovë, dhënies të një pjese të territorit apo të ndonjë forme tjetër. Po të kishte seriozisht, Kosova dhe qytetarët e saj nuk do të mbeteshin si zorrë qorre e Evropës, të izoluar dhe pa mundësi të lëvizin lirshëm. Po ta kishin seriozisht ndërkombëtarët nuk do të lejonin kriminalizimin e klasës politike me të cilën kanë vjedhur bashkë! Po ta kishin seriozisht do të ndiqnin dhe gjykonin të gjithë për krime lufte e jo ta formojnë një Gjykatë raciste të Specializuar, vetëm për shqiptarët! Kosova e ka një problem që e përcjellin çdo vend të tranzicion; antivlerat e fitojnë fuqinë e vlerave, kurse vlerat e vërteta marginalizohen. Kosova e bëri në luftë të jashtëzakonshme e që nuk e bëri asnjë vend tjetër, por e dëshmoi qartazi se ata që u sakrifikuuan dhe e bënë luftën nuk patën kapacitet të mjaftueshëm ta udhëheqin vendin! Këta që e bënë luftën ishin pakicë, masa kritike që lëvizi dhe ndryshoi proceset, por se një pjesë e tyre e personalizoi pushtetin duke e abuzuar mundësinë e dhënë dhe të fituar. Nuk ka vend në botë ku një përçarës i luftës, sabotues i luftës, mohues i luftës dhe i cili nuk bëri asnjë sakrificë personale, përveçse e lartësoi hedonizmin, me para të popullit, të ngritet në piadestalin e të më merituarit duke u shpallur "arkitekt i pavarësisë", ndërkaq që të marginalizohet deri në izolim dhe përbuzje kuptimi dhe përmbajtja e çdo përpjekje për çlirim, liri dhe bashkim kombëtar siç ishte sakrifikuari i papërsëritshëm, Baca Adem Demaçi. Disa hajdutë dhe keqbërës nga krahu i luftës e krijuan dhe e pranuan këtë gjendje. Nuk e besoj se Kosova ka ndonjë perspektivë të sigurojë qëndrueshmëri si shtet përveçse kjo do të çojë deri në përfundim të një procesi më normal të mundshëm, bashkimi me Shqipërinë, i cili do të jetë i pashmangshëm. Mund të ketë vonim, por se nuk ka shpëtim! Është brengosës vullneti i disa politikanëve që kanë pranuar të bisedojnë me Serbinë për ndryshim të territoreve duke e dëmtuar panevojshëm territorin e një shteti të përbashkët në të ardhmen, Shqipërisë për të gjithë

shqiptarët. Se sa është e përkushtuar Kosova dhe qytetarët e saj për Shqipërinë, më së miri tregoi tërmeti i fundit ku, përkundër përplasjeve midis politikanëve, populli u organizua 100 për qind. Mos e dhashtë Zoti sepse, nëse nesër Shqipëria do të rrezikohej nga kushdo qoftë, për një javë do të mobilizoheshin 100 000 ushtarë nga Kosova, në mbrojtje të Shqipërisë, pa asnjë dyshim! Edhe Kosova, me këtë gjysmë pavarësie dhe me një sovranitet të dhunuar, ka shumë përparime. Mungon një arsim cilësor, si burim i ecjes para me kuadro të kualifikuara. Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e që do të duhej të llogaritej si ajka e kombit, qysh moti i ka dalë yndyra, si një degë e një partie të caktuar politike e që tash po merret me Çmimin Nobel si dhe me Edi Ramën, pas një gjumi thujaja 15-vjeçar, pa bërë asnjë punë për t'u mbajtur mend për së mbari! Kosova e ka popullin e shkëlqyer, por politikën e mjerë, politikanë kryesisht të pakualifikuar, servilë dhe pa kurriz anatomik! Ata që duan ta tregojnë kurrizin, ashtu si ua ka falur Zoti, ose shkojnë në margjina ose në

Hagë!
Maqedonia e Veriut, e Jugut, e Lindjes dhe e Perëndimit: Shqiptarët e këtij shteti kanë qenë të ndarë në dy pole dhe u kanë shërbyer në radhë të parë maqedonasve e pastaj dy dinastive; të Menduh Thaçit dhe të Ali Ahmetit që janë në pushtet që nga koha e neolitit! Këta e kanë gjuhë amtare shqipen, por se nuk kuptohen mes vete pasi nuk flasin pa përkthyes, qoftë ai të jetë Nikolla Gruevski apo Zoran Zaev. Tash aq shumë janë marginalizuar sa që më nuk iu duhen asnjë partie maqedonase, prandaj tërë luftën e bëjnë duke luftuar njëri-tjetrin. Politikisht, pas këtyre zhvillimeve të fundit partitë politike nuk i lusin shqiptarët për koalicion, por se shqiptarët i lusin partitë maqedonase t'i marrin në gjirin e tyre, sa për të mbijetuar dhe thënë se janë pjesë e pushtetit! Tash në skenë janë aktualizuar disa hajdutë të Fondit Vendlindja Thërret, nën petkun e analistit dhe parashikuesit, patriotit dhe moralizuesit, ndonëse nuk kanë lënë hajni pa bërë! Shqiptarët në Maqedoni nuk u mundën nga maqedonasit, por se e mundën veten duke u bërë kre-

jtësisht të pavlerë dhe jondikues! Tash, meqë janë diskredituar në nivelin lokal, po merren me politika botërore!
Mali i Zi: Shqiptarët i gëzojnë të gjitha të drejtat e njeriut, të drejtat politike dhe civile, të drejtat për organizim dhe protesta, të drejtat për arsimim në gjuhën amtare në të gjitha nivelet, pa asnjë kufizim dhe pa asnjë diskriminim, sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Të gjitha këto të drejta i kanë të garantuara dhe i gëzojnë... në Shtetet e Bashkuara të Amerikës!
Lugina e Preshevës: Shqiptarët e Luginës të gjitha shpresat, por edhe vetë janë të varur nga topet e Hashim Thaçit. Sidomos për bashkim me Kosovën, sikur Muça pas daive! Mbeshtetje kjo e pasigurt dhe e paqëndrueshme, anatomikisht dhe politikisht!
Gëzuar dhe urime Viti i Ri 2020 për të gjithë lexuesit e "Epokës së re" dhe për të gjithë ata që më lexojnë dhe më kritikojnë (duke mos besuar se ka të tillë)!
Për shqiptarët gjithmonë do të ketë shpresë për aq sa ekziston Shqipëria, ndërkohë që Shqipëria është e përjetshme.
Gëzuar!

Publicitet

 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	 KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN MUNICIPALITY OF LIPJAN
DREJTORIA E ARSIMIT	
Nr-4-111-80429 Datë: 27.12.2019 Në bazë të nenit 16 dhe 62 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, Ligjit të punës Nr 03/L-212, Ligjit për Arsimin në Komunitet dhe Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, neni 5 pika C, Statutit të Komunës së Lipjanit, U.A Nr.10/2018 (MASHT) dhe U.A Nr.07/2017 (MPMS), Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan shpall:	
KONKURS	
Për plotësimin e vendeve të punës	
I. SHFMU "Zenel Hajdini" në Gadime, p.n.f Vrellë 1. Një (1) Mësues/e klase (deri më 30 qershor)	
II. SHFMU "Nezë Bujani" në Bujan 1. Një (1) Mësues/e klase (deri në përfundim të pushimit mjekësor)	
III. SHFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, p.n.f Brus 1. Një (1) Arsimtar/e për Fizikë (8 orë) (deri më 30 qershor) 2. Një (1) Arsimtar/e për Tik (5 orë) (deri më 30 qershor)	
IV. SHFMU "Katër Dëshmorët" në Krojmir 1. Një (1) Mësues/e klase (deri më 30 qershor)	
V. SHMP "Adem Glavica" në Lipjan (Ekonomia bujqësore) 1. Dy (2) Punëtor/e teknik	
Kushtet e kërkuara: <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitje adekuate profesionale, në bazë të normativit 10/2018 (MASHT), • Diplomë (Çertifikatë) fotokopje të vërtetuar nga organi përkatës (në formatin A4), • Çertifikata e lindjes, • Letërnjoftimi – fotokopje, • Dëshmi se nuk jeni nën hetime. 	
Dokumentet e pranuar nuk kthehen.	
Njoftim: Informimi i kandidatëve aplikues rreth mbajtjes së testit me shkrim, intervistës me gojë dhe shpallja e rezultateve do të bëhen në Web faqen e Komunës https://kk.rks-gov.net/lipjan/ dhe në tabelën e shpalljeve.	
Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbime me Qytetar në Komunë në sportelet Nr.1-2 dhe dorëzohen në të njëjtën vend, bashkë me dokumentet për konkurim. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.	
Drejtori i DKA-së Rësim Hasani 	

Flet shkruesi i Deklaratës së Pavarësisë, Shyqri Nimani

Qeveria nuk ma pagoi honorarin, Deklarata e Pavarësisë mbetet pronë e imja artistike dhe historike

Nga mbrëmja e 16 shkurtit 2008, Shyqri Nimani, profesor i Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës, kaligrafisti i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, ka treguar shumë gjëra interesante. Ai për 16 orë rresht kishte punuar në Deklaratën e Pavarësisë, por që nga ajo kohë, tashmë mbi dhjetë vjet të kaluara, askush nga qeveria nuk e ka ftuar për nënshkrimin e kontratës për punën që ka bërë. "Sidoqoftë, tani e përgjithmonë, deri në pagesën e honorarit, Deklarata mbetet pronë e imja artistike dhe historike", ka thënë Nimani për gazetën "Epoka e re". Në këtë intervistë dhënë për numrin festiv të fundvitit, ai ka folur edhe për emocionet gjatë shkrimit të tekstit të Deklaratës së Pavarësisë në formatin A/4



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - "Epoka e re": Z. Nimani, për 16 orë rresht kishit punuar në Deklaratën e Pavarësisë dhe e kishit përfunduar pesëmbëdhjetë minuta para orës 15:00. Na tregoni rreth atyre çasteve.

Nimani: Ç'është e vërteta, në ato çaste unë kam pasur dy lloj ndjenjash të gërshetuara njëra me tjetrën, emocione dhe ankthe. Natyrisht se emocionet kishin të bënin me të qenit i vetëdijshëm se po ndodhte, më në fund, ajo ngjarje historike e shumëpritur e shqiptarëve dhe se fati kishte vendosur që unë ta kaligrafoja (bukurshkruaja) artistikisht me dorën time këtë akt të rëndësishëm të parë. Nga ana tjetër, ishte ankthi i madh që më kaploi kur kuptova atë mbrëmje se ishin tri faqe të plota të tekstit të Deklaratës në formatin A/4, të cilat unë do të duhej t'i kaligrafoja në pergamenë (lëkurë vici). Paraprakisht unë u kisha thënë se do të më duheshin së paku shtatë ditë për këtë ndërmarrje të ndërlikuar, gjithë një duke menduar se teksti do të përmbante vetëm një faqe kompjuterike, A/4. I gjendur në këto rrethana të pavolitshme, unë nuk kisha zgjidhje tjetër pos t'i përvishesha punës me të gjitha fuqitë e mia të mundshme. Unë kisha marrë me vete të gjitha veglat dhe materialet e domosdoshme në zyrat e Qeverisë (meqë kështu më kishin kërkuar). Për çdo rast, kisha marrë me vete dy fletë të mëdha pergamene të formatit A/2 (420 x

594 mm). Kjo u tregua e arsyeshme sepse, pos tekstit shumë të gjatë të Deklaratës, duhej të llogaritej hapësira edhe për 120 nënshkrimet e kuvendarëve të Kuvendit (morën pjesë 109 gjithsej) si dhe për nënshkrimet e kryeministrit, presidentit dhe të kryetarit të Kuvendit.

Edhe pse, për një çast, kur koha e dorëzimit të Deklaratës po afrohej pamëshirshëm - mendova se nuk do t'ia dilja, se për herë të parë në jetën time artistike do të dështoja, por ishte djali im, Agoni, (i cili tërë kohën e 16 orëve ishte me mua dhe me fotografonte kohë pas kohe), i cili më fuqizoi me fjalët e tij inkurajuese se 'do t'ia dalësh'. Dhe vërtet ia dola. Pastaj, të kënaqur, morën Deklaratën dhe nxituan për në Ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, e cila, fatmirësisht, ishte fare pranë godinës së Qeverisë së Kosovës.

"Epoka e re": Kryeministri i atëhershëm, z. Thaçi, erdhi dhe jua mori dokumentin. Çfarë ju tha në ato çaste, cili ishte komentit i tij i parë?

Nimani: Duhet të theksoj se kryeministri i atëhershëm, z. Hashim Thaçi, që nga fillimi i përgatitjeve dhe konsultimeve tregoi interesim të jashtëzakonshëm. Ai vinte kohë pas kohe gjatë procesit të kaligrafimit dhe shikonte me vëmendje shumë të përqendruar. Me të vinin edhe disa bashkëpunëtorë të tij, si Hajredin Kuçi, Vlora Çitaku... andaj, kur ai erdhi me një grup të vet dhe me gazetarin Blendi Fevziu, së bashku me kamera-

manin e TV KLAN të Tiranës, unë sapo isha duke e përfunduar kaligrafimin; ishin pikërisht 15 minuta para orës 15.00 të pasdites së 17 shkurtit të vitit 2008. Kur e panë të gjithë Deklaratën e kaligrafuar të përfunduar, ata shfaqën në fytyrat e veta befasinë admiruese.

"Epoka e re": Është bërë e tëra fund e krye siç e kishit paramenduar, apo ju ngeli edhe diçka tjetër merak në punën tuaj për Deklaratën e Pavarësisë?

Nimani: Kufizimi drastik i imponuar nga afati kohor dhe nga papërvoja e punëdhënësit institucional në rastin e kaligrafimit të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, sigurisht se më ka penguar për realizimin e detyrës sipas paramendimit tim, që do të thotë sipas kanoneve të përcaktuara tradicionalisht. Unë kam dashur ta kaligrafoj Deklaratën me një font më të veçantë shkronjash, me iniale ornamentale, me iluminacione shembëllesash florale dhe faunale, me ngjyra të llojeve nga më të ndryshmet dhe me zburimet e toneve të pigmenteve fluorocente si dhe me ngjyra bronzi të argjendta dhe të arta. Por, kam qenë i detyruar ta konvertoj konceptin paraprak, mbase ta quaj 'pispillosës', në atë më të 'reduktuar' - me për-

dorimin e vetëm një ngjyre, të së zezës dominuese, me shkronja të përmbajtura dhe më të lexueshme të stilit italik - me ritëm dhe dinamikë subtile. Sepse m'u kujtua dhe vendosa ta ndërlihdja me tipin e shkronjave italik me të cilin është kaligrafuar dokumenti ynë i lashtë dhe i mirënjohur 'Formula e pagëzimit' (1462) nga kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli. Megjithatë, më vjen shumë mirë që edhe dokumenti i shpalljes së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (4 korrik 1776) është kaligrafuar thjesht dhe vetëm me një ngjyrë dhe i përngjan dukshëm dokumentit tonë.

"Epoka e re": Çfarë s'është thënë deri më tani rreth punës së kësaj deklarate?

Nimani: Mbase ka dhe shumë gjëra të tjera që nuk i kam thënë deri më tani. Një nga to është çështja e kontratës së autorësisë dhe e pagesës së honorarit. Mbrëmjen e 16 shkurtit 2008, kur unë isha duke u përgatitur ta bukurshkruaja Deklaratën në godinën e Qeverisë, më takoi Abedin Qupevaj, shef i protokollit, i cili më kërkoi që në kontratën që do ta bënim të figuronte që, pos meje, edhe Qeveria e Kosovës të ishte bashkautore e Deklaratës. Unë i thashë se për këtë çështje as që

mund të mendoja, ngase unë po mendoja vetëm për mundësinë e kryerjes së kaligrafimit në këto rrethana të vështira. Nga ajo kohë e deri më tani, tashmë mbi dhjetë vjet të kaluara, askush nga Qeveria nuk më ka ftuar për nënshkrimin e kontratës e as unë nuk kam vajtur atje. Sidoqoftë, tani e përgjithmonë, deri në pagesën e honorarit, Deklarata mbetet pronë e imja artistike dhe historike.

"Epoka e re": Si ndiheshit ju derisa lexohej deklarata në seancën solemne dhe si ndiheni tani, kur jeni autor i dokumentit më historik të Kosovës?

Nimani: Kur e morën Deklaratën e kaligrafuar unë u ndjeva aq i çliruar, sa më dukej se hoqa nga vetja atë barrën e madhe të Sizifit nga trupi. Meqë unë dhe biri im, Agoni, ishim shumë të rraskapitur pas një pune të pandërprerë 16-orëshe dhe pa rroba solemne, aktin solemn të shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës e përjetuam me anë të ekranit televiziv në një nga hapësirat e Qeverisë. Përjetimi i atëhershëm ishte i papërshkrueshëm - lumturi ngashënjesë, marramendëse. E sot, fatkeqësisht, ai entuziazëm dhe magjepsje paksa (apo bukur shumë) është venitur. Por, prapëseprapë, pas shiut lind dielli.



NJËZET VJETËT E LIRISË, TREGUES SE NGA DUHET ECUR NË ARDHMËRI



Nga Jakup KRASNIQI

Po e mbyllim këtë vit, 2019, një nga më të vështirët e jetës sonë politike, si në kulturën e komunikimit ndërshqiptar, thua se ne shqiptarët e kemi mënyrën më të vështirë të komunikimit për t'u marrë vesh edhe për çështjet më vitale të vendit, si në keqqeverisjen e skajshme e në papërgjegjësitë institucionale pothuajse totale. Nëse analizojmë me kujdes e profesionalizëm politik, me kritikë e vetëkritikë, atëherë nuk do të jetë e vështirë që në 21-vjetorin e lirisë e 12-vjetorin e pavarësisë, ta gjejmë rrugën e duhur për ta qeverisur shtetin e për shtetin më të ri të Evropës, me integritet e dinjitet, me përgjegjësi e përkushtim. Por, siç dëshmojnë qartë e dhembshëm vitet e shkuara, të pazëvendësueshmë e të pandryshueshmë që kanë lindur për "kryeministra" e të "parët" e partive politike, nuk janë të gatshëm të dëgjojnë asgjë që nuk është në fjalorin e tyre të varfër për komunikim institucional e publik, e më së paku të dëgjojnë diçka që nuk është në interesin e ngushtë të tyre. Ndërsa i kemi parë se sa pak ishin të interesuar për funksionimin normal të shtetit. Mbase kjo ka bërë që asnjë qeveri e pas pavarësisë të mos e çojë deri në fund mandatin kushtetues. Vetëm ky fakt në vetvete flet shumë.

Ndoshta, në një masë, gjatë këtyre viteve dikush edhe mund të arsyetohet se na ka munguar tradita qeverisëse, se na kanë munguar dija dhe kultura për të qeverisur mirë etj. Mbase edhe mund të thuhet kështu, por pse ata që morën përgjegjësinë për ta qeverisur shtetin rreth vetes nuk ofruan njerëzit që kishin dije dhe përvojë institucionale, pse nuk ofruan njerëz që do t'u ofronin e propozonin këshilla për qeverisje të mirë, pse nuk e bënë asnjë përpjekje që t'i kërkonin njerëzit kompetentë në asnjë institucion shtetëror a publik, por afër vetes ofruan njerëz të rinj të papërvojë e pa dijen e duhur, njerëz të afërm e të

dëgjueshëm njerëz, siç do të thoshte me plot të drejtë poeti e satiriku ynë Ali Asllani, "të lepeve e peçeve"? Natyrisht poeti fliste për qeverisjen e kohës së tij, e cila s'ishte gjë tjetër vetëm një qeverisje satrapiste, që prodhonte padije, mjerim e maskarenj me brirë. Këto janë disa pyetje që kërkojnë përgjigje adekuate. Por, e gjithë çështja është, kush të përgjigjet? Dhe a mund të përgjigjen ata që të vetmen gjë që dinë më se miri është vetëlavdërimi e kapadailëku. Vetëlavdërimi nuk është dije për të qeverisur, por dinakëri e maskarallëk që s'i duhet askujt. Koha jonë po kërkon me urgjencë që kjo praktikë e të qeverisurit duhet të ndërpritet një sahat e më parë. Është dhembje e madhe. Pse këta që qeverisën keq pas pavarësisë, në shumicën e kohës, kanë kompromentuar vlerat sublime të Lëvizjes Kombëtare Klandestine për Çlirim. Njerëzve që kanë luftuar duhet t'u njihen meritat gjithsesi, por jo t'u jepet mundësia për të qeverisur keq, madje tepër keq me çdo pasuri kombëtare, njerëzore e materiale. Edhe këtë patëm rast ta shohim e stërshohim gjatë këtyre viteve të lirisë.

Të gjithë duhet të pajtohemi dhe, besoj shumë që shumica pajtohemi, se pas njëzet vjetëve të lirisë e dymbëdhjetë vjetëve të pavarësisë, keqqeverisja, padija e papërgjegjësia për të qeverisur duhet të përfundojnë dhe kjo ka kohë që është bërë domosdoshmëri. Mbase, bashkë me këto duhet të shkojnë edhe rrahgjoksë të stilit "unë e solla pavarësinë", e njerit apo "unë e bëra ushtrinë" e tjetrit! Ky farë brumi bajat nuk do ta sillte asnjërin as tjetrën. Ata nuk mësuën nga Skënderbeu i cili meritat ua linte shqiptarëve e jo Kastriotit! Ka të ngjarë që ky soj i njerëzve as ka mësuar e as ka dëgjuar gjë nga kryetrimi e burrështetasi Skënderbeu! Më 6 tetor 2019 qytetarët e ndërgjegjshëm, me zgjedhjet dhe votën e lirë që bënë, i dhanë një mundësi, ndonëse jo të mjaftueshme, një qeverisjeje ndryshe, por a do të jetë ndryshe, këtë duhet ta shohim. Nuk ka asnjë dyshim, fillimi i një qeverisjeje të mirë është interes i të gjithë qytetarëve të Republikës sonë pa përjashtim. Të shpresojmë se ndryshimi po vjen. Por, populli thotë:

"Pranvera nuk vjen me një lule!"

A ka shpresë për ndryshim cilësor?

Po që se shikojmë me një sy kritik cilësinë e zgjedhjeve, kam frikë se shumë shpresa nuk ka, por nihilistë nuk duhet të bëhemi. Ndonëse një pjesë e të zgjedhurve nuk e kanë përvojën e tyre politike, intelektuale e, besa, as institucionale, ka nga ata që bartin me vete përvoja jo të mira dhe, ndonjëri, edhe pse edhe më parë ishte në shtëpinë e përfaqësuesve, nuk na ka bindur se ka ndonjë paraqitje që mund të mbahet në mend për të mirë. Sigurisht që nuk është mirë që askush të paragjykohe, ashtu që nuk është mirë që askush të paravlerësohet. Ajo që dihet deri më tani është se disa individë kanë pasur një jetë goxha të gjatë në angazhimin politik të dëshmuar, aty ku kanë qenë të angazhuar kanë lënë shije të mirë dhe kanë treguar kompetencë mjaft të mirë në ushtrimin e detyrave. Këtyre njerëzve, që kanë një përvojë të mirë jetësore e bagazh politik, zgjedhësit nuk ua dhanë mundësinë e përfaqësimit! Pse ka ndodhur kjo, përgjigjen duhet ta japin vetë ata. Por, kushdo që gjatë këtyre viteve i ka përcjellë zhvillimet politike në Kosovë, nuk ka si të mos shikojë këto zhvillime me një dozë skepticizmi. Në një situatë të tillë, njeriu duhet të thotë: qofsha i gabuar!

Një praktikë e mënyrë të qeverisjes e kemi parë që njëzet vjet

dhe mos e pafshim më! E kemi parë se dëshira për të qeverisur nuk do të thotë asgjë. Se mungesa e dijeve, e përvojës për të qeverisur; se mungesa e përkushtimit dhe e përgjegjësisë politike, intelektuale e kombëtare; se mungesa e kompetencës në ushtrimin e detyrave institucionale janë pengesat kryesore për një qeverisje qoftë edhe mesatare. Gjatë gjithë këtyre viteve që i kaluam në liri e pavarësi nuk kam parë e as dëgjuar as edhe një herë të vetme një garë fer e parimore në mesin e partive politike, që kanë marrë të drejtën për të qeverisur, sekush nga anëtarët e kryesisë apo kryesive do të ishte më kompetent për t'i marrë përgjegjësitë ekzekutive e sekush ato përfaqësues. Kjo logjikë e përdorur gjatë 20 vjetëve të lirisë e 12 vjetëve të pavarësisë është dëshmi se në partitë tona politike, që kanë dalë fituese në zgjedhje, nuk ka pasur debat të mirëfilltë se a do të qeverisin mirë, por kushdo të fitojë një pozitë nga i plotfuqishmi despoti i partisë. E, zakonisht, despoti i partisë ka zgjedhur pushtetin real, kryeministrin ose pozitën ceremoniale, atë të kryetarit të shtetit (presidentit) në rastin tjetër. Edhe pozitën e tjera janë varur kryekreje nga vullneti i Zeusit të partisë politike! Parti politike që nuk e kanë as transparencën e partive moniste (komuniste) të shekullit të kaluar. Logjika e unit, pa parë jashtë unit, është logjikë primitive dhe s'mund të

kishte rezultat tjetër, veç atyre që kemi parë tashmë.

Ne, të gjithë, duhet ta dimë se gjatë gjithë këtyre viteve të lirisë e të pavarësisë ka sunduar kjo frymë despotike, e cila frymë na ka sjellë këtu ku jemi: te mjerimi institucional, te degradimi i përgjithshëm edukativ e arsimor, te jozhvillimi (stagnimi), te korrupsioni galopant, te papërgjegjësia për ta përdorur si duhet e ku duhet paranë publike, te mungesa e funksionimit të drejtësisë dhe të institucioneve të tjera të pavarura të shtetit. Kjo mënyrë e të qeverisurit ka sjellë pakënaqësinë qytetare, paper-spektivën, sidomos të rinisë, ka sjellë zbrazjen e fshatrave në drejtim të qyteteve, të zbrazjes së Kosovës dhe uljen e natalitetit, me plakjen e popullsisë.

Çuditërisht, me këto fenomene nuk po merret askush, sikur nuk është duke ndodhur asgjë rreth nesh. Të gjitha këto fenomene negative marrë së bashku po e dëshmojnë arrogancën dhe papërgjegjësinë e atyre që na qeverisin gjatë këtyre viteve! Dhe duhet thënë e stërpërsëritur: na qeverisën deri sot si është më së keq!

Koha është për ndryshim, por edhe ndryshimi i ka paqartësitë e veta! Jam i bindur se qytetarët do të dëshironin të kenë kthjelltësi të plotë në qeverisjen e vendit.

Të shpresojmë se ndryshimi po troket!

Të shpresojmë që ndryshimi po vjen për qytetarët dhe jo për bajraktarët!








Mehmet
Akif
Schools



International
School of
Prishtina



20
VJETORI



Me rastin e ndërrimit të viteve, i urojmë të gjithë mësuesve, nxënësve, prindërve, stafit akademik, vëndit tonë dhe gjithë njerëzimit shëndet, lumturi, suksese, vëllazëri, paqe dhe mirësi në këtë vit të ri që e presim me ndjenja të ngrohta dhe me shpresë.

*Gëzuar
Vitin e Ri 2020*

BALLKANI NË UDHËKRYQIN GJEOPOLITIK



Dr. Edita TAHIRI,
*ish-zëvendëskryeministre
dhe kryengeociatore*

Ballkani është zënë peng nga gjeopolitika. Ky është një moment definimi i diagnozës së rajonit tonë. Derisa në këto dy dekada përpjekjet u orientuan për paqe dhe stabilitet dhe për integritet euroatlantike të gjithë shteteve të rajonit tonë, përveç Serbisë, sot asnjëra nga këto procese nuk janë të përfunduara. Arsyet janë të ndryshme, ndërsa përgjegjësia është edhe kombëtare edhe ndërkombëtare. Mirëpo, arsyeja kryesore pse paqja mbeti e papërfunduar që askush më nuk mund ta kontestojë është lejimi i lojërave gjeopolitike në Ballkan. Kjo përkundrazi faktit që Ballkani, përkatësisht Evropa Juglindore, kanë një peshë të veçantë gjeopolitike dhe janë përcaktuar për gjeopolitikën perëndimore euroatlantike, përveç Serbisë që mban anën e Rusisë dhe të gjeopolitikës euroaziatike.

Ndarje e re e vijave gjeopolitike u bë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, kur shtetet që dolën nga zhbërja e ish-Jugosllavisë, përfshirë këtu Kosovën, u përcaktuan qartë për rendin demokratik dhe gjeopolitik perëndimor si dhe u përkrahën nga Perëndimi, ShBA-ja dhe partnerët evropianë, në luftën e tyre për liri dhe pavarësi. Në këtë fitore të madhe të ëndrës për liri dhe pavarësi dhe përcaktimit gjeostrategjik drejt Perëndimit, pak iu dha rëndësi faktit që në mes të Ballkanit ishte Serbia e cila si "Kali i Trojës" po punonte për interesa gjeopolitike ruse e të aktorëve të tjerë që përmbledhen në një emërues të përbashkët të ambicieve të neohegjemonisë nga vende joperëndimore, humbësve të Luftës së Ftohtë. U injoruan deri në masë të palejueshme lojërat e rrezikshme të Serbisë, e cila me një anë gjoja synonte evropianizimin dhe anëtarësimin në BE, ndërsa në anën tjetër po armatoset çdo ditë e më shumë

nga Rusia për ta marrë rolin e neohegjemorit në Ballkan.

Çfarë ndodhi?

Së pari, jo se në vendet e Ballkanit nuk kemi vizion të qartë për integritetin euroatlantik, por mbase nuk mund ta demonstrojmë përmes reformave të thella, për shkak të urisë së madhe për korrupsion dhe pasurime personale, duke i lënë vendet tona mjaft të dobëta dhe të pazhvilluara. Kjo madje cenoi vlerat e liberalizimit dhe demokracisë duke prodhuar autokraci ndër elitat politike. Ndërkohë, mungesa e perspektivës ekonomike po nxitë ikjen e rinisë nga vendet tona.

Së dyti, ne u përballëm kohët e fundit me një Bashkim Evropian që fliste me dy zëra në disa çështje gjeopolitike për Ballkanin. Unë pashë dy Evropa. Shpresojmë të unifikohet tani kur erdhi udhëheqja e re. Një zë i Bashkimit Evropian i disa zyrtarëve që me lehtësi e komoditet hapën hapësirë për ide të rrezikshme për ndryshimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Jam e sigurt që të tillët nuk ishin në dijeni se çfarë do të thotë kjo për paqen dhe gjeopolitikën në Ballkan dhe Evropë, pra tentuan ta prekin një kufi duke mos ditur se do të përhapej gjithandej në rajon si dhe do të rritej ndikimi gjeopolitik rus përmes "Serbisë së madhe". Ç'është më e keqja, kumbarë të kësaj pune djallëzore ishin presidentët e Kosovës dhe Serbisë dhe çuditërisht dhe pa nevojë, edhe kryeministri i Shqipërisë. Kjo çështje dështoi falë kundërshtimit të plotë nga Kosova dhe kombi shqiptar dhe qëndrimit të prerë kundër të Gjermanisë dhe kancelares Merkel, dhe mbështetjes nga aleatët e tjerë perëndimorë, përfshirë ShBA-në, Mbretërinë e Bashkuar dhe Francën. Gjermania dhe fuqitë e tjera udhëheqëse Evropiane ishin zëri i Evropës konsekuente që po vazhdonte t'i mbajë premtimet e dhëna në agjendën e Selanikut më 2003 për integritetin e gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Së treti, blloku transatlantik u përballë me sfida. Projekti paqësor për Ballkanin Perëndimor përmes integritetit të vendeve të Ballkanit të BE-së dhe NATO mbeti i papërfunduar edhe pas

njëzetë vjet përpjekje. Reformat e brendshme, lodhja nga zgjerimi, mungesa e konsensusit për disa çështje jetike krijuan hapësirë që lojëra negative të luhen në Ballkan nga Rusia, po as Kina e Turqia nuk mbetën mbrapa. Rusia shkoi aq larg sa ndërhyri që ta pengojë anëtarësimin e Malit të Zi në NATO dhe vazhdon me ndërhyrje Bosnje e Maqedoni përballë kësaj situatë. ShBA-ja dhe partnerët evropianë mbase tani kanë një rikthim të angazhimit në Ballkan. Se rreziku i destabilizimit të Ballkanit po vjen nga Rusia. Tashmë thuhet qartë në qëndrimet zyrtare amerikane dhe të vendeve evropiane, dhe të Mbretërisë së Bashkuar.

Së katërti, marrëveshja paqësore në mes të Kosovës dhe Serbisë ende nuk përfundoi, sepse Serbia nuk ka hequr dorë nga krijimi i "Serbisë së madhe" dhe dominimi gjeopolitik serbo-rus në Ballkan. Kjo për vetë faktin se tri procese paqësore në një periudhë njëzetëvjeçare, në Konferencën e Rambujesë, në bisedimet për statusin në Vjenë dhe dialogun për normalizimin e fqinjësisë mes dy shteteve në Bruksel, nuk sollën një marrëveshje përfundimtare për paqe mes Kosovës dhe Serbisë. Dy të parat Serbia i refuzoi, nuk nënshkroi marrëveshjet as në Rambuje as në Vjenë. Në dialogun e Brukselit ishte pak më bashkëpunuese, mirëpo kur Serbia e pa se gjërat po shkonin drejt përfundimit, braktisi këtë proces për t'u futur në lojëra gjeopolitike për t'i ndryshuar kufijtë në ambicie për të krijuar "Serbinë e madhe". Në dy proceset paqësore në Rambuje dhe Vjenë, faktori ndërkombëtar perëndimor pati plane të qarta. Pas dështimit të Serbisë për ta nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, ShBA-ja dhe NATO intervenuan me mjete të forcës, bombarduan Serbinë, ndalën luftën, gjenocidin serb kundër shqiptarëve dhe Kosova u çlirua. Kur Serbia dështoi ta nënshkruajë Marrëveshjen e Vjenës, Planin e Ahtisarit, Kosova shpalli pavarësinë dhe mori përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë. Në Dialogun e Brukselit u arrit që të integrohet pjesa veriore në sistemin e shtetit të Kosovës, u eliminua çështja e ndarjes së verit dhe Serbisë iu vu kusht Kapitulli 35 për t'u zbatuar marrëveshjet e pazbatuara dhe një

marrëveshje paqësore ligjërisht e obligueshme. Tash dy vjet u bllokua dialogu dhe jo për taksën siç është servuar një narrativë, por për shkaqe të ideve të rrezikshme për prekje kufijsh.

Çfarë po ndodh në të vërtetë?

Ballkani është në udhëkryqin gjeopolitik. Mendoj se ka forca që pretendojnë për ta dominuar Ballkanin përsëri. Në këtë rast është Serbia e cila nuk dëshiron ta shohë Ballkanin e barabartëve. Mirëpo, ka një Evropë dhe një ShBA dhe të tjerët që të shohin këtë dhe ta mbështesin Ballkanin e të barabartëve. Këto ditë u përballëm edhe me idenë e Shengenit për Ballkanin në rajonin tonë, ndërsa ne të gjithë duam të shkojmë në Evropë dhe në botën euro-atlantike. Çfarë janë këto krijesa që i imponohen Ballkanit, që risjellin sisteme gjeopolitike dominimi serbo-ruse, të cilave iu dhamë fund me luftë e me sakrificë me sublime.

Çfarë duhet të ndodhë?

Marrëveshja paqësore në mes të Kosovës dhe Serbisë me njohje të ndërsjellë në kufijtë aktualë, të garantuar nga ShBA-ja dhe BE-ja, është rruga e vetme që sjell paqen e qëndrueshme në rajon. Një marrëveshje që ka për bazë

parimet ndërkombëtare për fqinjësi mes shtetesh që kanë pasur luftë, ku Serbia si palë agresore merr përgjegjësitë për luftën dhe gjenocidin e bërë kundër Kosovës dhe shqiptarëve, merr përsipër obligimet për reparacionet e luftës, respekton vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës dhe pranon suksesionin ku një e teta e pasurisë së ish-Jugosllavisë i takon Kosovës. Ky është opsioni i vetëm që nxjerrë Ballkanin nga udhëkryqi gjeopolitik dhe mënjanon rreziqet për paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe Evropë.

Nuk duhet lejuar më tej që Ballkani të mbetet fushëbetëje gjeopolitike për të tillët që kanë trauma nga humbjet e dominimeve nga Lufta e Ftohtë.

Një plan i qartë gjeopolitik i partnerëve perëndimorë, ShBA, BE dhe NATO, është i domosdoshëm për t'ua prerë rrugën lojërave gjeopolitike që po zhvillohen në Ballkan. Disa nga elementet kryesore të këtij plani do të ishin: përsheptimi i anëtarësimin të Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit në NATO, rritja e pranisë ushtarake amerikane në Kosovë që është e domosdoshme për t'iu kundërvu rritjes së pranisë ushtarake ruse në Serbi, vazhdimi i reformave demokratike, ndërtimi i paqes dhe pajtimit në rajon, integriteti i gjashtë vendeve në BE.





*Happy
New Year
2020*



SWISS **DIAMOND** HOTEL



Prishtina

*Me rastin e festave të fundvitit
Swiss Diamond Hotel Prishtina
ju dëshiron shëndet dhe mbarësi.*

Gëzuar 2020

Flet komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama

Pajisjet e mbrojtjes për FSK-në vijjnë në 2020-n

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka bërë me dije se ushtria e Kosovës ka përmbyllur në mënyrë të suksesshme vitin e parë të tranzicionit. Në këtë intervistë dhënë për numrin festiv të gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ushtria i ka përmbyllur të gjitha objektivat që i ka pasur për vitin 2019. Rama ka treguar se këtë vit FSK-ja ka nënshkruar kontrata të rëndësishme për armatim dhe pajisje të tjera. Ai ka bërë me dije se pajisjet për mbrojtje që janë konform mandatit të ri të FSK-së do të arrijnë në Kosovë gjatë vitit 2020

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR-

"Epoka e re": Z. Gjeneral, po bëhet një vit prej kur ka filluar tranzicioni i FSK-së në ushtri. Si ishte viti i parë për ushtrinë?

Rama: Është bërë një vit që janë aprovuar ligjet për tranzicionin e FSK-së në Kuvendin e Kosovës, ndërsa ne zyrtarisht tranzicionin e kemi filluar më 21 janar. Ajo që mund të them është se tani FSK-ja është shumë më e përgatitur, më e trajnuar dhe shumë më mirë e pajisur. Mund të them se ka qenë një vit i suksesshëm duke i ka kaluar pritjet tona dhe planin që kemi pasur. Ky vit më tepër ka qenë në kuptimin administrativ të tranzicionit të institucioneve në Ministrinë e Mbrojtjes, ku kemi ndërtuar Shtabin e Përgjithshëm. Prioritet tjetër ka qenë ndërtimi i kapaciteteve trajnuese në TRADOK bazuar në mandat dhe mision të ri. Ajo që e kemi arritur këtë vit ka qenë ndërtimi i Gardës Kombëtare të Kosovës, e cila është një njësi e re që nuk ka ekzistuar në të kaluarën. Mbi bazën e plantit tonë afatgjatë dhjetëvjeçar që kemi ndërtuar bashkërisht me partnerët tanë, ne kemi bërë një analizë dhe kemi arritur ta ndërtojmë këtë njësi, e cila është edhe një arritur e jashtëzakonshme. Kemi bërë ndryshimin e manualeve, rregulloreve të doktrinave dhe procedurave të standardeve operative. Bazuar në të gjitha këto aktivitete, del se kemi tejkaluar planin tonë duke u bazuar në misionin dhe mandatin e ri që kemi.

"Epoka e re": Sa sfida ka qenë përmbyllja e objektivave të vitit të parë të tranzicionit?

Rama: Çdo tranzicion i ka sfidat e veta. Nuk mund të them se kemi pasur ndonjë sfidë të jashtëzakonshme apo të patejkalueshme. Një e arritur tjetër që kemi pasur këtë vit është rekrutimi i 700 ushtarëve të rinj, ku i kemi kryer edhe trajnimet bazike. Kemi arritur që

edhe 200 të tjerë t'i kthejmë nga komponenti rezerv në atë aktiv. Pra, FSK-ja këtë vit po e përmbyll me 900 ushtarë të rinj.

"Epoka e re": Në fund të këtij viti si sfida e papritur ishte rasti i tërmetit në Shqipëri, ku ushtria e Kosovës shumë shpejt u mobilizua dhe iu përgjigj kërkesës për ndihmë autoriteteve shqiptare?

Rama: Neve na vjen keq për atë që ka ndodhur në Shqipëri, por në atë rast ne vetëm kemi kryer detyrat tona bazuar në ligjet dhe Kushtetutën e vendit. Ushtria gjithmonë duhet të jetë e gatshme për çfarëdo sfide që do të vijë edhe në të ardhmen. Tërmeti në Shqipëri ka qenë fatkeqësi natyrore, pra një fatkeqësi për shtetin shqiptar. Njësitet tona janë të trajnuara dhe të pajisura mirë për këto raste. Ky veprim i shpejtë është si rezultat i bashkëpunimit dhe përkrahjes që kemi pasur nga partnerët gjatë procesit të ngritjes. Pra, nuk është rezultat apo e arritur vetëm e jona. Pjesë e këtij suksesi që u pa edhe në këtë fatkeqësi janë edhe partnerët tanë strategjikë, të cilët prej fillimit na kanë trajnuar dhe pajisur për këto raste. Tani jemi si qendër regjionale trajnuese për kërkim-shpëtim urban. Por, merita më e madhe është e atyre pjesëtarëve, oficerëve dhe nënoficerëve që kanë marrë pjesë direkt në atë operacion, i cili ka qenë shumë domethënës për shtetin shqiptar. Dhe në këto raste siç dihet detyra e parë e çdo ushtari është shpëtimi i jetëve.

"Epoka e re": Performanca e ushtarëve të FSK-së në këtë aksion ka qenë e lartë. Për të vlerësime kanë dhënë autoritetet shqiptare dhe partnerët ndërkombëtarë të FSK-së. Çfarë do të thonë për FSK-në dhe Kosovën këto vlerësime?

Rama: E përmenda edhe më herët se ky nuk është vetëm sukses i FSK-së, por i gjithë Kosovës. Vlerësimi që na kanë dhënë krerët më të lartë të shtetit shqiptar, prej presidentit dhe kryeministrit,

duke ndarë medalje për njësitet tona, na kanë bërë të ndihemi krenarë. Mua më gëzon fakti se kemi marrë vlerësime të larta edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë, nga ata që këto kapacitete i kemi ngritur së bashku. Natyrisht se këto vlerësime që kemi marrë nga Shqipëria dhe partnerët tanë, por edhe nga vetë qytetarët shqiptarë që kanë pësuar nga tërmeti, na bëjnë të ndihemi krenarë me forcën tonë. Ne vetëm e kemi kryer detyrën tonë si forcë. Pas çdo aksioni ne e kemi procedurën e analizës së pasveprimit ku analizojmë veprimet tonat dhe i nxjerrim mësimet e mësuara, në mënyrë që në të ardhmen të jemi sa më të përgatitur. Ne lutemi që të mos ndodhin fatkeqësi natyrore asnjëherë por, pavarësisht nga dëshirat, ne jemi të obliguar të jemi të gatshëm për çdo sfidë që i kanoset vendit apo vendeve në rajon.

"Epoka e re": Cilat janë objektivat e ushtrisë së Kosovës për vitin 2020?

Rama: Edhe për vitin 2020 i kemi objektivat e qarta. Ne kemi një plan gjithëpërfshirës të zhvillimit. Pra, kemi planin në detaje për secilën njësi se çfarë detyra dhe obligime ka si në kuptimin e ngritjes profesionale, të pajisjeve,

infrastrukturës dhe të gjitha elementeve të tjera. Domethënë, prioritetet tona do të jenë të bazuar në objektivat strategjike të ministrisë dhe ne jemi të obliguar që ato objektiva strategjike t'i realizojmë, duke u bazuar në planin tonë gjithëpërfshirës. Ky vit do të jetë më shumë i fokusuar në trajtimin dhe zhvillimin profesional të të gjithë njësiteve, duke marrë parasysh mandatin dhe misionin e ri. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (TRADOK) do të jetë prioriteti yni sepse do t'i ndërtojmë ato kapacitete trajnuese që janë të nevojshme për misionin dhe mandatin e ri. Për këtë do të kemi përkrahje edhe nga ana e partnerëve tanë dhe nuk shoh ndonjë sfidë.

"Epoka e re": Në cilin vit të tranzicionit pritet të vërehet më shumë ndikimi i FSK-së në raport me forcat e tjera që garantojnë sigurinë në Kosovë?

Rama: Mendoj se këto raporte të ndryshimit vërehen edhe tani, në vitin e parë. Mendoj se do të vërehet çdo vit e më tepër sepse për çdo vit do të vërehen ndryshimet në kuptimin e ngritjes së standardeve. Këto përgjegjësi i kemi mbi bazën e ligjeve që janë në fuqi. Është normale se tranzicioni nuk mund

të përfundojë brenda një kohe të shkurtër. Ky proces do të marrë kohë, por ne do ta bëjmë më të mirën e mundshme në bazë të kapaciteteve që kemi.

"Epoka e re": Po pajisjet me armatim, kur mund të shihen?

Rama: Në këtë drejtim ne kemi filluar pa humbur kohë duke bërë kontrata të rëndësishme këtë vit. Ndërsa në vitin 2020 pritet të arrijnë ato pajisje, sepse pajisjet e mbrojtjes janë pak më specifike dhe kanë procedurë kohore të posaçme që marrin kohë deri të prodhohen duke u bazuar në kërkesat tona. E rëndësishme është që këtë vit i kemi përmbyllur nevojat dhe kërkesat në bazë të mundësisë buxhetore. Pra, kemi nënshkruar kontrata të rëndësishme dhe rezultatet do të shihen vitin e ardhshëm.

"Epoka e re": Mund të na përmendni, nëse ju lejohet, se për çfarë kontrata dhe pajisje bëhet fjalë?

Rama: Do të ishte mirë që këtë t'ia lëmë kohës. Ato pajisje janë në përputhje të mandatit dhe misionit të ri që kemi marrë. E kemi obligim ligjor që t'i ndërmarrim të gjitha masat dhe të jemi të gatshëm për misionin e ri.



Të shkruash për gazetën

Gazeta mund të bëhet artikuluere e idealeve të elitave, me fokus edhe te vlerat kombëtare, intelektuale dhe morale. Kjo është detyrë urgjente e gazetave në vendin tonë. Pse urgjente?



Milazim KRASNIQI


Fillimisht u çudita nga ftesa e Malit i cili po më kërkonte të shkruaja një tekst për numrin festiv të gazetës ditore "Epoka e re". U çudita sepse kur të bëhet një ftesë që të shkruash në gazetë ditore, kjo ftesë e ka brenda vetes një element solemniteti dhe respekti për autorin. Në natyrën e gazetës është përzgjedhja e autorëve sipas një koncepti të fiksuar editorial. Gazeta nuk mund të funksionojë sipas sistemit të kontejnerit, ku hidhen gjërat kuturu, kush çka ka për të hedhur, pa i marrë leje askujt. Me sistemin e kontejnerit funksionojnë mediet e reja, portalet dhe mediet sociale por, gazeta jo. Prandaj, në mediet e reja nuk ka solemnitet, nuk ka kurrfarë respekti për autorët. Në mediet e reja të gjithë janë të barabartë, (përveç pronarëve, të cilët në mënyrë orveliane janë më të barabartë sesa të tjerët). Bile shumica e portaleve i fshehin emrat e autorëve, madje edhe të gazetarëve të vet, duke ua eksploatuar punën, pa ua dhënë kompensimin intelektual, me anën e afirmimit të autorësisë. Ndërsa, në gazetë autori është mbret. Emri i tij shkruhet me germa bold, zakonisht në krye të tekstit, ngatë titullit, i cili, sipas teoricienëve të gazetarisë, merr mbi 60 për qind të vëmendjes së lexuesit. Po pse u çudita nga ftesa e Malit? U çudita sepse e kuptova që gjatë tërë këtij viti kam shkruar vetëm pak tekste për gazetë, pra vetëm pak e kam shijuar solemnitetin e shkrimit dhe vetëm pak e kam gëzuar respektin si autor. Nëse nuk i numëroj tekstet që kam shkruar çdo muaj për revistën "Shenja", rezultati do të më dilte shumë më dëshpërues.

Për deri sa në portale dhe veçmas në "Facebook" e në "Twitter" kam shkruar me qindra tekste, në gazeta mund të numërohen në gishtat e njërës dorë. Ndaj: ujdia m'u shndërrua shpejt në dëshpërim, duke e ditur se atdheu i vërtetë i gazetarisë është vetëm gazeta. Në mediet e tjera gazetaria është më shumë refugjate, që pret gjithnjë përmirësimin e statusit, por pa shpresë se ai përmirësim do t'i ndodhë. Fjala vjen, në televizion teksti gazetar eksklipsohet nga imazhi, në radio nga të folurit, në portale nga titulli sensacional dhe nga reklamat që lëvrijnë nëpër tekst si krimba, në rrjete sociale nga rrethimi i tekstit me ledhe banalitetesh nga të katër anët. Dëshpërimi më bëhet edhe më i madh kur e mendoj gjendjen e gazetave në shtetin tonë. Nëse atdheu i vërtetë i gazetarisë është gazeta, atëherë atdheu i gazetave tona, Kosova jonë e dashur, është një atdhe i pamëshirshëm ndaj gazetave, si ato nënat që i braktisin foshnjat e veta. Fatkeqësisht, vendi/shteti ynë që nga; lirimi ka përdorë një taktikë armiqësore ndaj gazetave ditore. Menjëherë pas çlirimit të vendit, gazetave u është imponua me disa rregullore të UNMIK-ut një kufizim rigoroz neokolonialist. U ndalua që gazetat të shkruanin për kriminelët serbë, (për arsye u mbyll gazeta "Dita") u ndalua të hulumtohej keqadministrimi i prezencës civile ndërkombëtare, u bë e rrezikshme të raportohej mbi veprimtaritë kriminale të bandave që po uzurponin jo vetëm objekte, po edhe lirinë. Gazetave iu hoq edhe e drejta që të ishin medie shqiptare. Gazetave iu imponua që reklamat t'i botonin edhe serbisht, gjë që nuk ishte bërë nga gazeta ditore "Rilindja" as në kohën e Rankoviqit. Prandaj, gazetat mund të ishin shqipfolëse/shqipshkruese, në shërbim të prezencës ndërkombëtare, të njerëzve të fortë të politikës, të biznesit e të nëntokës, por jo të idealeve dhe të vlerave kombëtare shqiptare. Disa gazeta u ndërsyen kundër luftës çlirimtare, disa u

ndërsyen kundër lëvizjes paqësore, ndonjë tjetër u ndërsye kundër intelektualëve, disa kundër myslimanëve, të tjera kundër historisë kombëtare. Siç më pati thënë me një ton të hidhur Dritëro Agolli në vitin 1992, gazeta mori rolin e kobures. Tabela e qitjes së saj u bë shqiptarësia. Por, gazeta nuk po sfidohej vetëm nga presioni i prezencës ndërkombëtare dhe politikës agresive provinciale. Ajo po sfidohej edhe nga teknologjia, e cila gjeti partnerë më servilë në gazetari bërje. Nga ana tjetër, ajo që është më e dhimbshme, lexuesi i gazetës mund të konsiderohet si tradhtar dhe i pabesë. Për 40-50 cent, lexuesi e braktisi gazetën, siç e braktisë një aventurier i shfrenuar, një vajzë të pafajshme e të papërvajë. Me gjithë mbrapshtitë politike, pandjeshmëritë teknologjike dhe tradhtinë e lexuesve, disa gazeta ditore, ndër to edhe "Epoka e re", ende dalin në treg çdo mëngjes. Dalin të varfra dhe duken të vetmuara, si dikush që mbetet në një tavolinë dasme i vetmuar, pasi të gjithë të tjerët janë ngritur në një valle të çakërdisur, ndonëse valltarëve të dehur u duket valle e hareshme. Vetmia e gazetave tona ditore është si vetmia dhe braktisja e kolonelit të Markesit. Për vete ende i blej dy gazeta,

njëren prej tyre "Epokën e re", për diskutime me studentët e vitit të parë në lëndën Hyrje në gazetari. Vërtet ende mendoj se mësimet fillestare mbi profesionin e gazetarisë ende më së miri merren nga analiza e raportimit të gazetave. Në ligjëratën e parë, me ndjenjë humori sigurisht, i ngre para studentëve gazetat dhe i pyes: "A e dini çka janë këto?", për t'ua krijuar një ndjenjë më miqësore ndaj gazetave. Por, kultivimi i dashurisë ndaj gazetave të rinj është mision i vështirë, meqë tashmë medime dominuese janë bërë telefoni dhe kompjuteri, që ofrojnë gazetari falas dhe pothuajse në kohë reale. Sado që të ofrojnë gazetari të keqe, e ofrojnë falas dhe shpejt. Ndaj, mediet e reja nuk mund të konkurrohen nga gazeta. Ç'duhet të bëhet? Kjo do të thotë që gazetat duhet të ndryshojnë: nuk duhet të ndjekin lajmin e raportin, por duhet të fokusohen në zhanre të tjera, në komente dhe analiza për ngjarjet, në intervista atraktive dhe ekskluzive, në reportazhe, në udhëpërshkrime dhe në tekste pikante të marra nga agjencitë globale të lajmeve. Edhe temat politike lokale duhet t'i minimizojnë, ndërsa duhet të rrisin temat nga fusha kombëtare, evokime ngjarjesh nga historia, tekste letrare me vlera artistike të larta, të reja

nga shkenca, trajtime të problemeve të arsimit, integritit, besimeve fetare, globalizimit. Me një kësi riorientimi, gazetat do të mund të rikthenin shkëlqimin dhe ndikimin, sigurisht jo te eshalonet e analfabetëve funksionalë, por te një pjesë e elitave dhe te rinia studentore. Gazeta mund të bëhet artikuluere e idealeve të elitave, me fokus edhe te vlerat tona kombëtare, intelektuale e morale. Kjo është detyrë urgjente e gazetave në vendin tonë. Pse urgjente? Sepse momentalisht, pra edhe me rastin e kalimit nga viti 2019 në vitin 2020, ne e kemi gjendjen e mendimit në krizë alarmante. Ja prospekti shqetësues: anarhistët duan qeveri pa shtet, duan komb shqiptar pa Kosovë. Ndërkombëtarët dhe Serbia duan Kosovë pa shqiptarë. Islamofobët duan Kosovë pa myslimanë. Selefistët duan Islam pa kulturë kombëtare. Si qershia mbi tortë, keqëbërësit e politikës duan shtet pa gazeta. Prandaj gazetat duhet të rezistojnë. Nëse rezistojnë dhe nëse marrin këso këshillash dashamirëse, gazetat mund të ribëhen nga hiri i vet, si feniksi. Për mua, gjërat mbeten të qarta: të shkruash për gazetën, mbetet kënaqësi intelektuale e veçantë. Ndihem si i ftuar në dasmë. Dhe i respektuar si krushk. Mal, të falënderoj për ftesën dhe mundësinë!



Kosova dhe agonia paszgjedhore e qeveribërjes



Shkruan: Prof. dr. Ibrahim GASHI

Pothuajse pa dallim, në të gjitha praktikatat e zgjedhjeve, procesi i formimit të një qeverie të re fillon menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare. Kjo periudhë e paszgjedhjeve pothuajse kudo shoqërohet me një proces të negociimit të partisë fituese me partitë më të vogla, të afërta nga pikëpamja programore për krijimin e koalicionit qeverisës. Ky proces i negociatave përjashtohet vetëm në rastet kur partia e parë ka fituar shumicën (mbi 50 për qind) të ulëseve në Kuvend. Në zgjedhjet e 6 tetorit në Kosovë, çuditërisht ky proces negociues, së paku në nivelin individual dhe mediatik, midis partisë që do të dalë e para në zgjedhje (LV) dhe partisë tjetër e cila pritej që të dilte në mesin e tri të parave (LDK-së) kishte nisur që nga momenti i shpalljes së datës së zgjedhjeve, ndoshta edhe më herët. Edhe gjatë fushatës zgjedhore kjo "miqësi" dhe dëshirë për qeverisje të përbashkët midis këtyre dy subjekteve sa vinte e po forcohej. Liderhipi i LV-së, madje pa u menduar shumë, po u vinte vijë të kuqe të gjitha partive të tjera, duke lënë kështu shtegun e hapur, sipas tyre, të sigurt për koalicion qeverisës me LDK-në. Për më shumë, kishte pasur përpjekje për një koalicion parazgjedhur midis këtyre dy subjekteve, për të evituar kështu çfarëdo befasie. Përpjekja për këtë koalicion filloi t'i shpërfaqë diferencat e mëdha rreth mandatarit të ardhshëm, deri në masën sa ta pamundësojë arritjen e këtij koalicioni. Mosarritja e këtij koalicioni parazgjedhur bëri që edhe koalicioni i partive qeverisëse (PAN) të mos vazhdohej, por të tri partitë e këtij koalicioni të hyjnë në zgjedhje si të vetme. Epilogu i zgjedhjeve nuk solli shumë befasia, madje në një farë mase ishte i pritshëm. E para doli LV-ja, e cila nuk kishte qeverisur vetë apo si pjesë e koalicionit asnjëherë në nivelin qendror. E dyti doli LDK-ja, e cila në zgjedhjet e fundit (të vitit 2017) kishte qëndruar në opozitë. E treta doli partia më e madhe

nga koalicioni PAN, Partia Demokratike e Kosovës, e pasuar nga AAK-ja. Menjëherë pas zgjedhjeve, madje pa u shpallur zyrtarisht rezultatet, dy partitë pretendente, tashmë të paradeklaruara (LV dhe LDK) i filluan negociatat dhe takimet e grupeve punuese për bërjen e koalicionit qeverisës. Këtu filloi agonia e qeveribërjes në Kosovë, edhe pse në fillim, derisa palët po bisedonin për harmonizimin e programeve dhe krijimin e një programi qeverisës, gjithçka dukej se po shkonte për mrekulli. Deklaratat e grupeve negociuese, pas çdo takimi punues, flisnin me optimizëm dhe siguri të plotë se koalicioni do të bëhej shpejt. Kjo klimë miqësore midis dy palëve, që sforcohej edhe nga deklaratat, pothuajse të përditshme të dy liderëve të këtyre subjekteve, hoqi dilemat në opinionin publik se mund të kishte epilog tjetër veçse krijimin e qeverisë LV-LDK. Këtë të vërtetë filluan ta besonin fuqishëm të gjithë qytetarët, por edhe analistët dhe diplomatët e huaj. Deri këtu gjithçka dukej se po lëvizte në drejtimin e duhur. Këtë alternativë e forcoi edhe deklarimi, që në momentin e shpalljes së rezultateve preliminare, pra ditën që u mbyllën zgjedhjet, i kreut të PDK-së, se partia e tij do të qëndrojë në opozitë.

Fillimin e agonisë qeveribërëse në Kosovë, nga momenti i shpalljes së rezultateve zyrtare nga KOZ-ja, deri në momentin e certifikimit të tyre, e nis dilema se një koalicion i vogël (NISMA-AKR-PD) a do ta kalojë pragun zgjedhor apo jo, duke qenë se ishte në tehun e këtij pragu, pothuajse për javë të tëra. Më në fund, pas proceseve të ankimeve të këtij koalicioni në instancat e parapara më ligj, dhe pas rinumërimit të mbi 70 për qind të të gjithë kutive të votimit, për disa vota ky koalicion e kaloi pragun, gjë që prishi, si duket, llogaritë e dy partive të para që tashmë kishin, siç theksonin ata, përafuar arritjen e koalicionit. Pas futjes së koalicionit NISMA-AKR-PD në Kuvend numri i deputetëve të partive parlamentare shqiptare reduktohej. Koston e kësaj hyrje të mëvonshme të këtij koalicioni të partive të vogla në Kuvend më së shtrenjti e pagoi partia fituese e zgjedhjeve, e cila humbi tre deputetë. Kjo, mbase, ndryshoi pozicionet midis dy partive të para në procesin e

negociatave në procesin e krijimit të qeverisë. Tani LV-ja kishte vetëm një deputet më shumë se LDK-ja. Agonia e vërtetë e qeveribërjes filloi të ndodhë në momentin e fillimit të bisedimeve rreth ndarjes së hises në qeverisjen e ardhshme midis LV-së dhe LDK-së, edhe pse deklaratat e para ishin inkurajuese se nuk ka dallime të theksuara dhe se marrëveshja do të arrihej shpejt. Kjo po ndodhte kur presidenti i Kosovës, konform mandatit kushtetues dhe duke respektuar afatet ligjore, kishte shpallur datën e mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, të Legjislaturës së VII. Ky përcaktim i datës pritej që do t'i lëvizte më shpejt palët drejt tejkalimit të dallimeve dhe arritjes së marrëveshjes për koalicionin qeverisës. Në ndërkohë, sikur po parandienin se diçka nuk po shkonte, edhe ambasadat dhe diplomatët e huaj po deklaroheshin se koalicioni duhej bërë sa më shpejt, sepse këtë po e prisnin qytetarët e vendit, por edhe shtetet mike të Kosovës. Takimet midis diplomatëve dhe të dërguarve të huaj me udhëheqjet e dy partive filluan të shpeshtohen, por koalicioni nuk po ndodhte, pra agonia po vazhdonte. Në fillim ishin mediat dhe analistët e pastaj edhe vetë përfaqësuesit e partive që i nxorën shkaqet e vërteta të

zvarritjes së marrëveshjes. Mënyra se si u plasuan këto në opinionin filloi ta shpërfaqte edhe dilemën se a do të arrihej koalicioni apo jo. Edhe qytetarët e rëndomë pyesnin "a po bahet qeveria a jo", duke vazhduar secili pastaj me narracionin e tij akuzues për njërin, përkatësisht tjetrin partner, varësisht prej afilencave politike që kishin. Agonia po shtohet sa më afër që po afrohej deadline i dhënë nga presidenti. Takimet midis dy liderëve në javët e fundit para mbajtjes së seancës konstituive ishin me dinamikë të shtuar dhe pavarësisht progresit të munguar, ato përfundonin me deklaratat optimistike. Por sa më afër ditës së mbajtjes së seancës konstitutive takimet filluan të pakësohen, deklaratat filluan të jenë më tone ndryshe, ku optimizmi po zëvendësohej me fajësimet e njeri-tjetrit. Më në fund, në ditën e seancës konstituive (26.12.2019), marrëveshja nuk ishte arritur. Opinioni publik, analistët dhe diplomatët e huaj më kot po e prisnin që ai të ndodhte në momentin e fundit, pak orë para fillimit të seancës. Për befasinë e të gjithëve kjo nuk ndodhi, por në vend të saj në seancë po ndodhte një skenar befasues dhe i paimagjinuar nga askush madje, siç duket, as nga vetë dy partitë pretendente për bashkëqeverisje. Themi

kështu sepse LDK-ja kishte paralajmëruar më parë se do ta votonte krijimin e institucioneve vetëm nga LV-ja dhe vetë do të qëndronte në opozitë. Nga ana tjetër LV-ja gjatë rrjedhës së seancës, e bindur se LDK-ja nuk do ta mbante këtë premtim dhe për t'i lënë fajin asaj (LDK-së) për dështim në krijimin e institucioneve, kishte përgatitur skenarin e propozimit të kandidatit për saj për kryetar të Kuvendit, e bindur se ai nuk do të zgjidhej. Kjo situatë e krijuar mund të kuptohet si dështim i LV-së për ta befasuar LDK-në, ku më gjasë ngeli vetë e befasuar, pasi LDK-ja mbështeti kandidatin e saj për kryeparlamentar, duke e zgjedhur atë. Kjo rrethanë e re e krijuar, nëse lexohet saktë, i bie se LV-ja ia mbylli vetes derën për një koalicion të mundshëm me LDK-në, veçse nëse do të vendoste t'i revan-shohej me ndonjë "befasi" të re, hipotetikusht të mundshme, por vështirë të besueshme. Dështimi i arritjes së marrëveshjes dhe konstituimi vetëm i Kuvendit përbën, për qytetarët dhe jo vetëm, kulmin e agonisë apo fillimin e agonisë së vërtetë të qeveribërjes në Kosovë, duke hapur pista dhe skenarë të ri që, sipas probabilitetit më të madh, mund të kenë për epilog një dështim tjetër dhe lëvizje të përsheptuar drejt zgjedhjeve të reja.





Fatkeqësia që nxori në pah solidaritetin që fshihet brenda nesh



Valon MURATI

1. Edhe ky vit që po lëmë pas është vazhdimësi e një trendi në të cilin ka kohë që shoqëria jonë është futur dhe të cilën nuk po arrin ta ndryshojë. Ky është një trend i cili ka mbushur shoqërinë me plot energji negative, ndikuar më së shumti nga gjuha e ashpër e denigruese në politikën tonë, nga mungesa e tolerancës dhe mirëkuptimit dhe e përcjell herë pas here edhe nga një gjuhë jo shumë pozitive e përcjell përmes mediave si dhe ndikimi i rrjeteve sociale në jetët tona. "Lajmi i keq është lajm i mirë" u bë moto që na mbërtheu si shoqëri. Të bërë bashkë parti politike e politikanë, bartës institucionesh, një pjesë e shoqërisë civile, ekspertë, analistë e opinionistë, gazetarë, madje edhe "opinionistë" të rrjeteve sociale kanë shpërndarë aq pesimizëm në shoqëri sa që duhet mund i madh për ta kthyer faqen e këtij procesi nga negative në pozitive, nga pesimiste në optimiste. Sigurisht keqeverisja, abuzimi me pushtetin, korrupsioni financiar e moral, nepotizmi e provincializmi në punësim, dështimet në arsim, ngecjet në shëndetësi, ekonomia gjithnjë në lëngim, çështjet e mprehta sociale, por edhe proceset e rënda politike si dialogu me Serbinë kanë lënë gjurmët e thella në krijimin e këtij ambienti politik e medial. Madje këta janë ndër faktorët kryesorë. Por, gjithashtu, një pjesë të madhe të kontributit në këtë situatë e ka edhe lufta e pakompromis për pushtet jo vetëm e atyre që kanë qenë e janë në pushtet, por edhe e atyre në opozitë, që nuk kanë lënë metodë pa përdorur për të ardhur në pushtet. Në këtë drejtim për njërin palë ato që konsiderohen si të arritura të vendit, për tjetrën trajtohen dështim; ato zhvillime që për njërin palë shihen vetëm bardhë, për tjetrën ato kanë ngjyrën e zezë. Sigurisht se sikur në çdo gjë tjetër në jetë, e vërteta është diku në mes dhe e ngjyrosur me më shumë ngjyra sesa vetëm

bardhë e zi. Por tregimi i të vërtetës në këtë rast duket dhe duket i padobishëm për të gjitha palët sepse, duke mos u brengosur për të, por për fitoren momentale, ata ishin dhe janë të vetëdijshëm se militantizmi që sjell fitoren krijohet dhe mirëmbahet vetëm në ekstremet politike. Dhe nuk ka gjalle se këto fitore të tyre, janë "fitore të Pirros" për Kosovën. Popullizmi me tërë ngjyrat e veta e ka mbërthyer skenën tonë politike, të gjitha partitë kryesore, një pjesë të mirë të mediave, e të mos flas për rrjetet sociale dhe "patriotët kujdestarë" që nuk flenë natë e ditë nga "dashuria dhe dhembja" për Kosovën e kombin. Fatkeqësisht ky është një trend nëpër të cilën po kalon edhe bota demokratike, por duke qenë se ne jemi në fazat e konsolidimit të shtetit tonë të ri, pasojat për ne janë shumë të rënda. Ne nuk kemi luksin e popullizmit sepse ne vazhdojmë të kemi nevojën e konsensusit për të ecur para si shtet e si komb. Ta zëmë sfida e madhe që kemi si shoqëri e si shtet nga dialogu me Serbinë, nga rezultati i së cilës varet stabiliteti i shtetit dhe shoqërisë, nuk tejkalohet me sukses me popullizëm e betejë se kush është më patriot se tjetri, por me mençuri, maturi e konsensus. Por ndonëse askush nuk e mohon publikisht, në thelb askush nuk e synon konsensusin në shoqërinë tonë. Kjo madje po përsëritet edhe në përpjekjet për formimin e qeverisë së re në mes të dy partive që kanë dalë të parat, LVV-së dhe LDK-së duke rrezikuar kështu që ta lënë vendin edhe për një kohë pa institucione dhe të na dërgojnë edhe njëherë në zgjedhje.

2. Në këtë vit plot konflikte politike, energji negative, zgjedhje të cilat sollën ndryshime në skenën politike që gjithnjë për shkak të kësaj qasjeje refuzuese e konfliktuoze nuk po arrin të implementohet, madje ka rrezik të na fusë në cikël politik me plot të panjohura, pati shenja se shpresa nuk ka vdekur në shoqërinë tonë. Këto shenja treguan se shpirti i shoqërisë sonë në brendësi vazhdon të jetë plotë jetë e optimizëm. Kjo u pa më së miri nga solidariteti i shprehur në shoqërinë tonë me rastin e tërmetit në Shqipëri. Kjo fatkeqësi përfaqi tërë energjinë pozitive të fshehur në brendësinë tonë e cila shpërtheu si vullkan dhe e cila do të na

duhej të na ndihmonte që të ringriheshim si shoqëri. Ky shpërthim solidariteti për të ndihmuar bashkëkombësit përveç që ishte një mesazh politik, se ne jemi një, se të gjitha përpjekjet për të përçarë kombin, e mbi hirin e kombit shqiptar në Kosovë të ndërtohet një komb i stisur kosovar, ishte edhe një mesazh shoqëror e njerëzor. Të mbërthyer nga konfliktet e vazhdueshme të brendshme, beteja politike pa parime, nga gjuha e urrejtjes dhe urrejtja e çdo gjëje rreth nesh, shoqëria jonë dhe njeriu ynë, kishte nevojë për të dëshmuar se ka mbetur njeri përkundër të gjithë urrejtjes njerëzore në të cilën po jetojmë. T'ia shtojmë kësaj edhe luftën për ekzistencë, kapitalizmin e egër përcjell natyrshëm me rritjen e motiveve egoiste dhe ftohjen e natyrave tona njerëzore dhe vështrimin e të gjitha raporteve nën prizmin e interesave personale, atëherë ky shpërthim solidariteti ishte një përpjekje për ta përmbysur urrejtjen dhe për ta kthyer dashurinë, për ta injoruar egon dhe për ta dashur publikën e shoqëroren, për ta kthyer në jetën tonë solidaritetin ndër-njerëzor e shoqëror si një vlerë jo vetëm

njerëzore, shoqërore e kombëtare por edhe universale. E solidariteti ka qenë ajo vlerë që ka mbajtur gjallë kohezionin tonë shoqëror e kombëtar në momentet më të rënda të ekzistencës sonë si komb si dhe ka mbajtur gjallë flakën e rezistencës në periudhat më të errëta të historisë sonë.

3. Fatkeqësia në Shqipëri sikur nxori më të mirën nga ne, edhe pse nga pak në mënyrë kaotike e të paorganizuar e, po ashtu, me një eufori të zakonshme për shoqërinë tonë, por e kuptueshme në kontekstin e përpjekjeve për të shpërfaqur ndjenja pozitive e flakur negativitetin nga vetja. Duhet theksuar se edhe ndërhyrja e mekanizmave shtetërorë, sidomos FSK-së, policisë e zjarfikësve në Shqipëri ishte për t'u marrë shembull. Ajo që çaloi fillimisht, si këtu ashtu edhe në Shqipëri, ishte organizimi i ndihmave dhe shpërndarja e tyre. Sidoqoftë, ky solidaritet që tregoi se ne si shoqëri në brendësinë tonë vazhdojmë të mbesim solidarë, ta duam tjetrin dhe të kujdesemi për tjetrin, do të mbetet vetëm një episod në jetën tonë nëse kjo nuk përcillet

me krijimin e një ambienti që do t'i hapë rrugën përparimit shoqëror, zhvillimit të ekonomisë duke pasur parasysh barazinë e njerëzve, zhvillimin e arsimit, kulturës, sportit e shëndetësisë. E këto nuk mund të realizohen nëse do të ketë mungesë të zbatimit të ligjit dhe korrupsion që ndryshk lëvizjen përpara të shoqërisë. E për të ndodhur të gjitha këto na duhet një nivel tjetër i politikëbërjes. Një politikëbërje që jo vetëm bazohet në dije, guxim e zbatim të ligjit, por që bazohet edhe në dashurinë e idealizmin për atdheun dhe të mirën e përgjithshme dhe solidaritetin me njëri-tjetrin. Pa një klasë të tillë politike do ta kemi vështirë që të mirën brenda nesh ta shndërrojmë në të mirë të shoqërisë. Deri atëherë na mbetet të përpiqemi e të mos ndalemi si shoqëri që energjinë tonë të brendshme pozitive ta bartim edhe në politikë, njëkohësisht për ta gjetur rrugën e duhur që në krye të vendit dhe në krye të institucioneve të vendosim njerëzit me këto karakteristika. Urime të gjithëve Viti i Ri 2020!



Flet drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj

Policia ka arritur rezultate në zvogëlimin e krimeve

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se policia vitin 2019 e ka përmbyllur suksesshëm pasi, sipas tij, edhe pse ka qenë një vit me shumë sfida, rezultatet tregojnë se ka pasur një trend të zvogëlimit të krimeve të të gjitha llojeve. Ai ka theksuar se situata e sigurisë në vend është stabile. Sipas tij, nuk ka ndonjë shqetësim që ndikon në sigurinë nacionale të vendit



MESAZHI I QALAJT PËR 2020-n?

"Popullin e Kosovës e uroj për festat e fundvitit. I siguroj se Policia e Kosovës do të angazhohet edhe më shumë për ruajtjen e rendit dhe ligjit në vend. Policia e Kosovës do të angazhohet shumë më shumë për ruajtjen e pronës dhe jetës. Po ashtu, do të ofrojmë shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët apo edhe për ata qytetarë që kalojnë transit nëpër Kosovë".

e gabuar. Statistikat janë indikatorë për gjendjen e sigurisë në trafik, por ne duhet të flasim më shumë për kulturën e ngasjes së automjetit dhe kulturën e sjelljes së qytetarëve në komunikacion që besoj nuk është në nivelin që e dëshirojmë. Ne jemi duke u munduar që me sa më shumë aktivitete vetëdijuese, me sa më shumë kampanja dhe në bashkëpunim me mediet ta bëjmë një sensibilizim të qytetarëve karshi sigurisë në trafik, mirëpo besoj se duhet një qasje pak më ndryshe, duke e përfshirë edhe Ministrinë e Arsimit e cila mund të trajtojë në shkolla fillore këtë fenomen.

"Epoka e re": Si e vlerësoni situatën e sigurisë për këtë vit që po lëmë?

Qalaj: Mund të them se situata e sigurisë është stabile. Nuk kemi ndonjë shqetësim që ndikon në sigurinë nacionale të vendit. Normalisht se incidente do të ketë, mirëpo këto incidente janë të izoluar dhe nuk ndikojnë në situatën e sigurisë së përgjithshme në vend.

"Epoka e re": Po për festat e fundvitit, keni marrë masa për sigurinë?

Qalaj: Ka mobilizim të madh nga ana jonë si institucion. Policia është në gatishmëri për të ofruar siguri për të gjithë qytetarët që këto festa t'i kalojnë sa më mirë.

"Epoka e re": Si ka qenë në 2019-n bashkëpunimi i Policisë së Kosovës me ato të rajonit?

Qalaj: Këtë vit kemi rritur bashkëpunimin me policinë e Maqedonisë së Veriut, me të cilën kemi arritur të kemi një bashkëpunim të shkëlqyer në të gjitha fushat, edhe në fushën e policisë së rendit, në fushën e luftimit të kriminimit të organizuar, edhe sa ui përket ushtrimeve të përbashkëta me njësitë speciale. Po ashtu, kemi bërë nënshkrimin e disa memorandumëve të bashkëpunimit me kolegët tanë në Maqedoninë e Veriut. Kemi bashkëpunim të shkëlqyer edhe me Policinë e Shqipërisë. Gjithashtu, kemi bashkëpunim edhe me Policinë e Malit të Zi. Me të vetmen polici që nuk kemi asnjë lloj bashkëpunimi është Policia e Serbisë.

"Epoka e re": Kosova në 2019-n ka tërhequr aplikimin për anëtarësim në Interpol. A është e gatshme policia në aspektin teknik dhe profesional për të qenë pjesë e kësaj organizate?

Qalaj: Çështja e Interpolit e kalon aspektin e sigurisë pasi është më shumë gjeopolitik. Ju e keni parë edhe më herët se çështjet e ndryshme sa i përket integritetit të institucioneve të Kosovës në mekanizmat e ndryshëm ndërkombëtarë dhe atyre të sigurisë janë duke e lidhur ngushtë me përparimin në dialog. Kjo ka qenë arsyeja kryesore. Ne jemi gjithmonë të gatshëm të jemi pjesë e Interpolit. Policia e Kosovës nuk është vetëm konsumuese e sigurisë, por është në

gjendje të ofrojë siguri edhe për rajonin dhe gjithë botën. Mund të them se edhe nga aspekti teknik dhe profesional Policia e Kosovës është e gatshme të jetë pjesë e Interpolit, mirëpo krejt kjo varet prej zhvillimeve politike në rajon.

"Epoka e re": Sa keni mundur të bëni reforma brenda institucionit që drejtoni?

Qalaj: Reformat nuk ndalen. Ne kemi filluar dhe ky është një proces që vazhdon. Fakti që kemi rënie të madhe të veprave të ndryshme kriminale tregon se reforma po ecën mirë. Po jua jap disa të dhëna të raportit 11-mujor. Duhet ta keni parasysh se rastet kanë shënuar ulje nga 40.447 në 36.536 ose -9.66 për qind, veprat penale kanë shënuar ulje nga 29.535 në 24.631 ose -16.60 për qind, vrasjet kanë shënuar ulje nga 32 në 19, ose -40.62 për qind, lëndimet e rënda trupore kanë shënuar ulje nga 274 në 245 ose -10.58 për qind, po ashtu edhe lëndimet e lehta trupore kanë shënuar ulje nga 2.908 në 2.595 ose -10.76 për qind, vjedhjet kanë shënuar ulje nga 5.402 në 4.131 ose -23.52 për qind, vjedhjet e rënda kanë shënuar ulje nga 4.353 në 3.421 ose -21.41 për qind, grabitjet kanë shënuar ulje nga 261 në 147 ose -43.67 për qind dhe vdekjet e personave në aksidente kanë shënuar ulje nga 110 në 103 ose -6.36 për qind. Çdo sukses për Policinë e Kosovës u dedikohet zyrtarëve policorë në terren, njësiteve policore, hetuesve policorë e të gjithë atyre përfshirë stafin civil dhe atë menaxhues, që me punën e tyre të pakursyer kanë arritur me sukses t'i realizojnë objektivat strategjike të PK-së, të orientuara drejt ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, parandalimit të kriminimit dhe arritjes së rezultateve pozitive në të gjitha fushat policore.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR-
"Epoka e re": Z. Qalaj, si po e përmbyll 2019-n Policia e Kosovës?

Qalaj: Policia e Kosovës këtë vit e ka përmbyllur suksesshëm, duke u bazuar në faktin e rezultateve të mira që kemi pasur. Edhe pse ka qenë një vit me shumë sfida, me shumë ngarkesa dhe aktivitete, rezultatet tregojnë se kemi pasur një trend të zvogëlimit të krimeve të të gjitha llojeve dhe kjo është baza e suksesit të Policisë së Kosovës. Kemi pasur sukses edhe në organizimin e brendshëm të disiplinës. Ne jemi duke punuar në shumë dimensione. Mund të them se krahas sukseseve nuk kemi arritur ta shtyjmë ende çështjen e pensionimit të policëve që ka qenë edhe premtim që nga fillimi i mandatit tim. Po ashtu, edhe çështja e sigurimit shëndetësor dhe jetësor për policët. Sa i përket ligjit për pensionim të parakohshëm, në fakt draftligji ka përfunduar dhe e kemi dërguar në Ministrinë e Financave por, si pasojë dorëheqjes së kryeministrit, procesi u ndal. Një nga sukseset e mëdha ka qenë edhe dërgimi në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri të dy gjeneratave, njëra që ka diplomuar dhe gjenerata e dytë që po vazhdon trajnimin. Kemi pasur gjeneratat më të mëdha për nga numri që nga themelimi i Policisë së Kosovës. Mund të them lirisht se janë edhe gjeneratat më të përgatitura qoftë nga aspekti profesional dhe ai fizik. Besoj se diku nga muaji qershor në vitin e ardhshëm do ta dërgojmë edhe gjeneratën tjetër, meqenëse i kemi vendet e zbrazura në Policinë e Kosovës që ta dërgojmë edhe gjeneratën e re. Nëse kemi fat që të kalojmë Ligjin për pensionim të parakohshëm normalisht se do të rekrutojmë edhe njerëz të rinj për t'i zëvendësuar ata që pensionohen. Besoj se këto tri gjenerata do ta përmbushin nevojën e Policisë së Kosovës për kuadro të reja.

"Epoka e re": Cili ka qenë bashkëpunimi me udhëheqësit

në stacionet policore në komuna?

Qalaj: E gjithë puna e policisë varet nga policët në terren. Policët në terren janë pjesëtarë të stacioneve policore varësisht se ku jetojnë dhe veprojnë. Mund të them se edhe sukcesi i përgjithshëm u adresohet policëve, pasi ata ua ofrojnë ndihmën e parë qytetarëve, pastaj janë eprorët, udhëheqësit e ndërrimeve, pastaj zinxhiri komandues, komandantët e stacioneve të cilët kanë një meritë të madhe për arritjen e këtyre sukseseve.

"Epoka e re": Po bashkëpunimi me stacionin policor në veri, sepse keni pasur edhe aksione ndaj grupeve kriminale.

Qalaj: Kemi pasur bashkëpunim të mirë me kolegët që jetojnë në veri të vendit, natyrisht se kemi pasur disa sfida edhe të natyrës politike. Situata në veri është shumë më mirë sesa në vitet e kaluara. Prapëseprapë i kemi disa probleme, mirëpo mund të them se bashkëpunimi i kolegëve që punojnë në veri dhe pjesës tjetër të Kosovës është i mirë. Pavarësisht prej aksioneve që ka pasur policia në veri nuk kemi pasur asnjë shqetësim nga banorët lokalë. Ata i kanë përkrahur aksionet e Policisë së Kosovës, meqenëse këto aksione kanë qenë kundër personave që kanë qenë të përfshirë në vepra të ndryshme kriminale. Kohët e fundit kemi parë hulumtime që kanë trajtuar aspektin e sigurisë dhe shihet se besueshmëria ndaj policisë po rritet.

"Epoka e re": Gjatë vitit që po lëmë pas policia ka realizuar edhe disa fushata vetëdijuese për në trafik?

Qalaj: Edhe një jetë e humbur është dëm i madh për këtë vend. Është fatkeqësi se situatën në trafik nuk e kemi në nivelin e dëshiruar edhe pse kemi më pak vdekje nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, mirëpo është larg gjendjes që ne synojmë ta kemi. Kjo për faktin se ende mungon një kulturë e ngasjes së automjetit në vendin tonë. Gjithmonë kur flasim për gjendjen në trafik dhe për sigurinë në rrugë, u referohemi statistikave. Unë mendoj se është

Partneriteti publiko-privat, forma më e përshtatshme për investime në 'Trepçë'



Shkruan: Ardian SYLA,
kryetar i Bordit të "Trepçës"

Që nga miratimi i Ligjit për "Trepçën" në tetor të vitit 2016 e deri më tani Ndërmarrja "Trepça" ka kaluar nëpër transformimin më të madh të ndodhur që nga periudha e pasluftës. Ligji për "Trepçën" në preambulën e tij ka për qëllim kryesor krijimin e infrastrukturës ligjore përmes së cilës synohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik duke hapur rrugë për investime, rritje të vlerës së aseteve dhe avancim të kapitalit tekniko-teknologjik si parakusht për rivitalizimin e "Trepçës" si ndërmarrje me rëndësi të veçantë për ekonominë e Kosovës.

Transformimi i ndërmarrjes "Trepça", nga ndërmarrje shoqërore në shoqëri aksionare me aksionare kryesore Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe aksionarë të dytë punëtorët e "Trepçës", përmes ligjit të veçantë dhe statutit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, është ndër hapat më të rëndësishëm që janë ndërmarrë për

"Trepçën", që nga periudha e lëshimit në punë të minierave pas luftës.

Me ndryshimin e statusit juridik ndërmarrja "Trepça" i është nënshtruar një procesi të rëndësishëm të transformimit si në aspektin menaxhues, ashtu edhe në atë zhvillimor, pasi që shkëputja e "Trepçës" nga menaxhimi dhe administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si dhe bartja e aksioneve në pronësi të Qeverisë së Kosovës, ka hapur rrugë dhe mundësi të shumta për një zhvillim sa më të qëndrueshëm ekonomik të ndërmarrjes. Për më shumë, miratimi i Ligjit dhe statutit të "Trepçës" ka vërtetuar faktin që shteti i Kosovës ka interes që ta zhvillojë sektorin minerar, në veçanti ndërmarrjen "Trepça".

Prandaj, pas miratimit të ligjit, përzgjedhja e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës, miratimi i statutit, konsolidimi i ndërmarrjes, si dhe përzgjedhja e Bordit Menaxhues kanë qenë parakushte themelore për ta filluar aplikimin e qeverisjes moderne korporative në ndërmarrjen "Trepça". Porse, përkundër faktit që Bordi Mbikëqyrës nuk është i kompletuar në tërësi ashtu siç e parasheh Ligji për "Trepçën", si dhe përkundër faktit që statuti është miratuar me vonë, ndërmarrja "Trepça" për një kohë relativisht të shkurtër ka arritur që të jetë konform legjislacionit në fuqi, për ndërmarrje publike dhe qeverisje korporative duke marrë for-

mën e një shoqërie moderne aksionare, ashtu siç e meritonte prej kohësh.

Megjithatë, i gjithë ky transformim i rëndësishëm për ndërmarrjen nuk ka kaluar edhe pa sfida të tjera të cilat janë duke e përcjellë ndërmarrjen në vazhdimësi që nga paslufta. Ndërmarrja "Trepça" është ndërmarrje prodhuese dhe i gjithë funksionimi i saj varet nga nxjerrja, përpunimi dhe shitja e xehes. Prandaj, duhet një prodhim i qëndrueshëm nga muaji në muaj në mënyrë që ndërmarrja të mos ketë probleme funksionale. Mirëpo, për të arritur një prodhim të qëndrueshëm dhe vetëstabilitet financiar, duhen ndërmarrë disa hapa jetikë për minierat e "Trepçës".

Së pari, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ripërtërjes së moshës së vjetër të fuqisë punëtore, pastaj investimeve në kapitalin teknologjik në miniera, investimit në modernizimin e flotacioneve, investimit në kuadrot e reja, hulumtimit të vazhdueshëm të trupave xehërore, rihapjes së minierave të cilat aktualisht janë jashtë funksionit, janë ndër shtyllat thelbësore për një prodhim të qëndrueshëm dhe funksionim të mirëfillt të ndërmarrjes "Trepça". Fatkeqësisht, "Trepça" me kapacitetet aktuale financiare nuk e përballon asnjërin nga veprimet e sipërcekura. Investimi në teknologjinë nëntokësore, investimi në modernizimin e flotacion-

eve, si dhe rihapja e minierave kanë një kosto të papërballeshme për "Trepçën".

Ligji për "Trepçën" ka paraparë që në kuadër të transformimit dhe ristrukturimit, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillim të saj, edhe mundësitë e pjesëmarrjes së kapitalit privat vendor dhe të jashtëm përmes formave si partneriteti publiko-privat, investimet direkte private, investimet e përbashkëta, si dhe emetimi dhe shitja e aksioneve të cilat janë disa nga mundësitë për një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm të ndërmarrjes "Trepça".


Që të katër këto forma janë të përshtatshme dhe do të ishin një lëvizje e madhe drejt ngritjes së kapaciteteve prodhuese të "Trepçës", si dhe bërjes së ndërmarrjes profilabile, njëkohësisht edhe konkurrenste si në tregjet rajonale ashtu dhe në ato ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, një kontribuuese në Bruto Produktin Vendor. Prandaj, s'duhet harruar faktin që për të gjitha këto ekziston legjislacioni i duhur në Republikën e Kosovës.

Nëse i referohemi sektorit të minierave, i cili është bërthama e ndërmarrjes "Trepça", partneriteti publiko-privat si formë e investimit do të ishte metoda më e përshtatshme e kësaj kohe, deri në fuqizimin e ndërmarrjes, për faktin që partneriteti publiko-privat përfshinë edhe ndarjen e rrezikut në mes të sektorit publik dhe atij privat.

Pjesëmarrja e qeverisë si aksionare, me pronar të 80 për qind të aksioneve, e ka të pashmangshme rrugën e investimeve kapitale në "Trepça Sh. A.", në mënyrë që ta rimëkëmbim atë. Prandaj, i takon Qeverisë së Republikës së Kosovës, që në bashkëpunim me organet udhëheqëse të "Trepça Sh. A." ta gjejnë formën adekuate të investimeve, gjithmonë brenda kufijve të lejueshëm që përcakton Ligji për "Trepçën" dhe statuti i saj.

Po të kthehemi në retrospektivë dhe të mendojmë për namin që kishte kjo ndërmarrje, në punësim, zhvillim ekonomik, si dhe imazhin me anë të të cilit edhe e identifikon vendin, më pa mëdyshje jemi të thirrur që sërish t'ia kthejmë këtë nam. Mirëpo, marrë parasysh rrethanat historike dhe shkatërimet e infrastrukturës për rikuiperimin e tyre, natyrisht se Qeveria e Kosovës, por as vetë ndërmarrja me kapacitetet prodhuese s'kanë mundur akoma që ta rimëkëmbin. Bazuar në rrethanat kronologjike, e themi lirish që për ta kthyer namin e dikurshëm nevojiten investime bajagi të mëdha. Kjo do të thotë se nëse shikohet perspektiva e ndikimit ekonomik dhe social, në këndvështrim më të gjerë, komponentë kyçe janë investimet e huaja. Andaj, pa investime të huaja dhe investitorë të brendeve më serioze, rimëkëmbja e "Trepçës" do të jetë shumë më e ngadalshme, për të mos thënë e pamundur.

Liderët politikë të Kosovës



Belul BEQAJ

Liderët janë strumbullar të politikëbërjes. Është fakt se për domethënien e kësaj shprehje ka po aq interpretime sa ka studiues të këtij fenomeni, në përjashtim të Kosovës. Krahas dallimeve, ekzistojnë edhe disa karakteristika për të cilat pajtohen njohësit më të mirë të liderizimit. Por, shpjegimi i tyre për domethënien e liderizimit dallon nga të kuptuarit e zakonshëm në Kosovë.

Qytetarët e bombarduar kryesisht nga sjelljet ditore të kuaziliderëve dhe mediave joprofesionale, liderët i paramendojnë me aftësi të jashtëzakonshme, mbase hyjnore! Shoqëria kosovare është ushqyer me paragjykime, predikime, legjenda, mite, ku liderët janë përshkruar si aktorë kryesorë, trima, heronj, personalitete me aftësi

mbi mesatare. Këto paragjykime kanë një dozë të caktuar të mistifikimit dhe fshehtësisë dhe nuk mund të paraqesin burim të besueshëm të informacioneve për të vërtetën. Dhe, si të tilla, nuk japin shpjegim të dukurive të caktuara të ndërlidhura me rolin e liderit.

Për të qenë lider i suksesshëm nuk duhet asnjë aftësi, virtyt, apo shkathtësi e mbinatyrshe, ndonëse ka edhe lider që e kanë karizmin si dhunti të lindur. Prandaj, lideri nevojitet që të ketë, krahas vizionit, veçori të kompletuara integrative, edukative, fizike, shpirtërore, mendore, emocionale, sociale dhe morale. Liderët dallojnë nga personat e zakonshëm për nga veçoritë dhe aftësitë e tyre specifike, sjelljet e tyre dhe stilet e tyre, veçmas në situata të jashtëzakonshme.

Fundja, edhe nga dëshira, energjia dhe motivi për të udhëhequr pa të cilat nuk mund të bëjë më shumë se çdo individ tjetër e i zakonshëm. Derisa dëshira për të udhëhequr është veçoria e fundit e liderëve të zakonshëm, kjo është veçoria e parë e liderëve politikë kosovarë! Studimet e kryera kohët e fundit dëshmojnë se liderë më të suk-

sesshëm politikë janë ata që marrin vendime të guximshme, të drejta dhe me kohë. Pa dyshim se kjo aftësi është një ndër aftësitë dominuese të liderëve të cilët marrin vendime të guximshme siç ishte ideja e korrigjimit të kufirit, tarifës, demarkacionit, bashkimit kombëtar, dialogut, deportimit të dhunshëm të shtetasve turq në Turqi, dorëheqjeve. Por, duke i analizuar pasojat negative të cilat duhet të jenë më të vogla karshi rezultatit pozitiv të vendimit, na mbetet neve, qytetarë të nderuar, që pas 6 tetorit 2019 ta vlerësojmë vendimarrjen e sovranit për liderët politikë. Ne duhet t'i vlerësojmë pasojat e vendimeve që Kosovën e kanë sjellë në këtë gjendje. Pse rreth 17 % të qytetarëve janë në gjendje të mjerimit, pse shkalla reale e papunësisë është pesëfish më e lartë se në BE, pse rreth 40 000 shtetas të Kosovës po heqin dorë nga shtetësia, pse jemi shndërruar në kampion regjionalë të korrupsionit, pse mbetëm të izoluar, pse partitë janë shndërruar në institucione të punësimit, pse liderët nuk i kanë përmbushur pritjet e qytetarëve. Sa Hashim Thaçi, Isa Mustafa, Albin Kurti, Fatmir

Limaj, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj dhe të tjerët përpos pasojave të krijuara. Mund ta demtojnë edhe qëllimin e vizionit për të cilin kanë përfituar besimin!

Fatmirësisht, zgjedhjet nuk i fituan ata liderë politikë vendimet e të cilëve vazhdimisht e degraduan dhe e boshatisën shtetin e Kosovës nga të rinjtë të cilët po e ndiejnë vetën më të sigurt jashtë shtetit të Kosovës sesa në shtetin e Kosovës!

Për ta merituar votën qytetare, liderët kosovarë është dashur për t'i përveçësuar ihtarët e vet në saje të realizimit të misionit dhe vizionit për interesa të përbashkëta. Ideja dhe veprimet për t'u larguar nga Kosova janë në kundërshtim me interesat e përbashkëta. Vizioni për të ardhmen s'duhet të paraqitet si qëndrimin për të ardhmen e dëshiruar, por duke nisur nga realiteti i hidhur! Vizionin euroatlantik duhet përshkruar çfarë mund të jetë realisht. Atë çfarë dëshirojmë dhe mund të bëhet. Qëllimi i vizionit nuk është vetëm përshkrimi i të ardhmes së synuar, por edhe motivimi që e tërë energjia reale të drejtohet në rrugën e realizimit të qëllimeve publike. Gjendja

reale gjatë njëzet vjetëve është dëshmi se shumë votues kanë bërë gabime duke zgjedhur liderët e papërgjegjshëm. Sikur të mos kishin bërë gabime zgjedhësit, nuk do të kishim sot në pushtet gjoja se idealistët që kanë përfunduar si materialistë!

Prandaj, mbështetja e votuesve për liderët duhet të ndikojë në shembullin e tyre për t'u identifikuar me përkushtim ndaj interesit publik, qëllimit të caktuar drejt arritjes së rezultateve të pritura duke dëshmuar përgjegjësi për veprimet e ndërmarrja, e jo si deri më sot. Megjithatë liderët kosovarë politikë kryesisht deklarohen si pro amerikanë, është shumë me rëndësi të kuptojnë, të veprojnë dhe të sillen sikur njëri nga ish-themeluesit e ShBA-së, Benjamin Franklini, i cili, pas vërejtjeve shqetësuese të nënës, se do ta demtojë shëndetin duke punuar shumë në shërbim të publikut. Duke reaguar për shqetësimin e saj, pse aq shumë është i përkushtuar ndaj shërbimit publik, i shkruan nënës: "Më me ëndje dëshiron që amerikanët të thonë se kam jetuar si politikan i dobishëm, apo se kam vdekur i pasur?!"



TOP NGJARJET EKONOMIKE NË KOSOVË NË VITIN 2019

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Viti 2019 në fushën ekonomike është karakterizuar kryesisht me debatin rreth taksës së vendosur ndaj mallrave me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovica. Po ashtu, debati është përqendruar edhe te Ligji i pagave, investimet vendore kapitale, kryesisht në infrastrukturë, çështja e privatizimit të Telekomit, si dhe ndërlidhja me "Z-Mobile". Natyrisht se viti 2019 nuk do të mbahet mend për ndonjë investim apo brend të huaj. Ndërsa gjendja e operimit dhe punësimit në sektorin privat, si dhe norma e lartë e papunësisë edhe në vitin që lamë pas, nuk ka shënuar përparim. Sikurse në vitet e kaluara, edhe në vitin 2019 dominimi i agjendave politike ka ndikuar edhe në përkeqësimin e pozitës së Kosovës në raportin e Bankës Botërore që matë lehtësinë e të bërit biznes, në të cilin në dy vjetët e fundit kemi shënuar rënie për 17 pozita.

"Trepça" regjistrohet si shoqëri aksionare

8 MARS - Gjiganti metalurgjik "Trepça" është regjistruar si

shoqëri aksionare në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Me anë të këtij regjistrimi është konfirmuar se 80 për qind e aksioneve të "Trepçës" do të jenë të Qeverisë, kurse 20 për qind do t'u përkasin punonjësve të kësaj ndërmarrje.

Ambasada Britanike tërhiqet nga procesi i rekrutimit të kryesuesit të Bordit të ZRRE-së

28 MARS - Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë ka tërhequr mbështetjen për rekrutimin e pozitës së kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) si pasojë e "zhgënjimit me vendimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për mosvotimin e asnjërit nga kandidatët e rekomanduar nga partneri zbatues i projektit të rekrutimit". Kjo ambasadë ka theksuar se më 28 shkurt deputetët kanë dështuar t'i votojnë kandidatët e propozuar për këtë pozitë dhe janë të detyruar ta rishpallin konkursin. Pas këtij vendimi, Ambasada Britanike ka njoftuar se nuk do të financojë procese të reja rekrutuese.

Ndalohej lojërat e fatit në Kosovë

28 MARS - Me 69 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Kosovës ka votuar Ligjin që ndalon të gjithë lojërat e fatit në territorin e Kosovës, vendim i cili ka kaluar disa ditë pasi kanë ndodhur vrasje në një kazino në Suharekë dhe në Lipjan.

Vendet e Ballkanit nënshkruajnë marrëveshjen për heqjen e tarifave roaming

4 PRILL - Në Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor, i cili është mbajtur në Beograd, ministri i

Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljuka, në emër të Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen për zbritjen e çmimeve të roamingut për vendet e Ballkanit. Palët nënshkruese të marrëveshjes, e cila do të quhet "Roaming si në shtëpi", ka filluar nga 1 korriku i këtij viti duke ulur kostot e roamingut, ndërsa nga 1 korriku i vitit 2021 nuk do të ketë çmime bazë të roamingut. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia. Me anë të kësaj marrëveshje do të ketë reduktime të "ashpra" të çmimeve, nga 2.5 euro sa ishte për një minutë, në 0.19

cent. Pastaj në vitin 2020 në 0.16 centë, për t'u eliminuar tërësisht nga 1 korriku i vitit 2021.

"General Electric" përzgjedhet ofertuesi i preferuar për TC "Kosova e Re"

3 MAJ - "Contour Global" dhe Qeveria e Kosovës kanë njoftuar se konsorciumi i kompanive të "General Electric" është përzgjedhur si ofertuesi i preferuar në tenderin për Inxhinieringun, Prokurimin, Ndërtimin (EPC) dhe Mirëmbajtjen Afatgjatë (LTM) për Projektin e Termocentralit "Kosova e Re". Ndërsa më 6 maj ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se është i lumtur që Qeveria e Kosovës ka përzgjedhur ofertuesin e preferuar për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re".

ATK-ja revokoi licencat e lojërave të fatit

10 MAJ - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar opinionin dhe subjektet ekonomike se me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore,





kishte filluar revokimin e të gjitha licencave të subjekteve që merren me organizimin e lojërave të fatit.

Lëshohet për qarkullim autostrada "Arbën Xhaferi"

29 MAJ - Në një ceremoni të organizuar nga institucionet shtetërore është bërë inaugurimi i autostradës "Arbën Xhaferi", e cila shtrihet nga Prishtina deri në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut. Në inaugurimin e kësaj autostrade kanë marrë pjesë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, kryeparlamentari Talat Xhaferi dhe kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq. Kjo autostradë ka një gjatësi prej 65 kilometrash dhe njihet për urën më të gjatë në rajon me gjatësi prej 5.7 kilometrash.

Besim Beqaj jep dorëheqje nga pozita e ministrit të Inovacionit

20 QERSHOR - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit. Dorëheqja e Beqajt ka

ka emëruar Muzafer Shalën në pozitën e Besim Beqajt.

Kuvendi miraton Projektligjin për të ardhurat e korporatave

27 QERSHOR - Me 74 vota për, asnjë kundër, dy abstenime deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar Projektligjin në të ardhurat e korporatave. Kompanitë e sigurimeve që operojnë në Kosovë tash e tutje do të trajtohen njëjtë sikurse të gjitha bizneset e tjera që funksionojnë në Kosovë. Deri me këtë datë kompanitë e sigurimeve kanë qenë të obliguara që të paguajnë 5 për qind tatim në qarkullim si dhe të gjitha tatimet e tjera që parashihen me ligjet e Republikës së Kosovës.

Telekomi i Kosovës shkëput kontratën me "Z-Mobile"

30 KORRIK - Telekomi i Kosovës ka shkëputur kontratën dhjetëvjeçare me kompaninë telefonike "Z-Mobile". Në një konferencë për medie kryetarja e Bordit të Telekomit, Besa Shatri-Berisha, ka njoftuar se pas gjashtë muajve



por jo edhe drejtuesit e "Z-Mobile" të cilët janë duke ndjekur rrugët ligjore për ta kundërshtuar një vendim të tillë.

Ish-drejtuesit e Telekomit lirohen nga akuzat për kontratën me "Z-Mobile"

21 TETOR - Tre ish-drejtuesit e Postës dhe Telekomit të Kosovës

keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar pasi pretendohet se i kishin shkaktuar Telekomit të Kosovës humbje afro 30 milionë euro lidhur me kontratën me "Z-Mobile".

Hiqet homologimi për veturat e reja

28 TETOR - Ministria e Infrastrukturës e Kosovës ka

protesta, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi.

Kosova del nga sistemi rregullues energjetik i Serbisë, i bashkohet Shqipërisë

2 DHJETOR - Përfaqësuesit e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës



ardhur pas vendimit të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, për largim nga detyra të të gjithë anëtarëve të kësaj partie politike që mbajnë poste publike dhe që janë të akuzuar për korrupsion dhe nepotizëm. Ndërsa më 17 korrik kryeministri Ramush Haradinaj

bisedime të pasuksesshme me "Z-Mobile", kanë marrë vendim që ta shkëpusin kontratën. Ndërsa nga 28 nëntori të gjithë numrat e "Z-Mobile" kanë kaluar në pronësi të "Vala"-s. Shkëputja e kësaj kontrate ka gëzuar punëtorët e Telekomit,

(PTK), Agron Mustafa, Ejup Qerimi dhe Rexhë Gjonbalaj, janë liruar nga akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare lidhur me kontratën me "Z-Mobile". Në rastin e njohur si "Posta", ata akuzoheshin për

marrë vendim që veturat e reja, të importuara nga kompanitë e licencuara, nuk do t'i nënshtrohen më homologimit nga kompania e autorizuar. Një vendim i tillë është mirëpritur nga Bashkimi Evropian (BE). Ky institucion ka theksuar se pret që e njëjta qasje të zbatohet për të gjitha automjetet e importuara që përputhen me standardet e BE-së, përfshirë edhe automjetet e dorës së dytë.

(KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë (OST) kanë nënshkruar në Tiranë marrëveshjen e themelimit të bllokut rregullues të sistemeve energjetike Kosovë - Shqipëri. Kjo marrëveshje parashihet të hyjë në fuqi në prill të vitit 2020. Një marrëveshje e tillë e largon Kosovën nga sistemi rregullues energjetik i Serbisë.



Tarifat për regjistrimin e automjeteve rriten për 26 për qind

5 NENTOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka marrë vendim që t'i rrisë tarifën për sigurimin e detyrueshëm për automjetet për pasagjerë. Kjo rritje e çmimit për sigurimin e automjeteve, sipas vendimit të BQK-së, do të jetë mbi 26 për qind. Një vendim i tillë i BQK-së nuk është mirëpritur nga askush. Madje kundër këtij vendimi janë mbajtur edhe

Kushtetuesja pezullon Ligjin për paga

12 DHJETOR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka marrë vendim që ta pezullojë zbatimin e Ligjit për paga në sektorin publik, duke caktuar masën e përkohshme ndaj këtij ligji deri më 30 mars 2020. Ligjin për paga më 6 dhjetor në Gjykatën Kushtetuese e ka dërguar Avokati i Popullit, për vlerësimin e përputhshmërisë së këtij ligji me Kushtetutën. Ligji për paga është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 2 shkurt.

Edhe pse viti 2019 qe shpallur vit i ekono



Drejtimesit e odave ekonomike në Kosovë dhe njohësit e çështjeve ekonomike kanë thënë se ekonomia është lënë anash nga institucionet vendore, pavarësisht se viti 2019 qe shpallur vit i ekonomisë. Ata kanë thënë se gjatë vitit 2019 nuk ka pasur asnjë investim serioz i cili do t'i jepte shtytje ekonomisë së Kosovës dhe hapje të vendeve të punës. Në këtë kontekst ata kanë thënë as në vitin 2020 nuk presin ndonjë risi sa i përket zhvillimit ekonomik për shkak të dialogut me Serbinë dhe presionit social

gabueshëm për rritje të pagave në sektorin publik, si dhe me vazhdimin e situatës së paqartë rreth tarifës për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. Nuk kishte asnjë investim serioz që do të krijonte vende pune, pasi ndodhën zgjedhjet dhe vonesat për formimin e institucioneve, që ndikuan në konfidencën e të bërit biznes në Kosovë", ka thënë Rukiqi për "Epokën e re". Ai ka theksuar se pritjet e tij për vitin 2020 janë në aspektin e reformave ekonomike. "Këtë vit presim risi në politikatat ekonomike, nëse fillon punën qeveria që doli nga zgjedhjet e këtij viti. Por, nuk presim shumë ndryshime duke pasur parasysh ngarkesën me temat si dialogu, por edhe presionin social, përfshirë grevat dhe shumë çështje të tjera të hapura dhe të pazgjidhura për shumë vjet", u shpreh ai.

Zeka: Qeveria e re duhet ta nisë vitin 2020 me një strategji kombëtare për zhvillimin ekonomik

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka

thënë se edhe pse viti 2019 ishte shpallur vit i ekonomisë nga Qeveria e Kosovës, prioritetet ekonomike janë lënë anash. "Viti 2019 është shpallur nga Qeveria vit i ekonomisë, megjithatë prioritetet ekonomike sërish janë lënë në hije për shkak të rrethanave të krijuara pas dorëheqjes së kryeministrit të vendit dhe shpërbërjes së Kuvendit", ka thënë Zeka.

Ai ka thënë për "Epokën e re" se qeverisja ekonomike gjatë vitit 2019 ka qenë e zbehtë. "Zhvillimet në aspektin e qeverisjes ekonomike në përgjithësi kanë qenë më të zbehta, gjë që ka ndikuar edhe në përkeqësimin e pozitës së Kosovës në raportin e Bankës Botërore që matë lehtësinë e të bërit biznes, në të cilin në dy vjetët e fundit kemi shënuar rënie për 17 pozita. Në anën tjetër, në këtë fundvit rezultatet janë të mangëta edhe në aspektin e tërheqjes së investimeve të huaja direkte dhe droja është që edhe këtë vit do ta ndjekim trendin e rënies së vlerës së investimeve të huaja. Mungesa e stabilitetit politik dhe mosfunksionimi i institucioneve, përfshirë edhe Kuvendin si

organin më të lartë vendim-marrës, kanë ndikuar në mosndryshim të një sërë aktesh ligjore të cilat do të kishin ndikim pozitiv në sektorin privat, siç është rasti me legjislacionin tatimor, në mënyrë më specifike Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, i cili ka paraparë zhvendosjen e mbledhjes së TVSh-së në brendi si kërkesë e kamotshme e bizneseve", ka thënë Zeka, duke shtuar se shpërbërja e Kuvendit ka pamundësuar shqyrtimin dhe aprovimin e ligjeve që rregullojnë funksionimin e gjyqësorit, siç është rasti me Projektligjin për Gjykatën Komerciale, i cili do të jepte përgjigje në një kërkesë të Odës Amerikane dhe komunitetit të biznesit për një gjykatë komerciale, e cila do t'i trajtonte vetëm kontestet e natyrës komerciale. "Duke pasur parasysh rezultatet e mangëta gjatë vitit 2019, pritjet e komunitetit të biznesit për vitin 2020 dhe qeverinë e re janë të larta. Qeveria e re duhet ta nisë hartimin e një strategjie kombëtare të zhvillimit ekonomik, e cila do të ishte udhërrëfyese për të gjitha iniciativat dhe vendimet e qeverisë dhe institucioneve të tjera.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

ekonomike janë lënë anash nga institucionet vendore.


Rukiqi: Vendimi për rritje të pagave ka qenë i gabueshëm

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se viti 2019 është karakterizuar me vendimin e gabueshëm për rritje pagash në sektorin publik si dhe mosqartësim rreth taksës ndaj Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. "Viti 2019 është karakterizuar me vendimin e

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Përfaqësuesit e odave ekonomike, të bizneseve, si dhe njohës të ekonomisë në Kosovë vitin 2019 në fushën ekonomike e kanë vlerësuar të zbehtë sa i përket përparimit të ekonomisë vendore. E tëra kjo, sipas tyre, si pasojë e humbjes kohë me Ligjin për paga dhe paqartësisë për taksën, si dhe si pasojë e dominimit të agjendës politike karshi asaj ekonomike. Sipas tyre, edhe pse viti 2019 qe shpallur vit i ekonomisë, prioritetet



misë, prioritetet ekonomike u lanë anash



Në këtë mënyrë do t'u jepej fund improvizimeve qeverisëse dhe vendimeve ad-hoc, që e kanë karakterizuar vendin në të kaluarën, sidomos në aspektin e qeverisjes ekonomike", ka deklaruar Zeka.

Sipas tij, prioritet duhet dhënë edhe zvogëlimin të hendekut ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës, duke pasur parasysh ankesat e sektorit privat për gjetjen e kuadrove adekuate të punës. "Qeveria, por edhe Kuvendi duhet ta shtojnë dinamikën e punës për sa iu përket ligjeve që përmirësojnë mjedisin e të bërit biznes dhe ndikojnë në fuqizimin e sektorit privat. Krejt në fund, është e rëndësishme të ndryshohet në mënyrë rrënjësore mënyra e promovimit të potencialeve ekonomike para investitorëve të huaj", është shprehur Zeka.

Piraj: Nëse nuk eliminohet burokracia dhe korrupsioni s'do të ketë ndryshime në ekonomi

Drejtori i kompanisë "Meka Halal FOOD", Burim Piraj, ka thënë se ekonomia e vitit 2019

në vendin tonë ka pasur një rritje jo të kënaqshme e cila nuk përkon me kërkesat e numrit të papunëve që është vazhdimisht në rritje. Sipas tij, vetë fakti i vazhdimin të emigrimit të popullatës është tregues për një ekonomi e cila nuk i plotëson pritjet tona. "Në vitin 2020, nëse nuk fillojnë të eliminohen burokracia dhe korrupsioni në institucione dhe nëse nuk lirohet e tërë lënda e parë nga taksa doganore, pa marrë parasysh se kush do ta përpunojë, nuk do të ketë ndryshim. Jemi dëshmitarë që firmat të cilat punojnë pa fiskalizim dhe në të zezën siç jemi mësuar ta quajmë ekonominë gri ne kanë arritur kapital shumë të madh, ndërsa firmat legale të cilat i paguajnë taksat dhe detyrimet e shtetit kanë një zhvillim më të ngadalshëm. Sektori tregtar e ka okupuar tregun i cili nga asnjë mekanizëm lokal dhe as i qeverisjes qendrore nuk kontrollohet dhe sot ka shumë supermarkete që janë fare prapë njëra-tjetrës që në asnjë vend të zhvilluar nuk do t'u jepej leje pune që të mos i bëjnë konkurrencë të pajustificuar njëra-tjetrës", ka deklaruar Piraj për "Epokën e re".

Sipas Pirajt, sektori i prodhimit, i cili do të duhej të ishte në qendër të vëmendjes së institucioneve shtetërore, është lënë anash në mëshirën e konkurrencës së padrejtë të shumë produkteve të subvencionuara që e vërshojnë vendin. Ai ka thënë se sektori i prodhimitarisë është shumë i rëndësishëm dhe se duhet ta ketë një trajtim të dinjitetshëm. "Ka shumë punë për institucionet tona më 2020, nëse duan që të krijojnë bazament për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm andaj dhe nuk po di si t'i përcaktoj pritjet e mia kur jemi në një moment kur çdo cikërimë ka ndikim të madh e reagimet e institucioneve janë shumë të ngadalshme dhe nuk përkojnë me trendët ndërkombëtarë", ka thënë ai.

Mustafa: Rritja ekonomike, jo e qëndrueshme

Profesori i ekonomisë, Muhamet Mustafa, ka vlerësuar se rritja e tanishme ekonomike prej rreth 4 për qindësh, sado që shumë e quajnë solide për Kosovën, nuk është e

mjaftueshme. Sipas tij, ky ritëm i rritjes ekonomike është fragjil dhe jo i qëndrueshëm. "Marrja e një rruge zhvillimi ekonomik me ritme më të shpejta çfarë i duhet Kosovës mbetet edhe në vitin 2020 çështje me më rendësi. Rritja e tashme ekonomike rreth 4 për qind, sado që shumë e quajnë solide për Kosovën, nuk është e mjaftueshme. Ky ritëm i rritjes ekonomike jo vetëm se është më tepër një rritje nga inicioni i disa faktorëve që lidhen me stadin zhvillimor dhe disa faktorë që vijnë nga jashtë, por është fragjil dhe jo e qëndrueshme. Për ta marrë drejtimin e duhur duhen fuqizuar forcat e brendshme zhvillimore dhe promovuar e zbatuar politikë që rritin ofertën vendore të produkteve për tregun e brendshëm dhe për eksport. Kjo kërkon një rritje të investimeve publike për një 200 milionë euro dhe një rritje të investimeve private 500-700 milionë euro në vit", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë për "Epokën e re" se te rritja e investimeve publike ka probleme të mëdha, sidomos deformime në strukturën e buxhetit që janë krijuar me

rritjen e pagave në sektorin publik. "Ndërkaq rritja e investimeve private mbetet peng i dobësive në qeverisjen makroekonomike, moszbatimin e ligjit dhe korrupsioni i lartë. Qeveria e re duhet të ballafaqohet me këto probleme jo të lehta. Nga ana tjetër situata në shoqëri përgjithësisht mbetet peng edhe i defekteve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve që prodhohen nga lufta primitive politike grupore e partiake për pushtet, duke e vënë pushtetin si qëllimin primar për t'i servisuar kastat partiake dhe të interesit grupor politik e ekonomik. Mbeten shumë të panjohura se si do të rrjedhin gjërat këtu, pas konstituimit të legjislaturës së shtatë të Kuvendit. A do të krijojë ky moment një praktikë të re institucionale apo negociatat për pushtet do ta devalvojnë edhe këtë dhe do të hyjmë në një situatë pritjeje, status quo, e cila do ta rrisë apatinë më shumë probleme shoqëruese degjeneruese. Urojmë që të ndodhë e kundërta dhe të ketë një kthjellim në logjikën dhe sjelljet e aktorëve politikë", është shprehur Mustafa.



Urime Viti i Ri 2020!





Rotacioni modest politik në Kosovë dhe triumfalizmi i pajustificueshëm i fitimtarëve



Adri NURELLARI

Periudha që pasoi zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit u karakterizua nga një sjellje super arrogante e liderit të partisë fitimtare që nuk ka asnjë lidhje qoftë me kulturën politike të një vendi demokratik e qoftë me numrat e rezultetit modest që pati kjo parti. Shumë kohë përpara se të niste parlamenti, lideri i Vetëvendosjes u pa duke u shëtitur dhe sjell si kryeministër, ndërkohë që kjo sjellje delirante mund të konsiderohej thjesht "peshku në ujë e fërtelja në zjarr". Përpos kësaj, sjellja ishte tejet arrogante jo vetëm ndaj partnerit potencial të qeverisjes me të cilin e ndanin në rezultat fare pak vota, por edhe me institucionet kushtetuese si presidenti e me vetë procedurën demokratike. Së pari duhet theksuar se në një demokraci funksionale një ndër vlerat kryesore që duhet të mbizotërojë është vetëpërmbytja. Në një demokraci të konsoliduar partia që fiton zgjedhjet ka të drejtë të qeverisë, por jo të sundojë me prepotencë duke shpërfillur pluralizmin politik. Për një lider në demokraci është thelbësore që të jetë në gjendje të bëjë kompromis dhe të dijë se si ta mundësojë bashkëpunimin edhe me forca rivale. Kjo do të thotë që politika në një sistem demokratik si ky i Kosovës duhet bazohet në dialog e kompromis mes palëve të ndryshme e pa u përpjekur që të asgjësohet apo mohohet partia tjetër. Me këtë gjë nënkuptohet që partia në pushtet nuk duhet ta antagoni-

zojë ose poshtërojë opozitën në mënyrë të panevojshme, por duhet të tregojë vetëpërmbytje e të përpiqet që të bashkëpunojë me të gjitha palët për të mirën e përbashkët.

Toleranca, bashkëjetesa, dialogu e konsensusi janë të gjitha pjesë të vetëpërmbytjes që duhet të tregojnë liderët në mënyrë që demokracia mos të kthehet në tirani të shumicës. Sjellja që synon shpagim apo revansh nuk e çon aspak përpara një qeveri apo mazhorancë të re por, përkundrazi, historia ka treguar se duke u marrë me të kaluarën harxhohet aq shumë energji e vëmendje sa nuk bëhet asgjë për të ardhmen. Një politikan mund t'ia dalë ta ngjallë zellin e turmave duke bërë thirrje se "kurrë nuk do të pajtohet me këta apo atë gjë" apo "asnjëherë nuk do të bashkëpunojë me këtë apo atë politikan apo parti", mirëpo kjo qasje në qeverisje garanton vetëm dështim. Ky ton i cekët moralist e populist mund të shitet e të ketë efekt për të siguruar vota apo mobilizimin e masave, por nuk jep asnjë rezultat e nuk ka kuptim në një sistem demokratik ku ndërtimi i konsensusit sa më të gjerë në vendimmarrje është thelbi i qeverisjes. Për më tepër që Kosova ka përpara sfida të rënda që në mënyrë të pashmangshme kërkojnë gjithëpërfshirje në vendimmarrje dhe jo anatemi e polarizim të skajshëm me rivalët politikë.

Së dyti, rezultati i zgjedhjeve që ka pasur LV nuk është ndonjë triumf i pashoq për t'u shitur kinse politika kosovare ka pasur një përmbysje. Vetëvendosja po shitet sikur e ka hapur një kapitull të ri politik me këto zgjedhje, faktikisht ka marrë vetëm 26.27 % të votave dhe 29 deputetë. Pra, bëhet fjalë për një shumicë të brishtë që kurrsesi nuk e justifikon retorikën mburravece që



po përdor sot LV dhe mbështetësit e saj. Sa për të krijuar një ide të përmasave minimale të rotacionit, mjafton të kujtohet që në zgjedhjet e vitit 2007, kur Partia Demokratike e Kosovës ishte në situatë të ngjashme dhe bëri rotacionin, fitoi me 34.7 % të votave dhe mori 37 deputetë. Pra, shumë më shumë se LV sot dhe e njëjta gjë vlen edhe për distancën nga partia e dytë. Asokohe PDK-ja mori 11.7 % më shumë se LDK-ja, ndërsa sot LV ka marrë vetëm 1.72 % më pak. Megjithatë, PDK-ja u tregua shumë më e vetëpërmbytur dhe bashkëpunuese me LDK-në duke i dhënë pa shumë zhurmë e bujë edhe postin e presidentit partisë së dytë.

Përpos kësaj, përtej mendjemadhësisë apo krekosjes për fitoren e cekët që ka bërë Vetëvendosja, duhet analizuar edhe roli i saj në opozitë dhe fakti që kjo parti ka dalë më keq në rezultate se në zgjedhjet e mëparshme sepse në 2019-n ka marrë 1.22 % apo 3 deputetë më pak se në vitin 2017. Nga

ana tjetër, nëse pretendohet për ndonjë penalizim të qeverisjes së kaluar me kryeministër Haradinaj, duhet theksuar se faktikisht koalicionit të deritanishëm qeverisës, votat vetëm i janë shtuar. Nëse e formuan qeverinë me vështirësi me 41 deputetë (pa 20 të pakicave), sot PDK-ja bashkë me AAK-në, Nismën dhe AKR-në kanë 43 deputetë. Kjo do të thotë se po të kishim të njëjtin konfigurim koalicionesh si në 2017-n, prapë LV-ja dhe LDK-ja do të kishin ngelur në opozitë.

Kur përmendet LDK-ja duhet thënë, gjithashtu, se kjo arroganca e tepruar nga LDK-ja është, gjithashtu, për t'u tallur sepse, në fund të fundit, LDK-ja sërish ka dalë humbëse dhe nuk ka gojë që të pretendojë të sillet si fitimtare. Kjo parti ka që në vitin 2004 që humb zgjedhjet dhe siguron pushtet vetëm prej ujdivë të tavolinave e jo kutive të votimit. Për këtë arsye i takon edhe të tregohet më e përlulur dhe e përmbajtur me oreksin e pangopshëm që ka për pozita politike. Për më

tepër, duhet parë edhe rezultati i kësaj partie përkundrejt zgjedhjeve të kaluara dhe trajtuar me këmbë në tokë efekti i kandidatës Vjosa Osmani. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 LDK-ja sapo kishte dalë nga koalicioni i PDK-së e prapëseprapë lista e drejtuar nga Avdullah Hoti mori 25.53 % të votave apo 29 deputetë. Ndërsa në zgjedhjet e fundit, kur gjithë fushata ishte anti-PDK-së, mori 24.55 % të votave apo 28 deputetë. E gjitha kjo do të thotë që Osmani si kandidatë për kryeministër ka marrë 1 % dhe 1 deputet më pak se Hoti. Prandaj janë krejt pa vend këto lëvdata që po i thuren të ashtuquajturit sukses elektoral të Vjosa Osmanit.

Për sa i përket flirtimit parazgjedhor LV me LDK, doli qartë që ai ishte i gjithi një taktizim elektoral për ta goditur rivalin kryesor të përbashkët dhe nuk kishte asgjë të bënte me ndonjë përputhje vizioni mes këtyre partive për të ardhmen e vendit. Taktizimi konsistonte në demonizimin e PDK-së në mënyrë që ta krijonin bindjen tek elektorati i lëkundur që vota për PDK-në do të ishte një votë e humbur kot sepse edhe po të dilte e para, PDK-ja s'do të kishte mundësi të gjente aleatë për t'i formuar numrat e shumicës së nevojshme për qeveri. Për dy vjet me radhë LV dhe LDK kërkuar rrëzimin e qeverisë Haradinaj dhe u dakorduan bashkë për qëndrimet, ndërkohë që kaluan 80 ditë pas zgjedhjeve dhe nuk u morën vesh për t'i ndarë karriget. Këto dy parti brenda një dite u morën vesh për programin, pavarësisht se ishin ideologjikisht krejt të kundërta (njëra e mban veten për të majtë e tjetra për të djathtë), mirëpo kur erdhi fjala te karriget, vështirë se ranë dakord se si do ta ndanin "plaçkën e luftës". Nga "koalicioni i shpresës", siç e quajtën veten në fillim, brenda pak javësh e katandisën veten në "shpresë për koalicion".

Gëzuar festat e fundvitit



KEDS  **KES|CO**



**URIME VITI I RI!
HAPPY NEW YEAR!
2020**

 **PRISHTINA
INTERNATIONAL
AIRPORT
ADEM JASHARI**

 **Limak
KOSOVO**



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

KOSOVA e RE



Gëzuar Vitin e Ri!
HAPPY NEW YEAR!

2020



Urime Kosovë, shpirti vital i kombit shqiptar!



Prof. Lisen BASHKURTI

Kalendari i vitit 2019 po kthen faqet e tij të fundit. Për Kosovën viti 2019, që po lëmë pas, është përballur me probleme të shumta, por edhe me zgjidhje të mira dhe ngjallje shpresash kuptimplote për mbarë qytetarët e saj.

Prej 11 vjetësh pavarësie, më 2019, Kosova arriti të hedhë hapa të rinj në rrugën për konsolidimin e shtetit të saj, bazuar në parime të larta demokratike, arriti ta thellojë stabilitetin e brendshëm të saj si dhe t'i kontribuonte stabilitetit në nivel rajonal.

Krijimi i forcave të armatosura të Kosovës ishte hap madhor në suazën e institucioneve themelore të Shtetit të Kosovës. Vendosja e taksës 100 për qind për mallrat serbe që hynin në Kosovë, përbëri një situatë të re, shumë më të balancuar dhe të avancuar të Kosovës në marrëdhëniet me Serbinë. Ligji për Minierat e Trepçës dhe asetëve të saj ishte një vendim tejet i rëndësishëm për të ardhmen e ekonomisë së Kosovës. Këta hapa të hedhur kanë qenë të vështirë, me kundërshti të brendshme dhe ndërkombëtare, por institucionet e Kosovës i tejkaluan me sukses të gjitha.

Gjatë vitit 2019 Kosova realizoi me sukses pavarësinë telekomunikative dhe energjetike nga Beogradi. Një nga të arritjet më të mëdha të pavarësisë telekomunikative për Kosovën është largimi i plotë i kodit të Serbisë që ka funksionuar në Kosovë për një periudhë të gjatë nga telefonia fikse. Tanimë në telefoninë fikse dhe në atë mobile, të gjithë operatorët, qoftë ata të mëdhenj apo të vegjël, zbatojnë në thirrjet nga e gjithë bota në drejtim të Kosovës me kodin e saj. Ky është hap i madh me vlera të shumëfishta, politike, ekonomike dhe sigurie për Kosovën. Nga ana tjetër, lidhja e rrjetit energjetik të Kosovës direkt me Shqipërinë, duke u shkëputur nga varësia e tregut energjetik të Beogradit, është arritje e jashtëzakonshme për rritjen e pavarësisë së Kosovës, por edhe për ekonominë dhe sigurinë e vendit.

Si shtet i pavarur dhe sovran Kosova qartësoi më tej politikën e saj publike, të brendshme dhe

të jashtme. Kosova dëshmoi përgjatë vitit 2019 se i merr vetë vendimet e saj, bazuar në kushtetutë, në shërbim të interesave të shtetit dhe të qytetarëve të saj si dhe në pajtim me miqtë dhe aleatët e saj më strategjikë ndërkombëtarë. Koha për tutelë dhe paternalizëm, ngado që tentohet që të vijë, për shtetin e Kosovës ka marrë fund.

Edhe në procesin e gjatë dhe të vështirë të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, gjatë vitit 2019 Kosova ka bërë gjithë përpjekjet e saj për vazhdimin e dialogut, por me kushte të reja dhe qasje më të balancuar, mbështetur në Kushtetutën e saj dhe interesat shtetërore dhe qytetare. Nëse në këtë aspekt nuk u shënua kurrfarë përparimi në vitin që po lëmë pas, kjo ka ardhur për shkak të Serbisë, synimeve dhe qëndrimeve të saj hapazi armiqësore kundër pavarësisë së Kosovës.

Politika e Serbisë gjatë vitit 2019 është karakterizuar nga rritja e agresivitetit të saj kundër Shtetit të Kosovës, përpjekjet për bllokimin e integritetit të Kosovës në organizatat rajonale dhe ato ndërkombëtare, ndërmarrja e hapave konspirativë dhe korruptivë për t'i bërë disa shtete që t'i tërheqin njohjet për Kosovën, si dhe taktikat djallëzore direkte dhe indirekte për ta shantazhuar apo izoluar Kosovën përmes nismave si minishengeni ballkanik etj. Pavarësisht nga këto politika dhe taktika të Serbisë dhe disa mbështetësve të saj, kundër pavarësisë së Kosovës, sërish Kosova i përballoi me sukses të plotë ato, duke forcuar akoma më shumë identitetin shtetëror dhe interesin e qytetarëve të saj. Mbi të gjitha, viti 2019 do të kujtohet si vit i zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit. Ishin zgjedhje të lira dhe demokratike, që prodhuan një rezultat politik me pritshmëri të larta transformuese për Kosovën. Qytetarët e Kosovës presin nga qeveria e re më shumë për ekonominë dhe punësimin, për sundimin e ligjit dhe forcimin e drejtësisë, për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivele të larta, për reformën në qeverisje dhe në administratën publike, për transformim në edukim, shëndetësi dhe fusha të tjera.

Qytetarët e Kosovës votuan më 6 tetor edhe për vënien në binarët kushtetues dhe profesionalë të politikës së jashtme dhe të diplomacisë së Kosovës. Kosova votoi për hapje dhe bashkëpunim me fqinjët,

rajonin dhe komunitetin ndërkombëtar përgjithësisht por, duke u bazuar në parimet për reciprocitetin në marrëdhëniet fqinjësore, rajonale dhe ndërkombëtare, për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit shtetëror dhe të pacenueshmërisë së kufijve dhe tërësisë territoriale të Kosovës. Gjithashtu, Kosova votoi për pikëpamjen se rruga për çdo iniciativë, si ajo e minishengenit ballkanik, fillon me kërkimfalje nga Serbia për krimet dhe gjenocidin e bërë mbi popullin e Kosovës, vazhdon me njohjen reciproke, më tej ecën me pajtimin, zhvillohet me ngjalljen e respektit të ndërsjellë, shkon

më pas drejt normalizimit të përgjithshëm dhe në fund ngrihet në nivelin e miqësisë. Pra, hapat paraprakë drejt bashkëpunimit rajonal, ku bën pjesë Serbia, duhet të nisin falje, respekt, pajtim, normalizim, njohje, miqësi. Gjithashtu, Kosova i qëndron pikëpamjes së drejtë, të dobishme dhe plotësisht të arsyeshme, se pa miqësi fqinjësore midis shteteve të barabartë, pa stabilitet të brendshëm e rajonal, pa sundim të ligjit, pa luftë kundër krimin e korrupsionit, pa respekt për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, pa zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nuk mund të ketë nisma eficiente, të balan-

cuara dhe gjithëpërfshirëse ballkanike, duke përfshirë edhe minishengenin rajonal.

Kalendari i vitit 2019 tanimë po kthen faqet e tij të fundit. Për Kosovën viti 2019, që po lëmë pas, ishte përballje me probleme të shumta, por edhe me zgjidhje të mrekullueshme që kanë ngjallur shpresa kuptimplote për mbarë qytetarët e saj. Viti që po vjen, 2020, duket se do të ketë sfida të mëdha për Kosovën. Këto sfida do të vijnë kryesisht nga pritshmëritë e qytetarëve të Kosovës për qeverisjen e re, të votuar më 6 tetor 2019. Urime Kosovë, shpirti vital i kombit shqiptar!





Qendra për Mjekësi Fizikale
dhe Rehabilitim

Nëna Naile

Banja në Kllokot - Kosovë



Tel&Fax: 0280 385 101, 0280 385 555 • Mob: 044 666 006, 045 385 555 • Info@nenanalle.com • www.nenanalle.com



Tek ne do të gjeni ngrohtësi në katër stinët e vitit ...!

Urime Festat e Fundvitit

NGJARJET KRYESORE QË KARAK

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Vrasja e liderit të Shtetit Islamik (ISIS), miratimi i akuzave nga Dhoma e Përfaqësuesve në ShBA për shkarkimin e presidentit, Donald Trump, zgjedhjet në Bashkim Evropian, zgjedhjet në Britani të Madhe, vazhdimi i luftës në Siri dhe në vende të tjera të Lindjes, si dhe protestat në Hong Kong kanë qenë disa nga ngjarjet kryesore që e kanë karakterizuar botën në vitin 2019.

Pelosi rizgjedhet udhëheqëse e Dhomës së Përfaqësuesve

3 JANAR - Kongresistja e Kalifornisë, Nancy Pelosi, është rizgjedhur udhëheqëse e Dhomës së Përfaqësuesve në ShBA, që është roli i tretë më i fuqishëm në Uashington. Pelosi ka qenë në këtë pozitë për katër vjet, nga viti 2007. Ajo ka rimarrë çekanimin pasi ligjvënësit e rinj të Dhomës së Përfaqësuesve kanë bërë betimin. Fitorja e saj vjen në kohën kur Qeveria e ShBA-së ka qenë pjesërisht e mbyllur për shkak të mospajtimeve rreth ndërtimit të një muri në kufi me Meksikën, të cilin e do presidenti Donald Trump.

Kriza presidenciale në Venezuelë

10 JANAR - Kriza presidenciale e Venezuelës ka shpërthyer kur Asambleja Kombëtare e këtij vendi ka rishpallur president Nicolas Maduro. Ky vendim ishte kundërshtuar nga Juan Guaido, i cili është vetëshpallur president. Ai ka marrë mbështetje nga shumë vende të botës, mes tyre edhe nga ShBA-ja dhe BE-ja. Kriza në Venezuelë ka sjellë edhe viktima.

Maqedonia ndryshon emrin

11 JANAR - Kuvendi i Maqedonisë ka miratuar ndryshimet kushtetuese për ta mundësuar ndryshimin e emrit të vendit, në Republika e Maqedonisë së Veriut, sipas marrëveshjes së arritur në Prespë me Greqinë. Kjo marrëveshje ia ka hapur dyert Maqedonisë së Veriut që ta marrë ftesën për anëtarësim në NATO që pritet të ndodhë në muajt e parë të vitit 2020.

Qeveria britanike i mbijeton votës së mosbesimit

16 JANAR - Parlamenti britanik nuk e ka miratuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë së kryeministres Theresa May. Kundër rrëzimit të qeverisë kanë qenë 325 deputetë, ndërsa për kanë votuar 306.

Shmanget mbyllja e qeverisë amerikane

12 SHKURT - Demokratët dhe republikanët në ShBA kanë arritur marrëveshje në parim mbi

sigurinë në kufi, e cila do ta financojë qeverinë amerikane dhe do të shmangë një mbyllje tjetër të saj. Marrëveshja ka përbajtur vetëm një pjesë të parave që presidenti Donald Trump i ka kërkuar për ndërtimin e një muri në kufi me Meksikën dhe nuk përmend ndonjë barrierë konkrete.

Sulm terrorist në dy xhami në Zelandën e Re

15 MARS - 49 persona kanë vdekur dhe mbi 20 të tjerë janë plagosur rëndë si pasojë e dy sulmeve terroriste në dy xhami në qytetin Kristçerç të Zelandës së Re. Autoritetet kanë ndaluar dy burra dhe një grua, afër zonës ku janë konfiskuar armë të zjarrit. Një video 17-minutëshe, e një prej sulmeve ka nisur me një skenë ku një burrë e identifikon veten si Brenton Tarrant, teksa nisat drejt xhamisë Al Noor, vend në të cilin janë vrarë 49 persona. Në prapavijë dëgjohej një këngë nacionaliste serbe.

Digjet katedralja Notre Dame në Paris

15 PRILL - Katedralja e famshme Notre Dame e Parisit është përfshirë nga flakët. Katedralja mesjetare ka përfunduar së ndërtuari në shekullin e 13-të dhe sot ajo konsiderohet po aq kryevepër arkitekture, sa edhe një simbol fetar. E vendosur në Ile de la Cite, një ishull i vogël në mes të qytetit, katedralja është një nga objektet më të njohura turistike të Parisit dhe tërheq rreth 13 milionë vizitorë në vit. Për renovimin e saj kanë dhënë donacione shumë shtete dhe personalitete.

Komediani Zelensky zgjedhet president i Ukrainës

21 PRILL - Komediani ukrainas Volodymyr Zelensky pa përvojë politike ka fituar në zgjedhjet, duke u bërë president i Ukrainës. Zelensky si komedian ka luajtur presidentin fiktiv në një serial të popullarizuar televiziv. Ai është vetëm 41-vjeçar.

Partia e Erdoganit humbet qytetet kryesore në zgjedhje

31 MARS - Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, është përballur me humbje, teksa partia e tij AK-ja ka humbur kontrollin e kryeqytetit të këtij shteti, Ankaranë, për herë të parë në zgjedhjet lokale. Po ashtu, partia e Erdoganit ka humbur edhe Stambollin, edhe pse ky qytet kishte shkuar në rivotim.

Mbi 320 të vrarë në Shri Lankë, ISIS-i merr përgjegjësinë

21 PRILL - 321 persona kanë vdekur



dhe mbi 500 janë plagosur nga sulmet e ISIS-it në disa kisha dhe hotele të Shri Lankës. Tri kisha në Negombo, Baticaloa dhe Kolombo ishin në shënjestër të sulmeve, ashtu si edhe hotelet "Shangri-La", "Kingsbury" dhe "Cinnamon Grand" në kryeqytetin Kolombo. Në lidhje me këto sulme policia ka arrestuar mbi 40 persona.

Theresa May jep dorëheqje

25 MAJ - Kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May, ka deklaruar se më 7 qershor do të japë dorëheqje si lidere e Partisë Konservative, duke hapur kështu rrugë për një garë për të vendosur për kryeministrin e ri britanik. Dorëheqja e saj ka ardhur për shkak të dështimit të saj në raport me Brexit-in.

Boris Johnsoni, kryeministër i Britanisë

24 KORRIK - Boris Johnsoni është zgjedhur kryetar i ri i Partisë Konservatore dhe kryeministër i ri i Britanisë. Johnsoni e ka mposhtur kundërkandidatin Jermey Hunt. Johnsoni është betuar para Mbretëreshës Elizabeta II më 2 korrik.

Ndërron jetë Albert Rohan

5 QERSHOR - Ka ndërruar jetë diplomati austriak Albert Rohan, i cili ishte edhe zëvendës i kryenegociatorit të Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës. Rohani, i cilësuar shpesh si një diplomat shembullor, që nga vitet '90 ishte përfshirë në përpjekjet për ta vendosur paqen në Ballkan dhe për hapjen e perspektivës evropiane për vendet e rajonit. Ai kishte hyrë në shërbimin diplomatik që në vitin 1963 dhe fillimisht kishte shërbyer në ambasadat e Austrisë në Londër dhe Beograd.

Arrihet marrëveshja për drejtuesit e rinj të institucioneve të BE-së

2 KORRIK - Krerët e shteteve dhe qeverive të BE-së, pas një samiti maratonë, kanë arritur marrëveshje për emërimin e drejtuesve të institucioneve kryesore evropiane. Pas kësaj marrëveshje, ministrja gjermane e Mbrojtjes, Ursula von der Leyen, është zgjedhur presidente e Komisionit Evropian. Kryeministri i Belgjikës, Charles Michel, është presidenti i ri i Këshillit Evropian dhe politikën e

Jashtme të BE-së do ta udhëheqë ministri i Jashtëm i Spanjës, Joseph Borell.

Të paktën 60 persona vdesin nga sulmi në një dasmë në Kabul

18 GUSHT - Një bombë ka shpërthyer në një sallë dasmash në kryeqytetin e Afganistanit, Kabul, duke lënë të vdekur 63 persona dhe duke plagosur më shumë se 180 të tjerë. Shpërthimi ka ndodhur në perëndim të kryeqytetit, kryesisht të populluar me myslimanë shiitë. ISIS-i e kishte marrë përgjegjësinë për sulmin.

Digjet Amazona, G7-ta ofron 22 milionë dollarë

26 GUSHT - Malet e Amazonës janë përfshirë nga zjarret. Brazili ka dërguar 44 mijë ushtarë për të ndihmuar në ndaljen e zjarreve. Për t'i dalë në ndihmë Brazilit, liderët ndërkombëtarë janë pajtuar në samitin e G7-s që të ofrojnë ndihmë logjistike dhe financiare (22 milionë euro) për të ndihmuar në fikjen e zjarreve në rajonin e Amazonës. Malet e Amazonës konsiderohen si "mushkëritë e botës".



TERIZUAN BOTËN NË VITIN 2019



Trumpi shkarkon John Boltonin

10 SHTATOR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka shkarkuar këshilltarin për siguri kombëtare të Shtëpisë së Bardhë, John Bolton. Pas lirimit nga detyra, Trumpi ka thënë se nuk është pajtuar me shumë sugjerime të Boltonit.

Kina shënon 70-vjetorin e sundimit komunist, në Hong Kong dhunë

1 TETOR - Kamionë që transportonin armë, përfshirë raketa bërthamore, kanë parakaluar në Pekin, për ta shënuar 70-vjetorin e Kinës komuniste. Ngjarja ka shënuar përvjetorin e 1 tetorit 1949, datë kur ishte themeluar Republika Popullore e Kinës nga lideri i atëhershëm Mao Zedong. Megjithatë, përvjetori i 70 i Kinës komuniste është përcjell me protesta të dhunshme në Hong Kong, ku mijëra njerëz kanë kundërshtuar rritjen e kontrollit të Pekinit mbi shoqërinë dhe politikën e territorit të tyre. Protestat në Hong Kong kanë vazhduar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019, ku ka pasur mijëra protestues të arrestuar dhe të lënduar nga policia.

Pushtimi turk në Siri

9 TETOR - Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan ka njoftuar se një operacion i ri ushtarak turk ishte nisur në verilindje të Sirisë kundër milicive kurde siriane. "Forcat e Armatosura Turke dhe Ushtria Kombëtare Siriane (rebelët sirianë të mbështetur nga Ankaraja) kanë nisur operacionin 'Burimi i Paqes' në veri të Sirisë", ka thënë Erdogan. Komuniteti Ndërkombëtar dënoi pushtimin turk. Edhe gjatë vitit 2019 Siria ka qenë vatrë lufte, ku shumë persona janë vrarë.

Vritet lideri i ISIS-it

27 TETOR - Udhëheqësi i grupit militant Shteti Islamik (ISIS), Abu Bakr al-Baghdadi, është vrarë në një operacion të forcave speciale të ShBA-së në veriperëndim të Sirisë. Lajmin e ka bërë me dije presidenti amerikan Donald Trump. Duke folur nga Shtëpia e Bardhë, Trumpi ka thënë se al-Baghdadi e ka shpërthyer jelekun e tij vetëvrasës gjatë sulmit që është realizuar nga forcat amerikane.

Brexit-i shtyhet deri më 31 janar

28 TETOR - Bashkimi Evropian (BE)

është pajtuar për shtyrjen e Brexit-it, apo të daljes së Britanisë nga BE-ja, deri më 31 janar të vitit 2020. Lajmi është konfirmuar nga presidenti i atëhershëm i Këshillit Evropian, Donald Tusk.

Socialistët fitojnë zgjedhjet në Spanjë

11 NENTOR - Socialistët e Pedro Sanchezit, që kanë qeverisur deri më tani në Spanjë, kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare, mirëpo kanë humbur shumicën, meqë partitë e krahut të djathtë kanë shënuar fitore të mëdha. Partia Popullore konservatore është renditur e dyta dhe partia e së djathtës ekstreme ka fituar më shumë se dyfishin e votave në krahasim me zgjedhjet e kaluara, duke u shndërruar në partinë e tretë më të fuqishme në këtë shtet.

Përçarjet midis aleatëve përcjellin samitin e NATO-s

3 DHJETOR - Udhëheqësit e NATO-s janë mbledhur në një samit dyditorë në Londër për ta shënuar 70-vjetorin e themelimit të Aleancës Veriatlantike. Samiti,

megjithatë, ka mbetur nën hijen e debateve të ashpra për shpenzimet në mbrojtje, politikën në Siri etj. Pak javë para se të mbahej samiti, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë se NATO-s "i ka vdekur truri". Kjo deklaratë ka "zëmëruar" presidentin amerikan Donald Trump dhe atë të Turqisë, Rexhep Taip Erdogan.

Merkeli vizitoi Aushvicin

6 DHJETOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka vizituar ish-kampin nazist në Aushvic, për herë të parë në 14 vjetët e saj si kancelare. Vizita e Merkelit është bërë në kohën kur Gjermania po shënon një ringjallje të antisemitizmit dhe rritje të elementeve të krahut të djathtë. Merkel është kancelarja e tretë gjermane që ka vizituar ish-kampin në Poloni. Udhëtimi i saj është jashtëzakonisht simbolik, pasi bëhet para shënimit të 75-vjetorit të çlirimit të këtij kampi nga trupat sovjetike më 27 janar 1945.

Betohet kryeministrja më e re në botë

10 DHJETOR - Sanna Marin ka marrë udhëheqjen e Qeverisë së Finlandës, duke u bërë kryeministrja më e re në botë. Marin, 34 vjeçe, është betuar para Parlamentit finlandez. Deri më tash ajo ka qenë ministre e Transportit, ndërsa paraprakisht ka shërbyer edhe si deputete dhe zëvendëskryeministre. Kryeministri i dytë më i ri në botë është ai i Ukrainës, Oleksi Honcharuk, 35 vjeç.

Boris Johnson fiton zgjedhjet në Britani

12 DHJETOR - Partia Konservatore e kryeministrit britanik Boris Johnson ka fituar zgjedhjet e parakohshme parlamentare, duke ia mundur atij ta bëjë i vetëm qeverinë. Pas fitores Johnsoni ka thënë se partia e tij ka siguruar mandat të fuqishëm për ta përfunduar Brexit-in. Ai e kishte çuar vendin në zgjedhje për shkak se parlamenti britanik nuk e kishte mbështetur për daljen e Britanisë nga BE-ja.

Ish-presidenti i Pakistanit, Pervez Musharraf, dënohet me vdekje

17 DHJETOR - Një gjykatë në Islamabad e ka dënuar me vdekje ish-udhëheqësin ushtarak të Pakistanit, gjeneralin Pervez Musharraf. Ai është dënuar në mungesë, pasi është shpallur fajtor për tradhti. Musharraf ka marrë udhëheqjen e Pakistanit me një grushtshtet në vitin 1999 dhe ka shërbyer si president i

këtij vendi nga viti 2001 deri më 2008.

49 gazetarë vriten në botë gjatë vitit 2019

17 DHJETOR - Organizata e Reporterëve pa Kufij ka bërë me dije se 49 gazetarë janë vrarë në vitin 2019, 389 janë burgosur dhe 57 të tjerë janë marrë pengje. Kjo organizatë ka theksuar se numri i gazetarëve të vrarë në vitin 2019 është në nivelin më të ulët në 16 vjet. Vrasja e gazetarëve ka ndodhur në Siri, Afganistan, Jemen dhe Meksikë, ndërsa burgosja e tyre ka ndodhur në Kinë, Egjipt dhe Arabi Saudite.

Miratohehen akuzat për shkarkimin e Trumpit

19 DHJETOR - Dhoma e Përfaqësuesve e Kongresit Amerikan ka miratuar dy akuza për shkarkimin e presidentit Donald Trump. Kjo është hera e tretë në histori që një president i nënshtrohet procesit të shkarkimit në bazë të shkeljeve të parashikuara në Kushtetutë. Miratimi i këtyre akuzave ka ardhur si rezultat i dyshimeve të Trumpit për presion ndaj homologut ukrainas Volodymyr Zelensky për ta hetuar rivalin e tij demokrat për zgjedhjet presidenciale të 2020-s, Joe Biden. Tani gjyqi ndaj presidentit do të zhvillohet në Senat, i cili dominohet nga republikanët.

Greva e punëtorëve të transportit në Francë

25 DHJETOR - Franca është përfshirë në greva. Punëtorët e transportit janë në grevë që nga muaji nëntor. Ata kanë vazhduar grevën edhe në Ditën e Krishtlindjes. Në negociatat në mes të qeverisë dhe sindikatave nuk është arritur marrëveshje. Sindikalistët janë zotuar se nuk do të heqin dorë nga planet për t'i shkrirë 42 skemat për pensione në një. Sipas këtyre reformave, ata që dalin në pension para moshës 64 vjeç do të marrin pension më të ulët. Bisedimet pritet të rinisin më 7 janar.

OKB: Më shumë se 235 mijë njerëz kanë ikur nga rajoni i Idlib-it në Siri

27 DHJETOR - Më shumë se 235 mijë njerëz kanë ikur nga shtëpitë e tyre në provincën Idlib të Sirisë, kanë njoftuar Kombet e Bashkuara, ndërsa forcat qeveritare kanë shtuar ofensivën e tyre në këtë zonë. Eksodi ka ndodhur midis 12 dhe 25 dhjetorit derisa janë shtuar luftimet. Idlib në veri-perëndim të Sirisë është rajoni i fundit i madh i mbajtur nga rebelët që kundërshtojnë presidentin Bashar al-Asad.

FLET PËR "EPOKËN E RE", BERNARD CHALLANDES, TRAJNER I PËRFAQËSUESSES SË KOSOVËS NË FUTBOLL

CHALLANDES: KUALIFIKIMI I KOSOVËS NË 'EURO 2020', HISTORIK PËR GJITHË EVROPËN



Trajneri Bernard Challandes ka vlerësuar lart ngritjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ai ka thënë se nëse sigurohet kualifikimi në "Euro 2020" do të jetë historik jo vetëm për Kosovën, por për të gjithë Evropën. "Shpresoj që mund të bëjmë këtë surprizë të madhe me kualifikim në evropian. Do të ishte historike jo vetëm për Kosovën, por për të gjithë Evropën. Për mua do të ishte e njëjta histori si kur Greqia e fitoi kampionatin në Portugali", ka thënë Challandes

shkëlqyer, kanë bërë lojërë të mira dhe praktikisht ne kemi zgjedhur një filozofi të mirë të lojës dhe të gjithë kanë qenë në pajtim me këtë filozofi që të punojmë së bashku. Për shembull, lojtarët ofensivë të punojnë në grup dhe tani kemi këtë rezultat. Mendoj se një trajner i mirë është një trajner që ka lojtarë të mirë në ekip, ka nevojë për ta dhe për këtë më duhet ta falënderoj edhe Federatën e Futbollit që na ka përkrahur për gjithçka. Falënderoi edhe stafin tim për punën e mirë. Pra, kjo është arsyeja e suksesit tonë.

duke mos menduar si "ne", pra kjo ishte puna ime e parë. Kam parë se ne kemi lojtarë të mirë, kemi potencial me këta lojtarë, por vetëm nëse luajmë të bashkuar. Ekipi ishte i ri dhe lojtarët ishin në moshë të re si dhe mentaliteti i lojtarëve të Kosovës ishte ndryshe, prandaj pyetja ishte sa kohë më duhet për ta krijuar këtë ekip? Surprizë për mua ka qenë se ndodhi shpejt, lojtarët kanë pranuar shpejt mesazhin dhe filozofinë time dhe kemi punuar me këtë filozofi. Për një kohë të shkurtër kemi ndryshuar, e kemi pasur Ligën e Kombeve dhe fitorja nuk ka qenë pretendimi ynë. Ishte vetëm një mundësi e parë për ta zhvilluar këtë mentalitet si ekip. Në rregull, ne fituam në ligë, por në asnjë moment nuk e kemi menduar të fitojmë apo ta arrijmë kualifikimin në atë kohë. Gjithmonë kemi folur vetëm për përparim, për zhvillim të ekipit dhe jo për kualifikim. Mendoj se kjo ishte e mirë. Rasti i vetëm kur kishim problem me këtë filozofi ishte ndeshja kundër Çekisë. Ndoshta këtë ditë harruam të luajmë apo, më mirë të them, këtë ditë Çekia ishte më e mirë se ne dhe nuk na dha mundësinë ta kemi topin, të krijojmë raste apo edhe të shënojmë. Ne jemi mbrojtur, kemi vrapuar dhe kemi luftuar, por nuk kemi luajtur lojën tonë. Kam folur shumë me skuadrën para kësaj loje dhe u kam thënë futbollistëve mos mendoni për kualifikim, luajeni lojën tonë, merrni përsipër rrezikun, krijoni nga mbrapa, por

nuk ishte e mundur. Gjithmonë kemi luftuar sepse ky ekip është i mirë edhe me mentalitet të mirë, por që nuk ishte mjaftueshme për të fituar.

"Epoka e re": Kosova në kualifikime zhvilloi edhe dy përballje me Anglinë dhe, përkundër rezultatit, paraqitja është vlerësuar pozitive në opinion. A ka qenë e mundur që rezultati të jetë më i mirë dhe të mos pranohen tre gola në dhjetë minutat e fundit?

Challandes: Ndaj Anglisë ishte një histori tjetër, por jam i kënaqur me dy ndeshjet sepse ne kemi luajtur, kemi krijuar dhe kemi pasur një përvojë të mirë. Kemi luajtur me disiplinë, lojë taktike për 80 minuta. Ishte vetëm 1-0 pas 80 minutave dhe tani është dashur të rrezikojmë për 1-1. Inkuadrova në lojë dy lojtarë ofensivë, të gjithë donin që të vinte ky gol dhe shpejt pranua tre gola për shkak të organizimit të mbrojtës që nuk ishte e mirë. Kishim ndërmarrë një rrezik dhe Anglia është shumë e fortë në sulm e nëse i lejon hapësirë, normalisht se të dënon. Është e qartë se Anglia është më e fortë, por në atë moment ishte një mundësi për barazim apo për të bërë diçka më mirë, por unë isha i kënaqur me këtë mentalitet dhe e njëjta vlen edhe për të ardhmen.

"Epoka e re": Kualifikimi në evropian nuk u arrit edhe përkundër rezultateve dhe paraqitjeve të mira në kualifikime. Megjithatë, është edhe një

mendoj se shanset janë 50 me 50", ka thënë Challandes, i cili kualifikimin eventual të Kosovës në Evropian e krahason me triumfin e Greqisë në vitin 2004.

"Epoka e re": Trajner, viti 2019 po vlerësohet në Kosovë vit i sportit, konkretisht futbollit. Ju po konsideroheni meritor për rezultatet e pozitive të Përfaqësueses. Cili është koment juaj?

Challandes: Jam i lumtur për këtë vit dhe për këtë "shpërblim" gjithashtu. Është nder i madh për mua ta pranoj këtë vlerësim, por për mua gjithmonë është e njëjta, sukcesi i skuadrës në rend të parë. Mund të them se në fillim të aventurës sime me Përfaqësuesen kam folur për mundësinë e suksesit, por vetëm si ekip. 'Ok'. Unë jam trajneri dhe pranoj vlerësime pozitive, por për mua është e rëndësishme të punojmë së bashku dhe më të rëndësishmit janë lojtarë të cilët kanë bërë një punë të

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, DHJETOR - janar - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, në intervistën për numrin festiv të gazetës "Epoka e re" ka folur për kohën që është në krye të "Dardanëve". Ai është shprehur i lumtur për rezultatet dhe paraqitjet e Kosovës në Ligën e Kombeve, por edhe në kualifikueset për Kampionatin Evropian. Strategu zviceran e ka komentuar edhe ndeshjen gjysmëfinale në Ligën e Kombeve ndaj Maqedonisë Veriore, duke thënë se shanset janë 50 me 50 për kualifikim. "Ne kemi fituar grupin dhe tani kemi mundësinë, por nuk do të jetë lehtë sepse lojtarët nuk luhen në Prishtinë. Maqedonia Veriore është një ekip i mirë dhe lojtarët e saj luajnë në Itali, Spanjë dhe Rusi. Edhe ne sikurse kundërshtari kemi një ekip të mirë dhe



mundësi që një gjë e tillë të arrihet nëpërmjet Ligës së Kombeve. Në gjysmëfinale kundërshtar e kemi Maqedoninë e Veriut. Sa janë gjasat për ta kaluar fillimisht këtë kundërshtar?

Challandes: Më kujtohet mirë teoria e parë me ekipin në Paris para ndeshjes me Madagaskarin në muajin mars të 2018-s, ku kam folur lidhur me Ligën e Kombeve. Kam thënë se ne duhet të kemi një ëndërr që është kualifikimi në "Euro 2020", pra një ëndërr dhe jo qëllim. Aty iu kam thënë futbollistëve se kjo ligë ta jep mundësinë e kualifikimit dhe shkuarjes në "play-off". Isha i sigurt se mund ta fitonim grupin në Ligën e Kombeve, pasi ishte një mundësi për t'i mposhtur Azerbajxhanin, Maltën dhe Ishujt Faroe. Kisha një bindje se Azerbajxhani nuk ishte kundërshtar i lehtë, por jo edhe i pakalueshëm. Ne kemi fituar grupin dhe tani kemi mundësinë, por nuk do të jetë lehtë sepse lojtarët nuk luhen si vendas ku kemi një përkrahje të fuqishme në Prishtinë. Maqedonia Veriore është një ekip i mirë dhe lojtarët e saj luajnë në Itali, Spanjë dhe Rusi. Edhe ne sikurse kundërshtari kemi një ekip të mirë dhe mendoj se shanset janë 50 me 50. Për ne ka shumë rëndësi që t'i kemi të gjithë lojtarët e gatshëm, të mos kemi mungesa sepse nuk jemi skuadër si Franca, Gjermania apo Brazili që mund t'i zëvendësojmë mungesat dhe ta kemi ekipin e fortë. Pastaj është vetëm një lojë ku një gabim mund ta vendosë rezultatin e ndeshjes. Nëse e shohim nivelin e dy ekipeve, unë nuk kam frikë nga Maqedonia Veriore, por vetëm respekt. Në këtë ndeshje kemi nevojë ta luajmë lojën tonë dhe mos të bllokohemi duke menduar për rezultat dhe kualifikim. Futbollistët duhet të jenë të qetë dhe të luajnë sikurse dinë dhe atëherë mundësia është të fitojmë këtë gjysmëfinale.

"Epoka e re": *Po supozojmë se Kosova do ta kalojë Maqedoninë Veriore dhe në finale do të përballlet me fituesin e ndeshjes Bjellorusia - Gjeorgjia. Cili është vlerësimi juaj për këto përfaqësuese dhe cilën do ta preferonit në finale?*

Challandes: Bjellorusia dhe Gjeorgjia janë pothuajse të njëjta. Gjeorgjia ka bërë shumë për ekipin kombëtar që 10-15 vjet dhe është një ekip i mirë, nuk është kundërshtar i lehtë dhe këtë e them pasi e kam parë kur ishte në grup me Zvicrën. Mund të them se është ekip agresiv dhe shumë kompakt, por prapë nuk është Francë, Gjermani, Portugali apo Belgjikë. Edhe Bjellorusia është e njëjtë, por në të njëjtën kohë edhe ne kemi një ekip të mirë dhe kemi treguar që gjithçka është e mundur, prandaj kualifikimi është i mundur për Kosovën. Ka qenë një ëndërr, por tash është një qëllim ynë. Për të arritur këtë qëllim duhet të kemi shumë mentalitet, teknikë, disiplinë dhe punë. Ne duhet të dimë si të luajmë, si të bëjmë presion, si të bëjmë kompakt në mbrojtje dhe sulm dhe jo të mendojmë se duhet patjetër të fitojmë. Gjithmonë duhet të kemi respekt për kundër-



shtarin, duhet të dimë se çka vjen prej një kundërshtari të tillë, por më e rëndësishmja është se çfarë do të bëjmë ne.

"Epoka e re": *Nëse arrini ta kualifikoni Kosovën në Evropian, a keni vendosur diçka rreth të ardhmes suaj?*

Challandes: Kualifikimi nuk është ëndërr vetëm për ekipin, por edhe për mua si trajner. Nuk e di të ardhmen time. Në vitin 2020 mbushi 69 vjeç dhe e di se sa energji duhet të kesh në këtë detyrë. Ndoshta mund të jetë Kampionati Evropian përfundimi i karrierës time. Kam mësuar në jetë që në shumë situata të mos planifikosh, sidomos në futboll, pasi është i paparashikueshëm. Fokusi im është për ekipin dhe kualifikimet dhe jo për të ardhmen time, por ju duhet të jeni të sigurt se kam kënaqësi të madhe që jam pjesë e këtij ekipi. Për të ardhmen time duhet të vendos, por më e rëndësishme është që ta ndiej kënaqësinë edhe të lojtarëve, dëshirën e stafit, federatës, sepse mua më pëlqen të punoj në harmoni. Nganjëherë e ke atë ndjenjën që ndoshta është koha të ndryshosh për faktin se një lojtar ka nevojë për një lloj tjetër diskutimi, tjetër mentalitet, fjalë të tjera nga trajneri. Ne po punojmë mirë së bashku, nganjëherë disa lojtarë nuk janë të lumtur kur nuk luajnë, por nuk është diçka specifike për Kosovën, është normale. Skuadra është e bashkuar, e ndiej dëshirën e lojtarëve kur ata vijnë këtu për secilën lojë, kjo është e rëndësishme për mua. Do të jetë e rëndësishme për mua edhe në momentin kur dua të vazhdoj me Kosovën, ta përfundoj karrierën, apo të vazhdoj në ndonjë ekip tjetër.

"Epoka e re": *Në muajin janar zhvillohet ndeshja miqësore me Suedinë. A do ta shfrytëzoni këtë ndeshje për të parë nga afër lojtarët e Superligës?*

Challandes: Kemi pranuar këtë mundësi për të luajtur këtë ndeshje me Suedinë B, pasi është një ekip i fortë dhe ka lojtarë të ndryshëm që luajnë në skuadrat si Jaenkopins, Malmo ku bëjnë pjesë në një ligë të fortë. Neve na është dhënë një

mundësi për të parë lojtarë të ri që luajnë edhe në ligën e Kosovës. Nuk ka rëndësi a luajnë në Prishtinë apo Bremen, por nëse luan në Bremen do të thotë se të rritet mundësia të luash në ekip, pasi për të luajtur në një skuadër të tillë duhet të jesh lojtar i mirë. E kam pranuar këtë ofertë për ndeshjen me Suedinë, sepse ne kemi menduar me drejtuesit e federatës se është një mundësi e mirë për të parë lojtarë që luajnë edhe në Kosovë. Nuk është problem vetëm për lojtarët në Kosovë, por kam propozime për lojtarët që luajnë edhe në mbarë Evropën. Unë gjithmonë them në rregull dhe pyes se për ku luan lojtari i propozuar. Kur marrë përgjigje se në ligën e dytë të Austrisë, pyes edhe për pozitën dhe kur kuptoj se është sulmues, atëherë bëjë krahasimin me lojtarët që kemi si Rashica që luan në Bremen, Muriqi në Fenerbaçe, Zeneli në Reims, Zhegrova tani po luan mirë në Basel, pastaj janë Celina, Berisha, Halimi etj. Në fillim ndoshta ka qenë më ndryshe, sepse kemi pasur nevojë ta ndërtojmë ekipin, kurse tani nuk është njëjta, dera është e hapur, por nuk është e lehtë të futesh brenda sepse tash kam krijuar një grup shumë të mirë. Për mua një lojtar gjithmonë mund të vijë, por jo vetëm sa për të marrë një tjetër. Ekipi ka avancuar dhe, po ashtu, edhe lojtarët të cilët po luajnë në klube të mira dhe është e vështirë që të fitohet një vend në 23-she.

"Epoka e re": *A keni vërejtur ndonjë lojtar që aktivizohet në Superligën e Kosovës dhe që në të ardhmen mund të ishte pjesë e Përfaqësueses?*

Challandes: Në këtë ndeshje e kam mundësinë për të parë disa lojtarë të tjerë. Ideja është të marr lojtarë për të ardhmen, për shembull Shabani është një lojtar që më pëlqen shumë, por është 33 vjeç dhe nuk mund ta ftoj pasi në atë pozitë kam Rashicën dhe Zhegrovën, prandaj është më mirë t'i jepet rasti një lojtari të ri. Unë i kam ndjekur disa lojtarë, por edhe flas me asistentin tim. Në Kosovë janë disa lojtarë të mirë në repartin e mbrojtjes si Bekteshi, Namani dhe Lladrovci, por problemi është se janë 27-28 vjeçar. Dera është e hapur për të gjithë lojtarët, por po e rrithej edhe një herë, konkurrenca është e madhe në ekip.

"Epoka e re": *Sigurisht se prej se jeni trajner i Kosovës keni përjetuar shumë çaste të mira, por cilin do ta veçonit?*

Challandes: I kam pasur disa çaste të mira. Për mua janë dy situata, nganjëherë për mua është edhe vetëm një aksion, për shembull goli i parë i Zenelit kundër Azerbajxhanit, i cili ishte gol tipik i tij dhe shumë i rëndësishme si finale për të fituar. Na dha mundësi për të qenë këtu ku jemi. Pas atij goli kemi shënuar edhe tre gola të tjerë, por ajo lojë ishte e para më shumë emocion. Po ashtu, kemi luajtur edhe kundër Maltës dhe

Ishujve Faroe, por me Azerbajxhanin këtu ishte finale dhe një moment madhështor dhe shumë i rëndësishëm, sepse tani jemi këtu falë asaj fitore. Ndeshja kundër Çekisë ishte, po ashtu, shumë e vështirë dhe goli i Vojvodës ishte në një moment kur Çekia bënte presion, por për mua nuk është vetëm momenti, është më shumë zhvillimi i skuadrës, mënyra e punës, prandaj mund të them se momenti im i mirë është i gjatë falë këtij ekipi.

"Epoka e re": *Po cili ishte momenti më i hidhur prej se jeni trajner i Kosovës?*

Challandes: Momenti më i hidhur ka qenë kundër Çekisë sepse nuk gjetëm zgjidhje për lojën tonë jo për rezultatin, por për mënyrën që luajtëm. Në fund nuk isha i lumtur sepse kishim mundësi më të mira. Normalisht se nuk mund të kërkoj vetëm lojë të përkryer. Mungesa e Muriqit ishte e madhe. Besoj se Nuhui ka bërë punë të mirë, ka punuar për ekipin, por Muriqi deri atëherë ka qenë një lojtar shumë me rëndësi për ne. Nuk kemi lënë shumë gjëra për t'u bërë pishman dhe nëse do të pyeteshim në fillim të kampanjës që do t'i luaj dy ndeshje të fundit për kualifikim, të gjithë do të thoshin se mund të jem i çmendur. Në fillim humbëm dy pikë këtu kundër Bullgarisë. Bullgarët kanë ekip të mirë dhe nuk është e lehtë të luash kundër tyre apo Malit të Zi. Nganjëherë frikësohem që kemi krijuar kaq shumë entuziazëm dhe eufori për këtë ekip sa që mund të harrojmë kush jemi.

"Epoka e re": *Kosova është vetëm dy ndeshje larg kualifikimit historik në Evropian. Cilat janë pritshmëritë e juaja për kualifikim si trajner?*

Challandes: Ne jemi Kosova, ne kemi një skuadër të mirë, kemi djelmosha të mirë dhe kemi zhvilluar lojëra të mira. Shpresoj që mund të bëjmë këtë surprizë të madhe me kualifikim në evropian. Do të ishte historike jo vetëm për Kosovën, por për të gjithë Evropën. Për mua do të ishte e njëjta histori si kur Greqia e fitoi kampionatin në Portugali. Shpresoj që nëse shkojmë në Evropian, Rumania të arrijë kualifikim dhe në këtë situatë ne të ndryshojmë grup dhe të jemi në grup me Gjermaninë, Francën dhe Portugalinë.



NGJARJET KRYESORE TË SPORTIT GJATË VITIT 2019



EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

Plot medalje nga sporti
xhudos

PRISHTINË, DHJETOR - janar - Viti 2019 ka qenë i jashtëzakonshëm për sportin e Kosovës. Përfaqësuesja pati një vit të suksesshëm ani pse nuk arriti kualifikimin në Kampionatin Evropian, por një gjë të tillë mund ta bëjë nëpërmjet Ligës së Kombeve në muajin mars 2020. Historinë e ka shkruar sporti i hendbollit, konkretisht Përfaqësuesja U21, e cila u kualifikua në Kampionatin Botëror si ekipi i parë i sporteve kolektive. Në botëror "Dardanët" kishin grup të fortë, por shijuan edhe fitoren. Xhudoja, e udhëhequr nga Driton Kuka, nuk ka të ndalur, medaljet fitohen në çdo garë ku marrin pjesë Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Akil Gjakova, Lorian Kuka e xhudistët e tjerë. Në arenën ndërkombëtare spikat triumfi i Liverpoolit në Ligën e Kampionëve. Në Formula 1 ligjin po e bën Lews Hamiltoni, kurse Lionel Messi e fitoi për herë të gjashtë "Topin e Artë".

24 janar - Sporti i xhudos tashmë e ka bërë traditë që të sjellë medalje në Kosovë nga secila garë ndërkombëtare që merr pjesë. Kampionia Olimpikë, Majlinda Kelmendi, e nisi në mënyrën më të mirë vitin 2019, pasi e fitoi medaljen e artë në Grand Prixin e xhudos në Tel Aviv të Izraelit. Në finale, Majlinda e mposhti izraeliten Gili Cohen (52 kg). Në këtë garë medalje fitoi edhe Lorian Kuka, e cila ishte befasia më e madhe e këtij viti nga sporti i xhudos. Lorian e fitoi medaljen e argjendtë. Një muaj më vonë, Distria Krasniqi (48 kg) e fitoi medaljen e argjendtë në Grand Slamin e Parisit. Në skenë sërish u shfaq Majlinda Kelmendi që e fitoi medaljen e dytë të artë këtë vit. Majlinda në Grand Slamin e xhudos në Dyseldorf të Gjermanisë e fitoi të artën pasi në finale e mposhti mongolezen Sosorbaram Lkhagvasuren. Ndërsa në Grand Prixin e xhudos Marrakech 2019 të Marokut, Lorian Kuka e rrëmbeu medaljen

e argjendtë. Medalje të argjendtë, të parën në karrierë, e ka fituar edhe Fationa Kasapi, në Kupën Evropiane për Kadete, në Zagreb të Kroacisë. Ndërsa Erza Muminoviq dhe Flaka Loxha i kanë sjellë dy medalje Kosovës në Kupën Evropiane të Xhudos për Juniore (U21) që është mbajtur në Athinë të Greqisë. Erza fitoi të artën falë pesë fitoreve, kurse Flaka shënoi pesë fitore, katër me luftë. Në fund të muajit mars, xhudistet Lorian Kuka dhe Nora Gjakova fituan dy medalje të arta në Tbilisi të Gjeorgjisë. Lorian Kuka e fitoi të artën në kategorinë deri në 78 kilogramë, pasi në finale e mposhti Kliema Antomarchi të Kubës. Ndërsa Nora Gjakova fitoi medaljen e artë në kategorinë deri në 57 kilogramë. Në muajin prill, Distria Krasniqi e ka fituar medaljen e artë në Grand Prixin e mbajtur në Antalia të Turqisë. Në finale Distria e mposhti Otgontsetseg Galbadrakh e Kazakistanit. Ndërsa Erza Muminoviq e ka fituar medaljen e artë në kupën evropiane të xhudos, për kadetë në Rumani. Xhudo doli e suksesshme edhe në Lojërat e dyta Evropiane "Minsk 2019". Kosova fitoi tri medalje: Të artën e fitoi Majlinda Kelmendi, të argjendtën Nora Gjakova, ndërsa të bronzën Lorian Kuka. Në muajin korrik në Grand-Prixin e Budapestit, xhudo e mbylli me bilancin e një medaljeje të artë, dy të argjendta, një vend të pestë dhe një të shtatë. Të artën e fitoi Akil Gjakova në kategorinë deri në 73 kg dhe dy të argjendta u fituan nga Nora Gjakova (57 kg) dhe Distria Krasniqi (48 kg). Në muajin dhjetor Distria Krasniqi e fitoi medaljen e artë në Mastersin e xhudos në Qingdao të Kinës, pasi në finale e mposhti mongolezen Narantsetseg Ganbaatar.

Fitues të shumtë në tenis

27 JANAR - Fitues i Australian Open është shpallur Novak Djokoviq, pasi në finale e mposhti Rafael

Nadalin, kurse te femrat Naomi Osaka e mposhti Petra Kvitovan. Serbi Novak Djokoviq është fituesi i turneut Wimbledon, pasi në finale mposhti Roger Federerin, derisa te femrat Simona Halep e mposhti Serena Williams. Rafael Nadali e ka fituar US Openin. Spanjollit në finale triumfoi ndaj rusit Daniil Medvedev, kurse te femrat fituese doli Bianca Andreescu ndaj Williamsit. Në Franch Open, Nadali e mposhti Dominic Thiem, kurse te femrat Ashleigh Barty e mposhti Marketa Vondrousova.

Musa Hajdari, i argjendtë në kampionatin ballkanik në Stamboll

18 SHKURT - Atleti Musa Hajdari ka fituar medaljen e argjendtë në kampionatin ballkanik të sallës për senior, të mbajtur në Turqi. Hajdari fitoi medaljen në disiplinën 800 metra. Ai arriti në cak me kohë 1:49.31, vetëm 11 të qindtat larg normës evropiane. Musa Hajdari është bursist për "Tokio 2020".

Tetë medalje për karatenë nga Kampionati Mesdhetar

7 PRILL - Ekipi i Kosovës në karate fitoi tetë medalje në kampionatin mesdhetar, që u mbajt në Antalia të Turqisë. Rigon Baruti fitoi medaljen e artë për kadetë (57 kg). Të bronzën e fituan Elton Musliu dhe Melos Gashi (+70 kg). Në grupmoshën e juniorëve, Betim Maliqi fitoi medaljen e argjendtë (-68 kg), ndërsa Endrit Shaqiri të bronzën (+76 kg). Në grupmoshën U21, Bunjamin Shabani fitoi të argjendtën në kategorinë 75 kilogramë, ndërsa Albulena Gërvalla (-55 kg) dhe Donita Elshani fituan të bronzën në (-68 kg). Karateja i solli Kosovës edhe dy medalje evropiane nga Danimarka, ku Albulena Gërvalla e fitoi të bronzën për U-21. Ndërsa Melos Gashi, në kategor-

inë e kadetëve, arriti ta rrëmbejë medaljen e argjendtë.

Hendbollistët U21 bënë historinë

14 PRILL - Përfaqësuesja e Kosovës U21 në hendboll, nën drejtimin e strategut Fatmir Muhaxheri, u bë skuadra e parë ekipore që siguroi kualifikimin në kampionat botëror. "Dardanët" e rinj u kualifikuan në botëror, pasi fituan finalen me Taipei Kinez, me rezultat 30-26, në kuadër të garës IHF Trophy Intercontinental. Në botëror grupi i Kosovës ishte shumë i vështirë. "Dardanët" janë mposhtur nga Kroacia, Hungaria, Portugalia, Brazili dhe Argjentina, ndërsa Kosova luajti baras me Bahrejin dhe e mposhti Australinë.

Garuesit nga Kenia triumfojnë në gjysmëmaratonën 'Prishtina 2019'

28 PRILL - Rreth 1200 garues kanë marrë pjesë në edicionin e 19 me radhë të gjysmëmaratonës 'Prishtina 2019'. Çmimet kryesore edhe këtë edicion i fituan garuesit nga Kenia. Shtegun 21 kilometërsh Prishtinë-Obiliq-Fushë-Kosovë dhe anasjelltas e kaloi edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Pjesëmarrës në gjysmëmaratonë ishte edhe presidenti i KOK-ut, Besim Hasani.

Prishtina dominon në basketboll në të dyja konkurrencat, Peja rikthehet në Superligë

14 MAJ - KB Prishtina është shpallur kampion i edicionit 2018/19, pas triumfit ndaj KB Rahovecit në serinë finale 3-1. Kryeqytetasit triumfuan në ndeshjen e fundit me rezultat 75-104 dhe në këtë mënyrë e rrëmbyen titullin e 14-të në histori. Prishtina e fitoi edhe





Kupën e Kosovës, pasi edhe në këtë finale e mposhti Rahovecin (96-60). Prishtina e fitoi edhe titullin dhe Kupën në konkurrencën e femrave. Lajm i mirë për basketbollin ishte rikthimi i KB Peja në Superligë

Barça, Juve, City, Bayerni dhe PSG-ja mbrojtën titujt

18 MAJ - Barcelona e mbrojti titullin në La Liga pasi përfundoi e para me 87 pikë, i dyti ishte Atletico Madridi me 76, kurse Reali i treti me 68. Edhe Juventusit e mbrojti titullin në Serinë A, duke e mbyllur kampionatin me 90 pikë, kurse Napoli përfundoi i dyti me 79 pikë. Manchester City, pas një gare të fortë me Liverpoolin, arriti që ta mbrojë titullin e kampionit në Premierë Ligë. City u shpall kampion me 98 pikë, kurse Liverpooli përfundoi në vendin e dytë me një pikë më pak. Titullin e mbrojti edhe Bayern Muncheni në Gjermani. Bayerni fitoi ndeshjen e fundit ndaj Frankfurtit (5-1) dhe e fitoi me 78 pikë të grumbulluara. Në Francë, Paris Saint-Germain ishte i pakonkurrencë pasi e fitoi titullin shtatë javë para fundit, por në fund kishte një diferencë prej 16 pikësh me skuadrën e Lilles.

Bodibilderët fitojnë katër medalje në Kampionatin Ballkanik

19 MAJ - Garuesit e bodibildingut dhe fitnessit të Kosovës në Kampionatin Ballkanik të mbajtur në Corfu të Greqisë fituan dy medalje të arta, një të argjendtë dhe një të bronzë. Bodibilderi Besard Maxharraj (100 kg) e fitoi të artën dhe u shpall kampion absolut (më i miri në të gjitha kategoritë e bodibildingut). Të artën e fitoi edhe Kushtrim Bajraktaraj (85 kg). Aldon Sadiku doli i dyti në kategorinë Classic Bodibilding - 180 cm, ndërsa Flamur Gerbavci ishte i treti në Classic Bodibilding -

175 cm. Blerta Ibrahimit zuri vendin e gjashtë në Wellnes, kurse Florent Kadrolli ishte i shtati në Classic Bodibilding kategoria +180 cm.

Pranohet ndërkombëtarisht Federata e Badmintonit të Kosovës

23 MAJ - Federata e Badmintonit të Kosovës (FBK) ka kryer me sukses procesin e ndërkombëtarizimit. Kjo federatë u pranua me të drejta të plota në Federatën Botërore të Badmintonit (EBF), duke u bërë anëtarja e 192-të.

Feronikeli fiton titullin dhe Kupën, bashkë me Prishtinën dalin në Evropë

24 MAJ - Skuadra e Feronikelit e fitoi titullin në Superligën e Kosovës në futboll, pasi e mposhti Prishtinën në ndeshjen e fundit me rezultat 1-0. Golin e vetëm e realizoi Yll Hoxha. "Nikli" e mbylli kampionatin me 80 pikë, kurse arriti të fitojë edhe Kupën duke e mposhtur në finale Trepçën 89 (5-1). Feronikeli më pas mori pjesë në garat e Ligës së Kampionëve e në Ligën e Evropës, por pa lënë ndonjë gjurmë sikurse që nuk la as skuadra e Prishtinës në Ligën e Evropës.

Besa Famgas vazhdon dominimin në Superligë, Vashat e Istogut fitojnë titullin dhe Kupën

25 MAJ - Besa Famgas ka fituar titullin e gjashtë radhazi të kampionit të Kosovës në hendboll. Besa në ndeshjen e fundit e mposhti Kastriotin në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj (26-25), ndërsa skuadra e Kastriotit e fitoi Kupën, pasi e mposhti në gjysmëfinale Besën e në finale Prishtinën. Në Superligën e femrave fituese dolën vashat e Istogut, derisa kjo skuadër e fitoi edhe Kupën e Kosovës.

Liga e Evropës dominohet nga anglezët, Liverpooli fiton Superkupën dhe Botërorin e Klubeve

29 maj - Liverpooli arriti ta fitojë Ligën e Kampionëve pasi në finale mposhti Tottenhamin (2-0). Golat i shënuan Mohamed Salah dhe

Divock Origi. Ndërsa shqiptari Xherdan Shaqiri për herë të dytë e fitoi titullin e Ligës së Kampionëve. Edhe finalja e Ligës së Evropës ishte në mes të skuadrave angleze, ku fituese doli Chelsea ndaj Arsenalit (4-1). Eden Hazardi shënoi dy gola, kurse nga një e shtuan Giroud dhe Pedro. Për Arsenalin shënoi Iwobi. Ndërsa në finale të Superkupës, Liverpooli triumfoi 7-6 pas penalltive ndaj Chelseat, derisa koha e rregullit kishte përfunduar 1-1. Liverpooli e fitoi edhe Botërorin e Klubeve, pasi e mposhti 1-0 në finale Flamengon.

Pensionimet, rikthimet dhe largimet e papritura në futboll

1 QERSHOR - Gjatë vitit u pensionuan shumë yje të futbollit botëror, por spikasin ajo e Arjen Robbenit, Peter Cechit dhe Andrea Barzaglit.



Ndryshe nga këta 41-vjeçar, Gianluigi Buffon u rikthye për ta vazhduar karrierën në Juventus. Në Itali, por te Milani, pritet edhe rikthimi i Zlatan Ibrahimoviçit. Largim i papritur ishte ai i Franck Riberys nga Bayern Munchen, por francezi vendos të mos pensionet e ta vazhdojë karrierën në Fiorentinë. Rikthim bëri edhe Mats Hummels nga Bayerni në Borussia Dortmund. Nga largimet e çuditshme ishte ajo e Daniele De Rossit, i cili pas një karriere të gjashtë u largua nga Roma dhe u transferua te Boca Juniorsi.

'Epoka e re' për herë të dytë kampione e Media Ligës

7 qershor - Gazeta "Epoka e re" e ka shkruar historinë në Media Ligë

pasi është bërë ekipi i parë që e fiton dy herë trofeun e më të mirit. "Epoka..." që nga fillimi e deri në fund të kësaj lige ishte ekip dominues dhe me plot meritë është shpallur kampione. Nga 30 ndeshjet e zhvilluara ky ekip arriti t'i regjistrojë 23 fitore, 4 barazime dhe 3 humbje. "Infokusi" dhe "Media Works"-i janë ekipet që kanë përfunduar kampionatin në pozitën dy dhe tre. Lojtari më i mirë i turneut është shpallur Erzen Zyberaj i "Epokës së re", kurse epititi i portierit më të mirë i ka takuar Arsim Popajt të "Lajmi.net". Pas triumfit në vitin 2010, "Epoka e re" e fitoi edhe në këtë edicion titullin e kampiones, duke grumbulluar 73 pikë.

Toronto shkruan historinë në NBA

14 qershor - Toronto Raptorsi ka hyrë në histori të NBA-së pasi ia ka dalë të fitojë për herë të parë në

Kulturës dhe Rinisë. Me këtë ligj iu hapet rrugë bizneseve që të investojnë në sport dhe 30 për qind e tatimit në fitim mund ta ndajnë për sportin.

Dallku pensionohet nga futbollit, bëhet trajner i Prishtinës

18 korrik - Kapiteni i Prishtinës dhe ish-mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Armend Dallku, pas një karriere të pasur futbollistike edhe në arenën ndërkombëtare, u pensionua nga futbollit aktiv. Ai u emërua trajner në grupmoshat e Prishtinës, kurse më vonë drejtuesit e klubit ia besuan edhe detyrën e trajnerit në skuadrën e parë. Sezonin vjeshtor e mbylli me sukses, me tri pikë diferencë me skuadrën e parë në tabelë, kurse me Prishtinën është kualifikuar në çerekfinale të Kupës.

Kosova, e 26-ta në 'Baku 2019' falë Muhamet Ramadani

28 KORRIK - Ekipi Olimpik i Kosovës ka përfunduar në vendin e 26-të nga 50 shtete pjesëmarrëse në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF), Baku 2019. Ky sukses ka ardhur pas medaljes së artë të atletit Muhamet Ramadani. Ai fitoi të artën në disiplinën hedhje e gjyles. Ekipi i Kosovës u përfaqësua në kryeqytetin e Azerbajxhanit me 18 sportistë të pesë sporteve të ndryshme, ndërsa fitoi një medalje.

Transferimet e vitit në Evropë

2 GUSHT - Gjatë vitit 2019 janë realizuar shumë transferime të mëdha në Evropë, por ndër kryesoret janë: Eden Hazard nga Chelsea te Real Madridi për 150 milionë euro, Antoine Griezmann nga Atletico Madridi te Barcelona për 120 milionë euro, Frenkie de Jong nga Ajaxi te Barcelona për 75 milionë euro, Harry Maguire nga Leicester City te Manchester Unitedi për 93 milionë euro, Nicolas Pepe nga Lille tek Arsenali për 72 milionë euro, Matthijs de Ligt nga Ajaxi te Juventusit për 75 milionë euro.

Kosova, e pasuksesshme në 'Eurobasket 2021'

17 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll i mbylli parakualifikimet e "Eurobasket 2021" me humbje pasi u mposhtë në Mançester nga Britania e Madhe (101-79). Derisa Britania siguroi kualifikimin tutje, "Dardanët" përfunduan me një fitore dhe tri humbje.

Kosova mori pjesë në Lojërat e dyta Mesdhetare

1 SHTATOR - Kosova mori pjesë në Lojërat e dyta Mesdhetare në Rërë, "Patra 2019". Flamurin e



Kosovës në parakalim e mbajti notari Arti Krasniqi. Krahas notarit Krasniqi, Kosova u përfaqësua edhe me dy ekipe në beach volley. Arti doli i katërti nga 16 pjesëmarrës në disiplinën 5 kilometra në ujëra të hapura. Ekipi i meshkujve në beach volley shënoi një fitore ndaj Andorrës, ndërsa u mposhtë nga Portugalia dhe Greqia, për të përfunduar në mesin e 12 ekipeve nga 16 sosh. Ekipi i femrave pësoi dy humbje nga medalistja e artë, Franca 1 dhe Sllovenia.

Kosova tregon 'dhëmbët', nuk lejon zhvillimin e ndeshjes ilegale 'Trepça'-Crvena Zveda'

9 TETOR - Klubi serb i futbollit "Crvena Zveda" dhe tifozët e tij nuk janë lejuar të futen në Kosovë për ta zhvilluar ndeshjen e Kupës së Serbisë ndaj skuadrës "Trepça" nga Mitrovica Veriore. Ekspedita e klubit serb është ndalur në pikën kufitare Jarinjë nga Polica e Kosovës, pasi Federata e Futbollit e Kosovës kishte kërkuar të mos lejohej zhvillimi i këtyre ndeshjeve ilegale në territorin Kosovës.

Gjymnastët prezantojnë Kosovën në Slloveni dhe Greqi

28 TETOR - Federata e Gjymnastikës së Kosovës është prezantuar në muajin tetor në turneun ndërkombëtar në Maribor të Sllovenisë me 13 gjymnastë. Gjymnastët që e përfaqësuan me sukses Kosovën ishin Bora Hoti, Vilëza Zeqiri, Valëza Rama, Altina Krasniqi, Regjina Shala, Elena Mangjollji, Diella Latifaj, Viera Gërguri, Elion Vitia, Elvis Çitaku, Ermal Hyseni, Dite Behluli dhe Alfredo Vincenzo, si dhe trajnerët Sherife Aliqaj-Qerimi, Shkumbin Maqastena dhe zyrtari Federatës, Bujar Zatriqi. Gjymnastet e Kosovës morën pjesë edhe në garën 'Horizon Cup' e cila është mbajtur në Selanik të Greqisë. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 19 shtete, kurse Kosova u prezantua me gjymnastet e KGJ "Elita", Vilëza Zeqiri, Valëza Rama e Lisa Zeqiri

dhe trajnerët e tyre Shkumbin Maqastena e Abelianë Bregu.

Hamiltoni fiton titullin e 6 në Formula 1

3 NËNTOR - Piloti britanik Lewis Hamilton ka qenë i shkëlqyeshëm në Botërorin e Formula 1, ku me plot sukses arriti ta fitojë titullin e gjashtë. Tash Hamiltoni është piloti i dytë me tituj më shumë, kurse ka vetëm një titull më pak se legjenda Michael Schumacher.

Xhakës i hiqet shiriti i kapitenit

5 NËNTOR - Mesfushorët shqiptarë Granit Xhaka i është hequr shiriti i kapitenit në ekipin e Arsenalit. Ky vendim i klubit anglez erdhi pasi Xhaka pati një përplasje me tifozët e Arsenalit pas zëvendësimit në ndeshjen me Crystal Palacen. Xhaka i kishte sharë tifozët që e fishkëllenin gjatë largimit nga fusha, kurse më vonë ai u kishte kërkuar falje, por kjo nuk ndikoi që ai të mbetet kapiten.

Shqipëria e pasuksesshme në kualifikueset për Evropian

17 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll, përveçse pati një kampanjë dështuese në Ligën e Kombeve, hiq më mirë nuk ka kaluar as në kualifikimet për "Euro 2020". Drejtuesit e Federatës Shqiptare e shkarkuan Christian Panuccin nga detyra dhe emëruan Edy Rejan, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të arritur sukses. Kuqezinjtë kampanjën kualifikuese e mbyllën në vendin e katërt me 13 pikë.

Bojku, fitues i turneut 'Adem Jashari'

17 NËNTOR - Repreruesi i Kosovës në boks, Shpëtim Bajoku, është shpallur fitues i turneut të 21-të ndërkombëtar "Adem Jashari". Në finale Bajoku e mposhti boksierin nga Bosnje e Hercegovina, Ivan Blazević.



Kosova e treta në eliminatorë, por kualifikimin mund ta arrijë nga Liga e Kombeve

18 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pasur paraqitje të mira dhe rezultate pozitive në kualifikueset për Kampionatin Evropian "Euro 2020", por nuk ka arritur ta sigurojë kualifikimin. "Dardanët" i mbyllën kualifikueset për "Euro 2020" në vendin e tretë në grup, me 11 pikë të tubuara, shtatë më pak se Anglia dhe katër më pak se Çekia. Megjithatë, Kosova ka edhe një mundësi për kualifikim përmes Ligës së Kombeve. Më 26 mars luan ndeshjen gjysmëfinale me Maqedoninë e Veriut në udhëtim, ndërsa fitorja e dërgon në finale me Gjeorgjinë ose Bjellorusinë.

KOK-u bëhet anëtar i FICTS

18 nëntor - Komiteti Olimpik i Kosovës është bërë anëtar i 121-të i Federatës Ndërkombëtare për Kinemanë Televizive Sportive (FICTS). Njohja e KOK-ut në FICTS ia hap dyert edhe Kosovës, e cila që nga viti i ardhshëm do ta organizojë Festivalin e Filmit Sportiv në Kosovë, ndërsa filmat më të mirë të zhanreve të ndryshme të zgjedhur në Festivalin e Kosovës nga Juria profesionale do të marrin pjesë në Kampionatin Ndërkombëtar të FICTS, që do të mbahet për herë të 38 në Milano të Italisë, në nëntorin e vitit 2020.

Themelohet Federata e Lojërave dhe Sporteve Tradicionale të Kosovës

27 NËNTOR - Me nismën e Komitetit Olimpik të Kosovës është themeluar Federata e Lojërave dhe Sporteve Tradicionale të Kosovës (FLSTK). Unanimisht kryetar u zgjodh profesor Fadil Hysaj. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Fejsal Shaqiri, Drilon Beqiri, Nezir Shehu, Kaltrina Hasani, Sadik Krasniqi dhe Masar Kabashi. Ndërsa sekretar i përgjithshëm u zgjodh Nazmi Ibrëdemaj.

Ahmeti ia mësyn postin të kryetarit në FFK, KE e shkarkon

1 DHJETOR - Pavarësisht sukseseve të mëdha nga Përfaqësuesja e Kosovës dhe shumë punëve të mira në Federatën e Futbollit të Kosovës, Agim Ademi nuk është lënë rehat në karrigen e kryetarit të FFK-së. Zëvendëssekretari Arianit Ahmeti ia ka mësyre postin të kryetarit ku ka paralajmëruar zgjedhje më 15 janar të vitit 2020, por drejtuesit e federatës kanë paralajmëruar se nuk do të ketë zgjedhje deri më 2022 pasi, sipas tyre, Ademi është zgjedhur për një mandat katërvjeçar. Komiteti Ekzekutiv i FFK-së e ka shkarkuar Ahmetin nga posti i zëvendëssekretarit.

Messi për herë të gjashtë fiton 'Topin e Artë'

2 DHJETOR - Ylli i Barcelonës, Leo Messi, është shpallur për herë të gjashtë futbollisti më i mirë në botë. Në garë për "Topin e Artë", ylli argjentinas e mposhti anëtarin e Liverpoolit, Virgil van Dijk dhe yllin e Juventusit, Cristiano Ronaldo. Messi këtë çmim e fitoi pas një sezoni të mirë me Barcelonën, ku në 50 ndeshje në të gjitha garat në edicionin 2018/19, shënoi 51 gola dhe dhuroi 22 asistime.

Joshua i hakmerret Ruizit

7 DHJETOR - Boksieri Anthony Joshua ka arritur ta mposhtë Andy Ruizin në kategorinë e peshave të rënda në boks. Britaniku, përveç që i është hakmarrë Ruizit, i ka rikthyer edhe titujt e botës në WBA, WBO, IBF dhe IBO. Joshua ishte

mposhtur në qershor, derisa tash arriti fitore pas 12 raundeve me pikë.

Boksi rrëmben pesë medalje në Kampionatin Ballkanik, Donjeta e artë

15 dhjetor - Në vitin 2019 edhe boksi pati sukseset e veta, por më i madhi ishte Kampionati Ballkanik "Antalia 2019", ku Përfaqësuesja e Kosovës fitoi pesë medalje. Donjeta Sadiku e fitoi të artën, pasi në finale e mposhti turken Sema Caliskan (-64 kg). Shpejtim Bajoku (-63 kg) dhe Besart Pireva (-75 kg) u stolisën me medalje të argjendta, kurse të bronzitën e fituan Patriot Behrami (-69 kg) dhe Bashkim Bajoku (-52 kg).

Futbollistët shqiptarë që shkëlqyen dhe zhgënjyen

21 DHJETOR - Shumë futbollistë shqiptarë kanë shkëlqyer gjatë vitit 2019. Pa dyshim që në krye është Vedat Muriqi që arriti të transferohet te Fenerbahçe pas një edicioni të shkëlqyeshëm me Rizesporin. Muriqi shkëlqejë edhe me fanellën e Kosovës, kurse krahas tij shkëlqim të madh pati edhe Milot Rashica, i cili është rikthyer në lojtarin kryesor të Werder Bremenit, por edhe ndër më të mirët të Kosova. Hap të madh në karrierë bëri edhe kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, i cili është transferuar nga Dinamo Zagrebi në Hellas Verona. Të shkëlqyeshëm ishin edhe lojtarët si Bersant Celina, Fidan Aliti, Benjamin Kolloli, Herolind Shala, por pa harruar edhe lojtarët që luajnë për Kombëtaren e Shqipërisë si Etrit Berisha, Thomas Strakosha, Berat Gjimeshi e shumë të tjerë. Ndërsa nga dështimet më të mëdha ishte Eros Grezda, i cili ka stagnuar shumë si në kombëtaren kuqezi, po ashtu edhe në skuadrën e Rangersit.

Sporti i Kosovës në pikëllim, shumë sportistë ndërruan jetë

23 DHJETOR - Në vitin 2019 Kosova humbi shumë sportistë që gjithë jetën e tyre ia kushtuan sportit. Në moshën 63-vjeçare u nda nga jeta ish-trajneri dhe ish-portieri i mirënjohur Skënder Sahiti. Kosova mbeti edhe pa doajenin e ndarjes së drejtësisë, gjyqtarin e parë nga Kosova me stemë të FIFA-s, Shinasi Berisha, i cili u nda nga jeta në moshën 73-vjeçare. Po ashtu, jetë ndërruan edhe anëtarin e Bordit Ekzekutiv të Federatës së Karatesë së Kosovës dhe trajneri i Klubit të Karatesë "Elita" nga Gjilani, Xhevat Shabani, presidenti i Federatës së Badmintonit të Kosovës, Jeton Nebiu si dhe gazetari sportiv Mustafë Lecaj. Në amshim shkoi edhe Artan Venhari, kryetar i Federatës Aeronautike të Kosovës si dhe futbollistja shqiptare Florijana Ismaili. Edhe ikona e hendbollit gjilanas, Agim Shahini.



WANDA NARA: DUA TË JEM SEKSI, SEPSE VUAJ DIFERENCËN NË MOSHË ME ICARDIN

Gruaja e sulmuesit Mauro Icardi, Wanda Nara, shpeshherë pozon në mënyrë provokuese. Ajo ka treguar edhe arsyen pse e bën një gjë të tillë. "E vërteta është se unë e vuaj diferencën në moshë me Mauro, jam shtatë vjet më e madhe se ai. Dua të jem seksi, madje edhe në rrjetet sociale prej tij. Unë fshihem pas një personazhi. Nëse bëheni e njohur dhe e kuptoni dobësinë tuaj, atëherë kundërshtarët e dinë se ku mund t'ju godasin", ka thënë Wanda Nara.



Fiton Lazio, feston Anna

Fiton Lazio, feston Anna Falchi. U kishte premtuar tifozëve bardhekaltër se nëse ekipi i drejtuar nga Inzaghi do të fitonte Superkupën, do të realizonte një foto të nxehtë. Dhe kështu ndodhi. Aktorja dhe ish-modeluesja e famshme italiane komentoi në

"Instagram": "Nuk e di se si... por po fillon të më pëlqejë e bardha dhe e zeza. Faleminderit Lazio për këtë dhuratë të bukur. Tani heroi ynë i 26 majit nuk do të jetë më Luliq71, por Luliq73, heroi i 22 dhjetorit (numri im me fat), Faleminderit dhe gjithmonë forca Lazio!"



Ish-bosi i Renaultit 'peshkon' bukuroshen e re

Flavio Briatore vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes dhe mediave që merren me gossip, pra faqet rozë, teksa pas Elisabetta Gregoracci

dhe Heidi Klum ka peshkuar një bionde bukuroshe dhe tepër të re, vetëm 20 vjeçe, e cila studion në Milano. Ish-bosi i Formulës 1, që është

69 vjeç, ka 49 vjet dallim me vajzën në fjalë, e cila ka një profil të mbyllur në "Instagram" dhe 30 mijë ndjekës.

Mbappe, lidhje sekrete me 'Miss Franca 2017'



Nuk ka foto ku shfaqen përkrah njëri-tjetrit, mungojnë, por në Francë janë të sigurt që sulmuesi kampion bote Kylian Mbappe dhe modeluesja Alicia Aylies, "Miss Franca 2017", kanë një lidhje dashurie. Bukuroshja franceze është pikasur shpesh në stadione duke ndjekur yllin e PSG-së, me të cilin frekuentohet prej muajsh pa u rënë në sy mediave rozë. Duket se Mbappe ka shënuar një tjetër "gol" spektakolar, këtë herë në jetën e tij private.

Zhvishet gruaja e Crouchit, ndjekësit mbeten pa fjalë

Peter Crouch dhe Abbey Clancy kanë një familje të mrekullueshme (dhe katër fëmijë). Abbey, që ka profesionin e modelueses, vazhdon të mahnitë në rrjetet sociale. Shkrepjet e fundit, në të cilat shfaqet e zhveshur, kanë lënë pa fjalë ndjekësit e saj. Shumë pëlqime dhe komente që kanë shprehur të njëjtin mendim: "Fantastike!"



NADALI I JEP FUND BEQARISË, I THOTË 'PO' MARIA PERELLO PAS 14 VJETËSH FEJESË

Tenisti spanjoll Rafael Nadal, që nga data 4 nëntor do të jetë numri 1 në botë për meshkuj, i dha zyrtarisht fund beqarisë. Pas 14 vjetësh njohje e fejesë me të dashurën e tij Maria Francisca Perello, ai ka vendosur unazën në gisht. Dasma u zhvillua në një kështjellë në Majorka, larg syve të mediave dhe të ftuarve "të padëshiruar". Rreth 350 të

ftuar në këtë ceremoni, asnjë foto "e vjedhur", pasi për të shkuar në këtë kështjellë transporti ishte vetëm përmes detit. Pra, gjithçka e kontrolluar. Ndaj ka qenë vetë tenisti ai që ka postuar dy foto nga dasma, ku ai është në krahët e bashkeshortës. Çifti është njohur që kur ishin adoleshentë, por tani vendosën të shkojnë në altar.



Legjenda e Babadimrit:

Si lindi historia e gjyshit që ndan dhurata

Regjistrimet e para të këtij shenjtori, peshkopi dhe mirëbërësi me origjinë nga Azia e Vogël, datojnë nga shekulli 4 pas Krishtit.

Karakteri i një gjyshi zemërgjerë, i cili u jep dhurata fëmijëve është e pranishme në tregimet dhe legjendat e kombeve në mbarë botën.

Emri dhe pamja e këtij gjyshi ndryshojnë nga kultura në kulturë, por besohet se nocioni i Babadimrit të sotëm është për shkak të besimeve para-kristhere të popujve gjermanë dhe sllovenë, të cilët, me pagëzimin e këtyre popujve, kombinohen me figurën e Shën Nikollës së Krishterë.

Por le të fillojmë nga fillimi. Kush sjell dhurata Santa Claus, Saint Nicholas, Christmas apo? Mund të thuhet se Shën Nikolla është një paraardhës i largët i Santa Claus-it të sotëm.

Regjistrimet e para të këtij shenjtori, peshkopi dhe mirëbërësi me origjinë nga Azia e Vogël, datojnë nga shekulli i 4 pas Krishtit.

Historia shkon se në jetë ai ishte një përfitues i shkëlqyeshëm që shpërndau tërë pasurinë dhe pronat e tij të të varfrit, dhe ai, i udhëhequr nga një zë i mrekullueshëm,



vendosi të përhapë besimin, drejtësinë dhe mëshirën te njerëzit.

Me pamjen e tij, ai solli ngushëllim, paqe dhe dashamirësi mes njerëzve. Ishte veçanërisht i dashur për fëmijët.

Në traditën gjermane ka qenë aq e zakonshme me shekuj që

prindërit të lënë karamelle për fëmijët e tyre për Ditën e Shën Nikollës, duke u thënë atyre se është një dhuratë nga ky shenjtor. Ky zakon u zhvendos gradualisht në Krishtlindje, në një kohë kur ndizet bredhi.

Në shekullin e 16-të, reformimi i Martin Luterit ndryshoi jo vetëm fenë e krishterë, por edhe

karakterin e krijesit të dhuratave. Përkatesisht, për shkak se protestantët nuk i festonin shenjtorët, ata kishin nevojë për një traditë të re të Krishtlindjes, dhe personazhi i Shën Nikollës u zëvendësua gradualisht me "At Krishtlindje", e cila u bë pjesë e folklorit britanik gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë.

Duke banuar rajonin e Amerikës së Veriut, emigrantët perëndimorë sollën me vete bindjet dhe zakonet e tyre përtej oqeanit në "botën e re". Sant Niklaus, Saint Niklaus, Sinterklass dhe variacione të tjera të emrit të Shën Nikollës u bashkuan përfundimisht, dhe u krijua Santa Claus emri i të cilit u përdor për herë të parë nga shtypi amerikan në vitin 1773.

Gjatë kësaj periudhe Shën Nikolla ngadalë "u shndërrua" në Santa Claus që njohim sot, megjithëse disa nga rekuizitat e pashmangshme - një kostum i kuq, një mantel me lesh, karroca, drerët, u shtuan më vonë.

Një nga artistët e parë që përcaktoi pamjen moderne të Santa Claus ishte Thomas Nast, një karikaturist amerikan i shekullit të 19-të, fotografia e të cilit nga Santa Claus në 1863 u shfaq në të përjavshmen Harpers Weekly.

Historia që Santa Claus jeton në Polin e Veriut është gjithashtu vepër e Nast, dhe në atë kohë, "gjyshit më të dashur në botë" iu dha një mantel me lesh. Sot, ngjyra tradicionale e kuqe e kostumit të tij, zëvendësoi ngjyrën origjinale të verdhë-jeshile në vitin 1868 kur u shtuan të dy karrocet dhe drerët.



VIP-at që fitojnë më shumë nga një postim reklame në 'Instagram'

Lista e personazheve më të ndjekur në "Instagram" tregon edhe se cilët fitojnë më shumë për çdo postim që mund të bëjnë në formë reklame në llogarinë e tyre. Lista është krijuar nga HopperHQ, një program që mat të dhënat e brendshme të "Instagram"-it si dhe të dhënat publike, për të kuptuar se cilët të famshëm fitojnë më shumë.



1. Lionel Messi 126 milionë ndjekës, 648.000 dollarë për postim



2. Ronaldo de Assis Moreira 47 milionë ndjekës, 256.000 dollarë për postim




3. Priyanka Chopra Jonas 43 milionë ndjekës, 271.000 dollarë për postim



4. LeBron James 50 milionë ndjekës, 272.000 dollarë për postim



5. David Beckham 57 milionë ndjekës, 357.000 dollarë për postim




6. Demi Lovato 73 milionë ndjekës, 458.000 dollarë për postim



7. Kevin Hart 77 milionë ndjekës, 480.000 dollarë për postim




8. Khloe Kardashian 96 milionë ndjekës, 598.000 dollarë për postim



9. Kendall Jenner 114 milionë ndjekës, 611.000 dollarë për postim



10. Nicki Minaj 104 milionë ndjekës, 651.000 dollarë për postim



11. Justin Bieber 115 milionë ndjekës, 722.000 dollarë për postim



12. Neymar 123 milionë ndjekës, 722.000 dollarë për postim



13. Taylor Swift 119 milionë ndjekës, 748.000 dollarë për postim



14. Beyonce Knowles 130 milionë ndjekës, 785.000 dollarë për postim



15. Dwayne Johnson 150 milionë ndjekës, 882.000 dollarë për postim



16. Selena Gomez 153 milionë ndjekës, 886.000 dollarë për postim



17. Kim Kardashian West 144 milionë ndjekës, 910.000 dollarë për postim



18. Cristiano Ronaldo 176 milionë ndjekës, 975.000 dollarë për postim



19. Ariana Grande, 160 milionë ndjekës, 996.000 dollarë për postim



20. Kylie Jenner 141 milionë ndjekës - 1.2 milion për postim



KOMPANIA UJËSJELLESI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D. D.
PRISHTINA

URIME VITI I RI 2020!



7 filma që ia vlejnë t'i shihni gjatë festave

Nëse doni të argëtoheni, të kaloni pak kohë me familjen, por pa u zhytur në botën e filmave tërësisht festivë, CNN Entertainment ka listuar 7 filma që ia vlen të shihen gjatë këtyre ditëve.



"CATS" - Vlerësimet deri tani kanë qenë pozitive. Me Taylor Swift, Jennifer Hudson, Judi Dench, Jason Derulo dhe Idris Elba, ky film "musical" me siguri që do t'ju argëtojë.



"LITTLE WOMEN" - Versioni i fundit i përshtatjes në film i librit të Louisa May Alcott, "Gra të vogla", ku tregohet historia e katër motrave që rriten në Amerikën e pas Luftës Civile.



"SPIES IN DISGUISE" - Një film i animuar ku protagonistë me zërat e tyre janë Tom Holland dhe Will Smith.



"JUST MERCY" - Michael B. Jordan dhe Jamie Foxx janë protagonistë në një dramë që tregon historinë e vërtetë të Walter McMillian, një burri nga Alabama të dënuar gabimisht për vrasje.



"STAR WARS: The Rise of Skywalker" - Seria e radhës e një klasiku të fantashkencës.



"1917" - I emëruar për "Golden Globe", një film që flet për Luftën I Botërore, ku dy ushtarë britanikë nisen me një mision për të shpëtuar qindra të tjerë nga vdekja.



"DY PAPËT" - Anthony Hopkins dhe Jonathan Pryce tregojnë një moment historik të Kishës Katolike, miqësinë mes Papës Benedikti XVI dhe atij që do të bëhej Papa Françesku.

Në frymën e solidaritetit dhe humanizmit,
këtë vit kemi zgjedhur që dëshirat tona
ti adresojmë në një dhuratë, duke përkrahur
lehtësimin e pasojave nga tërmeti i fundit
në Shqipëri

Gëzuar Festat me dëshirat më të mira
për vitin 2020!

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.





Në këtë festë tradicionale, në natën e ndërrimit të viteve, kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë, që në emër të Komunës së Drenasit t' u dëshiroj të gjithë qytetarëve të Kosovës urimet më të përzemërta.

Ramiz Lladrovci, kryetar

Gëzuar Vitin e Ri!
HAPPY NEW YEAR
2020!

Si festohet Viti i Ri tradicional në botë dhe si e festojnë shqiptarët



Viti i Ri është festa më supersticioze që ekziston, lihet pas kraheve viti i vjetër, dhe shihet me pozitivitet drejt të ardhmes, duke shpresuar për më të mirën. Kjo ndjenjë përkthehet në veprime që kërkojnë tërheqjen e një fati të mirë. Por, si kalohet kjo festë në vende të ndryshme të botës dhe si e festojnë shqiptarët.

Belgjikë

Pastrimi i trupit pas festimeve të Krishtlindjeve për t'u përgatitur për vitin e ri. Karakteristikë në Belgjikë është supa e qepës, e cila mbyll darkën e vitit të ri. Dhe për një fat të mirë vihet poshtë pjatës një monedhë apo një gjethe lakre.

Brazil

Të rinjtë vishen me të verdhë, në homazh të diellit, jetës dhe arit, simbol i bollëkut. Kryefamiljari hedh pas shpatullave një gotë verë për të larguar fatin e keq, ndërsa të rinjtë nuk heqin dorë nga notimi i mesnatës.

Kinë

Në Kinë viti i ri nuk festohet më 31 dhjetor, si në kalendarin

grigorian, por në një ditë që ndjek kalendarin hënor, dhe që varion nga 21 janari deri në 19 shkurt. Sipas traditës gjatë festimeve vishesh me të kuqe, dhe kjo do të trembte Nian, monstrën mitologjike që në legjendë dilte nga vrima e saj çdo 12 muaj për të ngrënë njerëz, që përfaqësohen nga maskat e luanëve për të sfiluar në qytet.

Gjermani

Gjatë Vitit të ri gjermanët përdorin maska, pinë verë të kuqe dhe hanë shumë lajthi, arra etj. Ata më tradicionalët pinë Feuerzangenbowle, pija e vëllezërës me bazë verë, kanellë dhe rum. Në fund të mbrëmjes lihet mbi tavolinë një pjatë plot me ushqim, për të pasur një vit të ri me prosperitet dhe bollëk.

Japoni

Viti i ri është periudha që shfrytëzohet për të bërë punët e shtëpisë që zgjasin tre ditë, deri më 3 janar. Në këto ditë festohet duke falënderuar zotat për të ardhurat dhe për të mirëpritur shpirtat e të parëve shtëpia dekorohet me rrënjë pisha, bambu dhe kashtë. Për ndërrim-

in e viteve kambanat e tempujve budiste bien për 108 herë, për të rrëfyer mëkatet e të gjithë njerëzve.

Rusi

Në Rusi viti i ri festohet dy herë, më 31 dhjetor sipas kalendarit gregorian dhe më 13 janar sipas atij julian, dhe që quhet dhe si Viti i ri, i vjetër. Më 31 dhjetor pritet mesnata për të kërcyer e për të ngrënë ëmbëlsirën tipike, të mbushur me arra dhe salcë kosi. Në goditjen e 12-të të kambanës hapen dyert për të pritur me gëzim vitin e ri.

Tajlandë

Viti i Ri tajlandez festohet mes 13-15 prillit, që përkon me vitin e ri budist. Është një nga festat më të pritura të vitit dhe më e ndjekura nga turistët. Tradita e do që të bëhen larjet e tempullit dhe fotove të Budës me ujë dhe duke pastruar me themel shtëpitë. Kjo përkthehet në një luftë uji që hidhet ndaj kalimtarëve, që sipas traditës largon fatin e keq. Për ta bërë këtë përdoret çdo gjë, që nga kallamishtet e madje deri tek elefantët.

VITI I RI, TETË TRADITAT E VEÇANTA QË I BËJNË SHQIPTARËT TË DALLOJNË NGA TË TJERËT

Nata e ndërrimit të viteve festohet në gjithë planetin dhe është një festë që bën bashkë anëtarët e familjes dhe njerëzit më të dashur. Njerëzit, në anë të ndryshme të botës festojnë këtë natë me mënyra të ndryshme, por të gjithë besojnë se dëshirat e tyre do të realizohen në vitin që pason. Ndryshe nga vendet e tjera të botës, apo edhe mes fqinjëve, nata e vitit të ri tek Shqiptarët festohet ndryshe. Ka disa tradita të cilat na dallojnë nga të tjerët dhe ku merr kuptim fjala 'shqiptarët'.

Tryeza plot me ushqime, veçanërisht mish Edhe pse çdo ditë nuk konsumojmë shumë ushqime, natën e vitit të ri, tryeza duhet të jetë e mbushur plot e përplot. Nuk mjafton nëse gjeli i detit ndodhet mbi tryezë, pasi kryefamiljari ka blerë edhe dy-tre lloje të tjera mishi që në fund të fundit, askush nuk i prek.

Bakllava

Ëmbëlsira me e preferuar e tryezës përgatitet shumë ditë para festës. Disa zonja ende preferojnë ta gatujnë vetë, disa të tjera ua besojnë furrave.

Pijet

Në tryezë nuk mungon asnjë marke alkooli, pije me gaz, pa gaz apo energjike. Nuk ka rëndësi nëse do të pihen apo jo, e rëndësishme të jene aty.

Superpastrimi i shtëpisë

Çdo cep shtëpie, dhomat, çdo orendi duhet pastruar. Viti i ri duhet të gjejë çdo shtëpi të pastër. Është e pastër dhe s'ka nevojë? Do të ripastrohet sërish. Nuk ka dyshime për këtë!

Luftë fishekzjarrësh

Nga dritaret, ballkonet e kudo të munden, shqiptarët do tregojnë me padurim arsenalin e pafundmë të fishekzjarrëve në shtëpi. Ishin më të bukura ato të fqinjëve? S'ka problem, në 1 janar rihedhim sërish.

Leku në byrek

Një tjetër traditë, byreku me lekun e fshehur. Kureshtja vijon. Kujt do ti bjeri këtë vit? Me shtrenjtësimin e jetesës dilema bëhet me e madhe. Çfarë shume do të marrim në këmbim të lekut? Momente sa argëtuese e qesharake që i shtojnë gëzim tryezës familjare.

Festa

Tani më, dihet nga të gjithë. Deri para mesnate me familjen, pas mesnate me shoqërinë. Mëngjesi? Nuk dihet ku na gjen.

Kush do të hyjë i pari në shtëpi?

Thonë që kur të hyn një djalë i vogël në shtëpi, viti do të shkojë mbarë. Akoma më shumë, shqetësimi më i rëndësishëm; të hyj me këmbën e djathtë. Një traditë që vështirë të zbehet.





KOMUNA E JUNIKUT



GËZUAR 2020!

Ju uroj më të mirat për Vitin e Ri 2020! Qoftë vit i mbarë dhe sjelltë suksese, paqe, dashuri e harmoni në familjen Tuaj, në vendin tonë e kudo në botë!

Uroj të kemi vullnet dhe të jemi të palëkundur në qëllimin tonë të përbashkët për ta fuqizuar Kosovën!

Gëzuar!

*Agron Kuçi,
Kryetar*



6 tradita për të sjellë fatin e mirë për Vitin e Ri

Festat janë koha ideale për të reflektuar. Çfarë kemi bërë mirë dhe çfarë mund të përpiqemi të bëjmë më mirë? Për ta ndihmuar veten për t'i arritur qëllimet tuaja ju rekomandojmë t'i lexoni traditat që shumë kultura të ndryshme i ndjekin.



MBAJINI PARATË POSHTË TAPETIT

Nëse dëshironi të keni më shumë para vitin që vjen, ndiqni të njëjtën taktikë që populli rumun ndjek. Ata besojnë se nëse i vendosni paratë poshtë tapetit kur ora shkon 12 Viti i Ri do t'ju sjellë më shumë të ardhura financiare. Për të pasur akoma më shumë fat ju këshillojmë të vishni të brendshme të kuqe ose të thyeni gotat natën e Vitit të Ri.



NDIZNI FURRËN DHE MUZIKËN

Në shumicën e rasteve paratë vijnë kur fitohen me djersë. Prandaj nëse dëshironi që Viti i Ri të jetë i mbarë shumë njerëz në Trinidad dhe Tobago besojnë se çelësi është që të keni një shtëpi të pastër dhe të mblidhni familjarët tuaj duke gatuar gjëra të shijshme për ata. Ëndrrat do t'ju bëhen realitet nëse gatvani fasule të zeza për ditën e Vitit të Ri.



HANI MIRË

Populli afgan rekomandon se nëse kombinoni natën e Vitit të Ri frutat e thata si bajamet, lajthitë, arrat, qershitë, kajsitë dhe rrushin e thatë fati i mirë do ju ndjekë gjatë gjithë vitit tjetër.



HANI DISA KOKRRA RRUSH DHE BËNI GATI VALIXHEN

Frutat janë protagonistët kryesor në traditat e Amerikës Latine: Në Venezuelë ose Bolivi, njerëzit për të pasur sa më shumë fat hanë saktësisht 12 kokrra rrushi në mesnatë. Për ata që 2020-ta do t'i gjejë duke udhëtuar botën ja një truk fatsjellës që mund të bëni: Merrni valixhen dhe bëni disa xhiro me të rreth shtëpisë, kjo do ju rrisë mundësitë që të shikoni vende të reja gjatë Vitit të Ri.



THONI LAMTUMIRË FATIT TË KEQ

Në Brazil njerëzit vishen me të bardha sepse besojnë se Viti i Ri në këtë mënyrë do t'ju sjellë paqe dhe qetësi mendore. Ata rekomandojnë se Viti i Ri duhet t'ju gjejë në ujë dhe sapo t'ju afrohen dallgët duhet të hidheni sa më lartë të mundeni.

MBUSHENI SHTËPINË TUAJ ME PARA DHE FRUTA TË RRUMBULLAKËTA.

Ndërsa në Filipine nuk është e nevojshme t'i drejtoheni detit në vend të saj ata veshin rroba me pika dhe hidhen aq sa kanë mundësi në mesnatë. Për t'ju sjell akoma më shumë fat ata rekomandojnë të hidhni disa monedha nëpër dhomat e shtëpisë kur ora shënon 12. Gjithashtu mbajini dritat ndezura gjatë natës dhe mbusheni tavolinën e Vitit të Ri me fruta të rrumbullakëta të madhësive të ndryshme.



Thëniet më të bukura për lumturinë

“Njeriu i pasur në vetvete është si ajo dhoma e ndritshme, e ngrohtë dhe e qetë në një natë dimri në furtunë”



- Njeriu është i palumtur sepse nuk di të jetë i lumtur; kur ka për ta ditur, do të jetë i lumtur në po atë çast.
- Kemi plot detyra në jetë që i nënvlerësojmë. Por nuk ka detyrë më të nënvlerësuar sesa detyra për të qenë i lumtur.
- Lumturia më e madhe nuk qëndron në mosrënien kurrë, por në ringritjen gjithnjë pas çdo rënie.
- Njeriu i pasur në vetvete është si ajo dhoma e ndritshme, e ngrohtë dhe e qetë në një natë dimri në furtunë.
- Pyesni veten nëse jeni të lumtur dhe do të pushoni së qenuri i tillë.
- Lumturia që fitojmë nga vetja është më e madhe sesa ajo që fitojmë nga rrethi ynë.
- Të jesh i lumtur do të thotë të jesh i mjaftueshëm në vetvete.
- Lumturia e njeriut përbëhet prej përdorimit të lirë të fuqive të tij mendore.
- Njeriu që ka lindur me një talent gjen lumturinë më të madhe atëherë kur ai mundet ta vërë atë në përdorim.
- Lumturi do të thotë të kryesh punë që kanë për të qenë të qëndrueshme; plot shpirt dhe të mbara, cilitdo qofshin ato.
- Është një gabim trashanik që njeriu të bëjë fli atë që ka në vetvete për të jashtmen, të japë lirinë qoftë dhe pjesërisht, të japë qetësinë për komoditet, gradë, famë dhe nder.
- Të tregohemi të kujdesshëm, të mos ecim symbyllur e të merremi me punë që nuk i përshtaten vetive tona, sepse sakrifikojmë lumturinë.
- Shumica e njerëzve punojnë si miza dheu nga mëngjesi deri në darkë për të shtuar florinjte dhe askujt s'i bie ndër mend të shtojë kulturën, pra të pasurojë gjendjen intelektuale, megjithëse kjo e fundit i shërben shumë lumturisë.
- Lumturia në pjesën më të madhe të saj përbëhet prej qetësisë dhe mendimit të lirë e vetëvëprues.
- Në botë vërtetohet përditë se lumturia luftohet prej dy armiqve: dhembjes dhe mërzi; dhe ne zakonisht sa herë i shpëtojmë njërës i afrohemi tjetrës.
- Sa më e madhe të jetë pasuria e brendshme, aq më pak mbetet vend për mërzinë, aq më pak njeriu do të ketë nevojë për njerëz të tjerë, sepse, aq më pak të tjerët mund t'i shërbejnë atij.
- Njeriu i rëndomtë e mbështet lumturinë e vet në sendet të jashtme si pasuria, grada, shoqëria, dhe kur i humb këto, bie në dëshpërim dhe i shkatërrohet jeta.
- Mësova se të gjithë duan të jetojnë në majën e malit, pa e ditur se lumturia e vërtetë qëndron te mënyra se si zbrat në një log të fshehur nga maja të thepisura.
- Një njeri që e ka pranverën në shpirt e vet, di ta gjejë pranverën në çdo stinë.
- Në kohën e pleqërisë, kur dashuria na lë, gjithashtu na lënë edhe kënaqësitë shoqërore, udhëtimet, kur shokët e farefisin i rrëmben vdekja; në këtë kohë më shumë se kurrë njeriu gjen mburojën e vetvetes.
- Lumturia është fitorja më e madhe e njeriut; ajo është përgjigja e genies së tij në një drejtim frytdhënës për vetveten dhe për botën rreth tij.
- Një njeri, interesi i të cilit gjithmonë drejtohet në anën e jashtme, mendon se lumturia gjendet jashtë tij, përderisa ai nuk vështron brenda vetes dhe ta zbulojë buriin në vetvete.
- Suksesi është të arrish atë që do. Lumturia është të duash atë që ke. Ndaj lumturia është shëndet i mirë dhe kujtesë e keqe.
- E vetmja gjë që ia vlen të kesh në jetën mbi tokë është ndjenja e humorizmit.
- Ai që ka guximin për të qeshur është zot i botës pothuajse po aq sa ai që është i gatshëm për të vdekur.
- Ndryshimi është ligji i jetës. Ata që shohin vetëm të kaluarën ose të tashmen, janë të prirur të humbasin të ardhmen.
- Kur mbyllet njëra derë, hapet një tjetër. Por ne shpesh dhe me keqardhje shikojmë aq gjatë kah dera e mbyllur, sa që nuk vërejmë atë që është hapur.
- Të gjitha gjërat e mëdha janë të thjeshta dhe shumë prej tyre mund të shprehen edhe me një fjalë të vetme: Liri, Drejtësi, Nder, Detyrë, Mëshirë, Shpresë...
- Të kërkoesh lumturinë në këtë jetë: ja shpirti i vërtetë i kryengritjes.



BABADIMRI NËPËR KOHË TË VËSHTIRA



Sadik Rr. KRASNIQI

Pushtuesi serb në vazhdimësi ka hulumtuar forma nga më të ndryshme veprimesh kundër popullit shqiptar. Në vitet e 90-ta pas suprimimit të autonomisë së Kosovës atëherë në kuadër të ish Jugosllavisë, Regjimi serb vazhdon duke shtuar format më të egra të dhunës mbi shqiptarët në Kosovë. Ndër të tjera ndanënxënësit shqiptar nëpër shkolla nga ata serb, nëndërrime të ndryshme, me qëllim të

helmimit të nxënësve shqiptar më vonë. Larguan nga puna, nga të gjitha profilet të gjithë punëtorët shqiptar që nuk ishin luajal të regjimit komunist serb. Larguan Polic, minator, gazetar, mjek, mësime etj. Vepruan me të gjitha format më të këqija, për të nxirë rekrutime të popullit shqiptar, për të krijuar rekrutime, e pastaj aksionet më të egra luftënxënëse ndaj popullit shqiptar duarthatë. Qëllimi

ishite zbrazja e Kosovës, ç'farosja e shqiptarëve, pastrimi etnik, sikur në vazhdimësi edhe në të kaluarën.

Babadimri mbeti pa dhurata, sepse populli mbeti pa punë pa burime. Si të ju shpjegohej fëmijëve se kësaj radhe nuk ka babadimër. Në dhjetor të vitit 1991 mësime nxënësit kërkonin nga fëmijët që të shkruajnë ndonjë poezi për babadimrin. Çka të shkruhej, çka të ju thuhej,

ishite prekëse. Nuk kishte dhurata Babadimri, nuk kishte gëzim për fëmijët shqiptar, nuk e kishin mundësinë prindërit pa punë, që t'i gëzonin fëmijët e vet me ndonjëdhuratë e të ju thonë: "Këto dhurata i keni nga Babadimri". Nga njëkrijesë e imagjinuar nga bota humane për të i bërë fëmijët e lumtur. Atëherë nga ky motiv, i shkrova këto vargje, të cilat për herë të parë po i botoj sot.

Kohë të vështira

BABADIMRI

(Dhjetor 1991)

Fëmijët:

Babadimër zemërbardhë
Sot mirë se na ke ardhë.
Si duket mirë nuk jeni,
Po dhuratat, ku i keni?

Babadimri:

Duke ardhë unë rrugës time,
më doli para një shtrigë e nxime,
shtrigë e nxime hije terri,
nuk pata fat, më zuri sherri.

Fëmijët:

Babadimër mos u mërzit
se ne shtrigës do t'i dalim n'pritë,
do të vijë një ditë e bardhë e
do ta ndjekim kah ka ardhë.

Babadimri:

Po e shihni nuk kam dhurata
kësaj radhe as fjalë të gjata.

E pata veç një amanet
mirëpo ju, po e ditkit vet!

Babadimri dhe Fëmijët:

Do të vijë një ditë e bardhë e
do ta ndjekim, kah ka ardhë.



Dhe vërtet fëmijët fjalën që ia dhanë Babadimrit, edhe e mbajtën, "Do të vijë një ditë e bardhë e do ta ndjekim kah ka ardhë"! Këta fëmijë në vitin 1999 u bënë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lavdi!

Dhjetor 1991



FLET DAUT DAUTI

KRIJIMI I SHQIPËRISË NË LONDËR SI REZULTAT I NJË KOMPROMISI TË FUQIVE TË MËDHA

Intervistoi:
Haqif MULLIQI
Fotografinë:
Agron SHALA

Dr. Daut Dautin e njohim që nga koha kur filloi të shkruajë në revista dhe gazeta të Prishtinës dhe kur paralajmëronte një karrierë të suksesshme në gazetari. Në fillim të viteve nëntëdhjetë e hasim edhe në publicistikën shqiptare. Objekt i shkrimeve të tij ishin, veçanërisht, temat historike, që zin fill në dokumentet e Arkivit Britanik,

me çfarë, në një mënyrë apo tjetrën, iu imponua publikut shqiptar, gjithandej, jo vetëm me qasje që e detabuizonin të vërtetën historike, por edhe me "kundërvënien" që trajtesat e tij i bënin historiografisë shqiptare (zyrtare) që ishte krijuar deri atëherë dhe e cila kishte qenë nën kontrollin e rreptë të shtetit. Dr. Dauti ka mbaruar Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ka magjistruar në Londër mbi të Drejtën e Unionit Evropian, kurse ka doktoruar në Universitetin e Lidsit (University of Leeds) në Angli për histori, në një fushë jashtëzakonisht intere-

sante, e cila në vete ngërthen periudhën që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri te Konferenca e Londrës. Studimet e dr. Daut Dautit janë një kontribut brilant për hedhjen dritë mbi periudha kohore për të cilat te ne është shkruar aq pak dhe, ndonjëherë, aq afër, të cilën e thekson në vlerësimet e veta për të edhe historiani i shquar britanik Noel Malkom. Kështu, në këtë intervistë të gjatë bërë posaçërisht për revistën "Akademia", do të flasim me të për disa prej çështjeve që e kanë karakterizuar periudhën kohore me të cilën është marrë ky studi-

ues, ku gjejmë edhe çështje të caktuara të cilat, pa dyshim, për herë të parë hasen në publicistikën dhe historiografinë tonë. Dr. Daut Dauti ka botuar një mori librash publicistikë dhe shkencorë të cilët atë e bëjnë një prej zërave më të veçantë të historiografisë bashkëkohore shqiptare.

Zoti Dauti, jeni gazetar me shumë përvojë, publicist, jurist etj. Një pyetje që mund t'ju bëjë secili është kjo: si ju lindi një interesim kaq i madh, gati pasionues, për historiografinë?
DAUTI: Besoj se fillimisht

kureshtja e gazetarit më ka shtyrë të shkoj në Arkivin Britanik apo në PRO (Public Record Office). Kisha dëshirë ta dija se çka kanë shkruar diplomatët britanikë për ne shqiptarët, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj. Më interesonte qëndrimi i tyre për shkak se ne nuk dinim aq shumë për marrëdhëniet shqiptaro-britanike të cilat nuk ishin aq të dendura e të ngushta e që pas Luftës së Dytë u ndërpreu tërësisht. Në shqip, por edhe në anglisht, kishte fare pak material për këtë temë. Kontakti im me dokumentet e para në këtë arkiv



krijoi efekt të madh. I kisha para meje dokumentet që dikur ishin sekrete, që flisnin për situata dhe personalitete të rëndësishme e të cilat unë po i lexoja pas gjysmëshekulli. Këtë punë fillova ta bëja si gazetar, duke filluar nga një temë, por e vazhdova si publicist dhe më vonë u bë interesimi im pothuajë primar. Interesimi zgjerohej për shkak se dokumentet që i gjeja ishin voluminoze dhe mbulonin situata të shumta dhe periudha të ndryshme kohore. Ky interesim vazhdoi me dekada dhe kulmoi me hulumtimin e temës së doktoratës sime në Universitetin e Lidsit, e që është projekti im më i madh në historiografi. Por, në realitet, interesimi im nuk ka përfunduar këtu, pasi që ai vazhdon edhe më tutje të më cytë për të shpalosur ende dosje të mbuluara nga pluhuri të cilat flasin për shqiptarët dhe historinë e tyre. Unë e vizitoham këtë arkiv, sikur edhe disa të tjerë, edhe sot pasi që aty gjithmonë ka diçka që ngacmon kureshtjen për të zbuluar gjëra që nuk i dimë apo për t'i ndriçuar ato që nuk i dimë mjaftueshëm apo sa duhet.

Mendoj se nuk janë të paktë ata që i kujtojnë disa fejtone interesante që i botuat në pjesën e parë të vitit 1991 e që vazhduan për shumë vjet: Shqiptarët në dokumentet e Intelligent Services, ai për Konfliktin shqiptar-britanik në Korfuz, fejtone mbi Kim Filbin dhe përpjekjet e CIA-s dhe të MI-6 që në periudhën 1949-1952 ta përmbysin regjimin komunist në Shqipëri dhe kështu me radhë. Çfarë e bënte të veçantë këtë lloj të dokumentimit të historiografisë shqiptare, në veçanti pas rreth pesë dekadave të sundimit të mendimit politik dhe ideologjik në këtë shkencë?

DAUTI: Shumicën e këtyre dokumenteve, me një entuziazëm të madh, i kemi përgatitur bashkë (unë dhe ti) për botim në gazeta. Ka qenë hera e parë që në publicistikën shqiptare botoheshin dokumente nga arkivat britanike, të cilat më parë kanë qenë (top) sekrete, të përpiluara nga diplomatët dhe konsujt që kanë shërbyer në rajonin e Ballkanit. Këto raporte fillimisht kanë qenë të dedikuara për të shërbyer për informim të një numri të vogël të zyrtarëve të lartë britanikë që duhej të merrnin vendime për këto çështje. Pra, të shohësh e lexosh diçka zyrtare që dikur ka qenë shumë e rëndësishme, është një punë që ta zgjeron dëshirën për thellim të mëtejme të hulumtimit. Pastaj, mundësia që kjo të përhapet për lexim të gjerë, krijon një ndjenjë kënaqësie. Ta informosh publikun për herë të parë se çka përmbajnë dokumentet që kanë të bëjnë me Çështjen e Korfuzit, Kim Filbit dhe planit anglo-amerikan për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri dhe temave të tjera, ka qenë një punë që unë edhe sot e konsideroj

shumë të rëndësishme.

A mund të zhvillohet shkencë e historiografisë nën kontrollin e shtetit?

DAUTI: Historia është shkencë dhe shkencë nuk e duron 'rregullimin' apo çfarëdo ndërhyrje nga shteti. Ndërhyrja nënkupton caktimin e rregullave të studimeve dhe botimeve. Shkencëtarët, në mesin e tyre edhe historianët, nuk do të krijonin pasqyrë të saktë e as të qartë sikur të kufizoheshin nga tema, mënyra e hulumtimit dhe interpretimit. Historiani është i obliguar që ta studiojë ndonjë temë dhe t'i paraqes faktet apo rezultatet përfundimtare pa marrë parasysh se si pasqyrohen ato në gjendjen ekzistuese në shoqëri. Ndërhyrja e shtetit ka qenë problem në shtetet e Evropës Lindore, sidomos, pra në ish-blokun komunist, siç e quajmë edhe sot një hapësirë të caktuar gjeografike ku bën pjesë edhe Ballkani. Gjatë komunizmit shtetet e kanë dizajnuar historinë në atë mënyrë që t'u shkonte për shtati sistemit politik dhe sundimit komunist. Në Ballkan, pos problemit të komunizmit, ka pasur edhe pretendime territoriale, sikur që ka edhe sot, dhe për këtë arsye historia është ngarkuar me një dozë të konsiderueshme të nacionalizmit. Këtu shteti ka kërkuar shërbim nga historianët. Por, ka shumë raste që vetë historianët kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë shërbim brenda vijave që janë caktuar më herët nga shteti. Gjatë komunizmit janë ridizajnuar

ngjarjet historike dhe janë ndërtuar personalitete dhe heronj në atë mënyrë që të jenë në shërbim të sistemit politik. Nëse shpjegimi është ndryshe nga ai që është caktuar, ka pasur intervenimi i shtetit me penalizim. Ne kemi pasur mjaft këso rastesh në Shqipëri, por edhe në Kosovë kur ky vend ishte pjesë e sistemit territorial dhe politik i Jugosllavisë. Ta zëmë, në historinë e Jugosllavisë thuhej se Kosova kishte hyrë vullnetarisht në shtetin jugosllav dhe se pas vitit 1945 kishte përparuar dhe ishte e barabartë me të gjithë popujt e këtij shteti. Prandaj, në Ballkan nuk janë të pakta rastet që tri apo katër histori të shteteve e përvetësojnë një ngjarje apo një personalitet, zakonisht hero, si të tyre. Sot, me këtë problem, ballafaqohet edhe historiografia shqiptare. Gjatë komunizmit është caktuar vija e studimit dhe interpretimit të ngjarjeve dhe personaliteteve. Sot historianët që dalin nga kjo vijë më nuk dënohen. Por, disa ende mendojnë se këta historianë shkaktojnë 'probleme' pasi që e kundërshtojnë vijën 'tradicionale'.

Në një prej shkrimeve tuaja të vonshme, që na ka rastisur ta lexojmë, ju shkruani për ndarjet e kufirit shqiptar në dem të Shqipërisë. Kosova mbeti jashtë, pjesa perëndimore e të ashtuquajturës "Serbi e jugut" (më vonë Maqedoni) gjithashtu ngeli jashtë, por edhe kufijtë e "Shqipërisë Londineze" vazhduan të kontestoheshin pas Luftës së Parë

Botërore: kufiri i fshatrave të Korçës me Greqi, çështja e Vermoshit me Malin e Zi si dhe çështja e Shën Naumit atëbotë me Serbi. Pse mendoni se ndodhte kjo gjë?

DAUTI: Shqipëria është shtet i krijuar si rezultat i një kompromisi të Fuqive të Mëdha që u arrit në Londër në vitin 1913. Në realitet, shumica dërrmuese e shteteve të krijuara, sidomos nga shek. XIX, janë rezultat i kompromiseve ndërkombëtare. Por, ndaj Shqipërisë kompromisi ka qenë i tepruar, tejet i paarsyeshëm dhe, si i tillë, i dhembshëm për shqiptarët.

Në masën e gjerë të shqiptarëve dhe në mesin e disa historianëve tanë, Britania e Madhe shihet me sy të keq. Londra, sipas tyre, është fajtorë për përgjysmimin e Shqipërisë. Në realitet është e kundërta dhe ka mundur të jetë edhe më keq sikur britanikët ta merrnin anën e rusëve dhe francezëve që nuk favorizonin krijimin e një Shqipërie të pavarur. Sekretari i jashtëm britanik, Edward Grey, u deklarua se shteti i tij ishte neutral në këtë çështje dhe se Londra vetëm ofronte shërbim të mirë. Në realitet, Grey e përkrahu formimin e shtetit shqiptar. Formimi i shtetit shqiptar kishte domethënien e përfundimit të ëndrrave ruse dhe serbe për dalje në Adriatik dhe Mesdhe. Interesi britanik ishte që Rusia të qëndronte sa më larg këtyre deteve. Disa ditë para fillimit të Konferencës së Londrës, ministri i Jashtëm grek dhe ai serb u takuan me Edward Greyin dhe që të dy ia parashtuan të njëjtën

pyetje: cili do të jetë qëndrimi britanik në Konferencë? Që të dyve, Grey iu përgjigj: Shqipëria do të formohet si shtet autonom. Por, megjithëkëtë, britanikët nuk u interesuan për shtrirjen etnike të shqiptarëve. Interesi i tyre ishte parandalimi i depërtimit rus në Ballkan dhe Adriatik. Ky ishte kompromisi i interesit britanik. Kompromisi për Shqipërinë e përjashtoi kriterin etnik në masë të madhe. Pasi që ky përjashtim ka lënë jashtë kufirit gjysmën e territorit dhe popullsisë, shqiptarët kurrë nuk u pajtuan me të. Luftërat janë çaste kur ndryshojnë kufijtë dhe shqiptarët kanë vepruar në këto raste duke shpresuar se do t'i rregullojnë kufijtë sipas masës së tyre apo zbatimit të kriterit etnik.

Pas Konferencës së Londrës, Fuqitë e Mëdha nuk treguan interesim për Shqipërinë edhe pavarësisht prej marrëveshjes që kishin arritur që ky shtet të ndihmohet për t'u ngritur dhe ecur i pavarur në këmbët e veta. Fuqitë e Mëdha nuk i respektuan obligimet që morën në Londër. Një situatë e tillë e pafavorshme për Shqipërinë vazhdoi edhe pas Luftës së Parë Botërore. Moskujdesi i këtyre fuqive ishte shenjë që Shqipëria kishte mbetur e pambrojtur. Kjo ishte arsyeja që shtetet fqinje vazhdonin t'i kontestonin kufijtë që kishin me Shqipërinë dhe mundoheshin të grabitnin territor aq sa ishte e mundshme.

(Vijon në numrin e ardhshëm të gazetës. Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia")



VLADIMIR MAJAKOVSKIJ

LETRA E FUNDIT

Në letrën e lamtumirës Majakovskij shkroi: "Të gjithëve. Nëse vdes, mos e fajsoni askënd. Dhe, ju lutem, asnjë thashetheme. Një i ndjerë nuk mund t'i përballojë ato. Mama, motër, miq, më falni! Nuk ishte zgjidhje, (nuk ia rekomandoj askujt), por unë nuk kam zgjidhje

tjetër. Lilja, më duaj. Parti, qeveri, familja ime është Lilya Brik, nëna ime, motrat e mia Veronika dhe Vitoldovna Polonskaja. Nëse ju bëni të mundur që ato të kenë një jetesë të mirë, ju falënderoj. Siç thuhet, incidenti është mbyllur. Barka e dashurisë është thyer në luftë me të përditshmen.

Jeta dhe unë jemi një. Është e panevojshme të renditen lëndimet, dhimbjet, gabimet reciproke. Ju që mbeteni, qofshi të lumtur!"

(Përktheu: Leonora Buçinca. Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia")



Intervista e rrallë me regjisorin e madh të filmit, Akira Kurosawa (1910-1998), u botua fillimisht në revistën "Film Monthly" (Nr. 225, 1998). Në kuadër të këtij shkrimi janë inkorporuar pjesë nga bashkëbisedimi i mjeshtrit japonez, me mjeshtrin tjetër të kinemasë iraniane, Abbas Kiarostami (1940-2016). Intervistën e ka realizuar Maani Petgar

PARAJSA ËSHTË KËTU

Saktësisht, para katër vjet e gjysmë, televizioni australian SBS e miratoi realizimin e një dokumentari për kinemanë iraniane. Teksa me producentin Claude Gonzales ishim në fazat paraprake të hulumtimit dhe të përgatitjes së materialit, një bisedë në mes të regjisorëve Akira Kurosawa dhe Abbas Kiarostami u botua në revistën *Film International*. Thamë se do të ishte gjë e mirë nëse z. Kurosawa do t'i jepte ato komente edhe në filmin tonë. Nëse kjo do të ishte e mundur, do t'ia shtonte vlerën kinemasë iraniane, gjithashtu edhe filmit tim.

M'u kujtua Donald Richie, autori dhe kritiku amerikan i filmit, i cili pesëdhjetë vjetët e fundit jeton në Japoni. Mendova se është personi ideal për të na ndihmuar për të rënë në kontakt me z. Kurosawa. Richie i ka shkruar 22 libra për kulturën, për historinë dhe për kinemanë japoneze. Ai, po ashtu, i ka titruar në anglisht shumë filma japonezë, përfshirë disa nga filmat e fundit të Kurosawas. Ia shkruam një letër dhe morëm përgjigjen ku thuhej se, pasi i kishte bërë dy vlerësime të këqija

për dy filmat e fundit të Kurosawas, Kurosawa ishte ndier disi i ofenduar. Na sugjeroi që të mos e përmendim emrin e tij, por na dha ca këshilla se si t'i afrohem.

Rreth një muaj më vonë e morëm një përgjigje nga zyra e Kurosawas: *Jam nipi i Kurosawas dhe menaxheri i produksionit të filmave të tij. Z. Kurosawa ka shfaqur interesim për t'ju takuar. Dëshiron që t'ia jepni hollësitë, përfshirë datën kur planifikoni ta bëni intervistën.*

Nuk ishim të sigurt se çfarë nënkuptonin saktësisht me hollësitë. Natyrisht, kishim ca mëdyshje, por Donald Richie na kishte folur aq shumë për dallimet mes kulturave japoneze dhe perëndimore sa që nuk kishim besim në marrjen e vendimeve. Pra, e kemi kontaktuar Richien edhe një herë dhe ai na thotë që ta kufizojmë ekipin e filmit dhe të ndriçimit sa më shumë që të jetë e mundur, si dhe që ta kufizojnë kohën e intervistës në një orë. I shkruam hollësitë dhe ia dërguam me faks Zyrës së Kurosawas. Disa ditë më vonë morëm përgjigjen përfundimtare

dhe afirmative, së bashku me datën e saktë, kohën e intervistës dhe vendndodhjen që duhej të ishte në njërin nga vilat e Kurosawas në Tokion jugore, pranë malit Fuxhi. Edhe një hartë e rajonit, distanca e tij nga Tokio, si dhe udhëzimet me shkrim nga stacioni vendës i trenave, u dërguan me faks te ne.

Për disa ditë me radhë të gjithë ishim si të hutuar. Nuk mund të besonim se 83-vjeçari Kurosawa e kishte pranuar intervistën. Ai rrallë jep intervista, ndërsa kishte pranuar të merrte pjesë veç në një konferencë për shtyp për shfaqjen e filmit të tij të fundit. E kontaktuam Donald Richien për ta falënderuar për këshillën e tij. Ai na tha: *Ju thashë se do t'ia dilni mbanë me intervistën, përderisa jeni të huaj, e sidomos për shkakun se jeni iraniane.* Të huaj për arsye se Kurosawa nuk ishte shumë i interesuar për mediat, për shtypin, për kritikët dhe për audiencën japoneze, meqë ishin gjithmonë indiferentë ndaj filmave të tij - dhe iraniane sepse Richie kishte mësuar nëpërmjet miqve të ndërsjellë se Kurosawa i pëlqente filmat e Kiarostamit.

Në qershor të vitit 1994 u nisëm për në Tokio me dy kamera dhe me disa drita. Kisha aq stres në aeroplanin për në Tokio, thajse isha duke shkuar për ta intervistuar Kurosawan menjëherë si të zbrisja. Përkundër shpenzimeve në Tokio, kishim planifikuar të shkojmë pesë ditë para intervistës. Doja të kisha kohë të mjaftueshme për ta krijuar një ide të Tokios së Kurosawas dhe të regjisorit Yasujiro Ozu. Intervista do të jetë në ditën e gjashtë dhe do të kemi një ditë shtesë për ta parë materialin - para se të largoheshim.

Pothuajse gjatë tërë kohës isha nervoz sepse në letrën e dytë Kurosawa kishte kërkuar që pyetjet të jenë instiktive e jo të paraplendura. Si është e mundur kjo? Çka nëse e kam një bllokadë mendore dhe nuk mund të mendoj gjë për të pyetur? Nuk mund ta rrezikoj një gjë të tillë, prandaj më duhej t'i mësoja përmendësh pyetjet (të paktën tri ose katër prej tyre) dhe të shoh se në cilin drejtim intervista shkon më vonë.

Thënë të drejtën, regjisorin im i preferuar japonez është Ozu. Më pëlqen Kurosawa, kryesisht për

veprat e tij urbane, sidomos *Tengoku to Jigoku (Parajsa dhe ferri, 1963)*. Por, siç e dini, ai është më i njohur për realizimet e tij epike.

Pesë ditët e para u sollëm si turistë. E pyeta Richien nëse ka lagje në Tokio, siç i kishte paraqitur Ozu. Për fat të mirë, ai tha se lagja e tij ishte një nga to. Megjithatë, unë nuk e di pse kujtimet e mia fillestare për Tokion u përmbledhën në varrezat e bukura dhe paqësore. Ato ishin vendet e vetme ku mund të rrije i vetëm. Sidoqoftë, bëmë shëtitje nëpër Tokio aq sa mundëm. Kaluan pesë ditë duke shkuar nëpër tempuj, nëpër lagje të vjetra e të reja dhe duke fjetur në hotele të lira. E, në pasditen e së shtunës, më 11 korrik (1994), hipëm në tren dhe udhëtua për një orë e gjysmë në vilën e Kurosawas. I morëm parasysh të gjitha pengesat e mundshme, në mënyrë që të mos arrijmë atje më vonë se në orën tre pasdite, që ishte koha jonë e paracaktuar. Kur zbritëm në stacionin lokal të trenit, vërejtëm natyrën e fshatit si dhe makinat e shtrenjta dhe antenat e mëdha televizive që na kujtojnë teknologjinë gjithnjë e më të pran-



ishme në Japoni.

Ne (unë, producenti Claude Gonzales dhe përkthyesi Houshang Raasti) arritëm fiks në orën tre (natyrisht, i kaluam disa orë në stacion që të mos shkonim atje shumë herët). Kur taksi iu afrua vilës kodrinore të Kurosawas vumë re një burrë, rreth 35 vjeç, që dilte nga shtëpia nëpër oborr e për në rrugë, për të na çuar në hyrje. Në mes të hyrjes dhe derës së dhomës së pritjes ishte një zonë - ashtu si në shtëpitë iraniane - ku të gjithë i zbathëm këpucët. Dhoma e pritjes ishte mjaft e madhe dhe kishte dritare të mëdha në të tria anët, me pamje nga mali Fuxhi. Na çuan në një tavolinë në një cep të dhomës së pritjes. Na pyetën se sa kohë na duhet për t'u bërë gati. E pyeta ndihmësin e tij se ku preferon z. Kurosawa të ulet. Ai vuri në dukje një karrige dhe kjo ndodhi kur pashë një ventilator përballë me të. Po piknim nga djersët. Vapa ma kujtoi dëshpërimin e detektivit (Toshiro Mifune) në filmin e Kurosawas, *Nora inu* (*Qeni i rrugëve*, 1947).

U shërbyem menjëherë me pije të ftohta: kafe të ftohtë, me pak krem në majë. Kurrë nuk do ta harroj shijen e asaj pije që ishte shumë freskuese, por jo e mjaftueshme për mua. Sidoqoftë, kur i thashë asistentit të tij se jemi gati, dy minuta më vonë hyri z. Kurosawa. Një grua rreth 35 vjeçe e ndoqi nga pas (besoj se ishte vajza e tij). Kurosawa erdhi drejt nesh dhe pas përsëritjeve dhe shtrëngimeve të duarve, u ul në karrigen e tij mjaft të mirë. Producenti ynë ia kishte sjell një dhuratë: një libër të disa prej pamjeve natyrore të Australisë.

Meqenëse arsyeja kryesore për ta kërkuar këtë intervistë ishte t'i dëgjojmë fjalët e tij për Kiarostamin, doja të arrija te ajo pjesë - sa më shpejt që jetë e mundur - e pastaj, me shpresë të kaloja te aspektet më personale të filmave të tij.

Z. Kurosawa, më intereson ta di se si u njohët me kinemanë iraniane?

Filmi i parë që pashë ishte një

film nga Kiarostami. Gjatë regjimit të Shahut u ftova në Iran për të qenë pjesë në jurinë e Festivalit të Filmit të Teheranit të cilin e refuzova pasi ishte përgjegjësi e madhe. Pas revolucionit e pashë filmin e z. Kiarostami (*Khane-ye dust kojast/Ku është shtëpia e shokut?*, 1987) dhe isha i habitur se sa mirë ishte realizuar.

Ekranit është si një shesh i madh në të cilin të gjithë mund të mblidhen dhe të flasin me njëri-tjetrin. Për shembull, unë sjell në ekran problemet e vendit tim dhe Kiarostami të vendit të vet. Aktorët i shprehin fjalët tona dhe e prekin zemrën e të gjithëve. Ky është roli i kineastëve, që të bisedojnë me njëri-tjetrin. Dhe, kjo është përgjegjësia e kinemasë.

Një film duhet të bëhet me zemër e jo me mendje. Unë mendoj se prodhuesit e rinj të filmave e kanë harruar sot këtë dhe në vend të kësaj po bëjnë filma përmes llogaritjeve. Kjo është arsyeja se pse filmat japonezë nuk kanë më audiencë. Me gjithë ndershmërinë, filmat duhet të bëhen për t'i synuar zemrat. Gjatë kohës së Ozusë, mentorit tim dhe, gjithashtu, në kohën time, asnjë regjisor nuk bëri filma duke u bazuar në teori dhe në llogaritje, e për këtë arsye kinemaja e Japonisë ishte e aftë të ndërtonte vitet e saj të arta.

Regjisorët e rinj po përdorin teknika për ta poshtëruar audiencën. Kjo është një gjë e gabuar. Ne duhet t'i shërbejmë kinemasë dhe ta krijojmë një film që do ta nxiste audiencën. Tekefundit, qëllimi duhet të jetë të krijojmë një film artistik. Kjo është e thjeshtë, apo jo?

Në filmat tuaj të vjetër ka pasur gjithmonë shqetësime për rrethanat njerëzore. Cili është burimi i kësaj?

Kur flitet për njerëzoren në Japoni, të gjithë mendojnë për tema dhe për tregime komplekse. Sidoqoftë, pavarësisht nga ndjenja e një njeriu të zakonshëm, në ekran përpiqemi ta projektojmë në mënyrë të ndershme. Kjo është e tëra.



ERICH FRIED

PYETJE PËR IZRAELIN

*Në një botë të padrejtë
Të jesh i drejtë
Është vështirë
Në rast se përpiqesh
Rabbi Hillel ka pyetur
Para 2000 vjetësh
"Nëse unë nuk jam për vete
kush është për mua?"*

*Por të jesh i drejtë vetëm për vete
Vetëm pse të tjerët ishin të padrejtë?
(dhe fundi jo ata mbi të cilët sot
po ushtrohet vetëdrejtësia ishin të
padrejtët)
Rabbi Hillel ka pyetur
Para 2000 vjetësh
"Nëse unë jam vetëm për veten
çka jam unë?"*

*Sot këtë pyetje e bën shumëkush në
Izrael:
Nëse nuk jemi për palestinezët
Çka jemi?
Ç'pasqyrim i vonuar
I armikut jemi atëherë?"
Mirëpo të tjerët thonë: "Ka kohë,
të mirat vijnë ngadalë"*

*Rabbi Hillel ka pyetur
Para 2000 vjetësh:
"Kur, nëse jo
sot?"*

ÇLIRIMI NGA IDHUJT

*Askush më i vogël
Se Leonardo da Vinçi
Na mëson:
"Ai që gjithmonë citon autoritetet
vë në përdorim kujtesën
por jo
edhe mendjen e vet"*

*Pra mbajeni mend:
Siç thotë edhe Leonardo da Vinçi
Çlirohuni nga autoritetet*

STATUS QUO

*Kush do
Që bota
Të mbetet
Ashtu si është
Ai nuk do
Që bota të mbetet*

SHEMBULL I VOGËL

*Edhe jeta e pajetuar
Merr fund
Ndoshta më ngadalë
Se një bateri
Në një llambë dore
Që s'përdoret kurrë*

*Por kjo nuk ndihmon shumë:
Kur njeriu
(Supozojmë)
Pas vitësh të tëra
Do ta ndezë atë llambë ajo
Nuk nxjerr asnjë rreze drite
Dhe nëse ti e ndez atë
Has vetëm në kockat e tua
E nëse nuk ke fat
Edhe ato
Do të jenë të brejtura*

*Ndërkaq që ti
Po aq mirë
Do të mund të kishe ndriçuar*

NJË PARAKUSHT SHITESË

*Nuk është
Vetëm e rëndësishme
Që një njeri
Të mendojë drejt*

*E rëndësishme është
Gjithashtu
Që ai që mendon drejt
Të jetë njeri*

(Përktheu: Ismet Daci. Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia").



(Në fotografi Akira Kurosawa dhe Abbas Kiarostami. Përktheu: Agron SHALA. Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia". Vizion).

ALL RIGHT

-tregim satirik-



JAROSLAV HAŠEK

Konti Lorenc u rikthye nga një udhëtim eksplorues në Afrikë, në të cilin kishte kaluar një vit e gjysmë. Në të vërtetë, udhëtimi i tij ishte i tillë, që ai të kalonte gjysmë viti në Algjeri, gjysmë në Tanger dhe gjysmë në Aleksandri dhe Kajro, duke kaluar nëpër fqinjësitë, ku mund ta adhuronte vallen e mrekullueshme të barkut. Ndokush e sheh që ta kërcejnë këtë valle për gjysmë ore dhe kënaqet ose rëndohet, por zoti kont duroi ta shihte këtë veçanti të lindjes për një vit e gjysmë. Administratori i pasurisë së tij i dërgonte çdo gjashtë muaj një telegram, me përmbajtjen e mëposhtme: "Gjithçka në rregull". Përgjithësisht ia dërgoi këtë telegram tri herë, por para se të largohej për në atdhe, zoti kont mori një telegram, i cili përmbante një fjalë më tepër: "Gjithçka është shumë mirë".

Ky ndryshim i befte e trembi kontin, pasi administratori shquhej për lakonizmin e tij dhe të shtonte në telegram një fjalë më tepër, do të thoshte se diçka e tmerrshme do të kishte ndodhur. Dërgoi përgjigjen e vet: "Më pritni në stacion së bashku me karrocën të martën e ardhshme në pasdite" dhe mori rrugën e kthimit, duke bërë ndërkohë edhe një kthim në Maltë, pasi kishte dëgjuar se aty vallja e barkut kërcehej pakëz më ndryshe se në Egjipt. Kështu që u kthye të martën.

"Gjithçka shkon për mrekulli" i tha administratori i tij, ndërkohë që karroca me pasagjerë me ata të dy përshkonte rrugën nga stacioni për në kështjellë.

Konti, duke hedhur sytë jashtë karrocës, pa arat e tij të shkatërruara nga breshëri. Tregoi me dorë, i habitur, tokën e shkretuar. "Jemi me fat, shkëlqesi" - i tha i kënaqur administratori, "në të gjitha këto ara gruri zuri krimbin e të lashtave. Na duhej një katastrofë derisa të lahej gruri, pasi nuk do të kishim problem vetëm këtë vit. Në qoftë se nuk do të zhdukej sivjet, do të shfaqej me siguri vitin tjetër. Për dy vjet me radhë do të kishim mungesa të mëdha. Lavdi Zotit, për fatin tonë të mirë erdhi breshëri, na goditi në shenjë dhe shkatërroi krimbin e grurit së bashku me grurin".

Administratori fshiu djersën e ballit dhe nxori kapelën. "Tepër dinjitoz ai kryqi i ri, për hir të së vërtetës", tha duke treguar kryqin e hekurt mbi një shtresë të trashë rëre, "por e meritonte realisht. Ju shërbeu me përkushtim".

"Cili?"

"Piteri, shërbëtori juaj".

"Piteri im?"

"Po, shkëlqesi. Gjatë kohës së shtrëngatës, kaloi këtej së bashku me ata dy kuajt e bardhë, të cilët para dy vjetësh kishit mirësinë t'i sillnit nga Rusia, nga stallat e Stolinskit. Bisedova për këtë punë me mësuesin Parlik nga Nusiçi dhe ai mendonte se rrufenë e tërheq më tepër ngjyra e bardhë. Sigurisht duhet të ketë qenë rrufe e fuqishme - rrufe e plotë. Jo vetëm që vrau çiftin e kuajve, por e goditi me një mënyrë tepër interesante edhe vetë shërbëtorin. U gjendën të shkruara të gjitha pullat e tij, ndërkaq mori flakë edhe vetë veterineri".

"O Zot, cili veteriner?"

"Veterineri i krahinës, shkëlqesi. I pata thënë të vinte edhe ai i shkreti, por nuk arriti të mbërrinte më tej kryqit. Fatkeqësisht, ishte e nevojshme të vinte, pasi gjendja e demave tanë ishte e veçantë. Lopët tona ishin të mirushqyera, të shëndetshme dhe të lumtura. U pëlqente jeta që bënin aq sa hanin çdo ditë e më tepër për t'u dukur më të bukura, por në njëfarë kohe hëngrën më tepër nga ç'duhej, nuk i jepnin më rëndësi as tërfillit, as barishteve të tjera dhe një ditë njëra prej tyre ngordhi. Të tjerat filluan të mbanin zi, u thanë nga lotët dhe ngordhën njëra pas tjetrës. Atëherë ndjeva nevojën ta thërrisja veterinerin. Fatkeqësisht, kjo çështje nuk kishte një fund të mirë dhe, së fundi, kur erdhi veterineri i ri, kishim shumë shpenzime dhe problemin e groposjes së lopëve. Shkëlqesia juaj nuk mund ta konceptojë se sa shumë punë duhet bërë për t'i groposur treqind lopë. Përgjithësisht, gjithçka shkon mirë".

Administratori fshiu djersën e ballit dhe vuri përsëri kapelën. "Ai kryq", tha, duke treguar me dorë tej një hendek, "nuk është edhe aq i bukur, pasi stallieri juaj nuk meritonte diçka më të mirë". Konti zgurdulloi sytë. "Ai, sigurisht, shkëlqesi, u vetëvra me iniciativën e vet për shkak të një gjendjeje të çuditshme. Lu ngulit ideja ngulmuese, se ishte infektuar nga hamshori i stallës, të cilin e përkujdeste, kështu që e varrosën së bashku me hamshorin e ngordhur".

Konti u hodh përpjetë i tronditur. "Mos u tronditni, shkëlqesi" - e qetësoi me zë të butë administra-

tori, "punëmarrësi që mori përsipër këtë çështje, i sollti të gjithë kuajt dhe e bëri shumë lirë. Fituam gjithsej njëqind korona. Fatkeqësisht, varrimi i stallierit kushtoi tetëdhjetë korona. Veç ishte një varrim i suksesshëm. Koha ishte e mrekullueshme, as e ngrohtë as e ftohtë, aspak mbytëse, ajri gjithashtu frynte këndshëm, kështu që ajo Francezia juaj, të cilën e sollët para dy vjetësh nga Parisi, gjatë ndarjes së saj bëri një kalim të bukur në drejtim të stacionit. Më mirë të qetësohet shkëlqesia juaj, të gjitha janë të rregulluara. Të gjitha janë në rregull. All right! Sidoqoftë, vajza ishte pa përvojë dhe kush mund ta dijë se çfarë qëndrimi do të mbante para grackave të ndryshme që do t'i ngrinin. Fatmirësisht, së bashku me të na la shëndetin edhe dhëndëri, shkëlqesi. Mori një kohë shumë të gjatë derisa ta dorëzonin zviceranët tek autoritetet austriake, por gjyqi e nxori të pafajshëm, pasi thoshte se dëmtimi ishte vënë në vend, madje i gjetën të gjitha sendet e çmuara familjare që kishte vjedhur, shkëlqesi".

Konti Lorenc zgurdulloi sytë akoma më shumë. Kuajt kalonin me galop, nga një zonë ku gardhi me thurimë teli në shumë vende

ishte i shqyer.

"Ç'u bë me këtë rrethim?" - thirri i sfillitur konti.

"All right!" - i tha administratori, "asgjë s'u bë, asgjë, shkëlqesi. Tani për tani nuk na duhet rrethimi, pasi lama dhe sorkadhet nga Japonia, që i sollët para tre vjetësh për kafshë shtëpiake, nuk mund të ikin. Në të vërtetë nuk mund të ikin, pasi nuk janë më. Mos u tronditni, kjo ndodhi vetvetiu. Tufa e qenve ujqër, ata këlyshët e vegjël, të cilët kishin mirësinë t'i blinin në Uhri, u rritën aq shpejt sa rrjedhja e ujit dhe u bënë ujqër të vërtetë. Qysh në fillim ishin ujqër të vërtetë, po derisa ta kuptonim ne, na shqyen dhe na hëngrën të gjitha sorkadhet japoneze. Në këtë mënyrë u zhduk pa lënë gjurmë edhe roja e portës dhe mendoj se ata përbindësia janë përgjegjës për këtë. Por shitëm me çmim të mirë lëkurët e tyre".

"Po lama ç'bën?"

"O, ajo ia doli mbanë për mrekulli dhe tani është balsamosur me sukses të plotë. Kishte aq pleshta saqë ujqërit nuk e morën mundimin ta hanin, kështu që i doli për mbarë. Një çast gjeti në pyll një çantë me fishekë dhe u mundua ta hante. Një fishek shpërtheu dhe predha i kaloi nëpër tru. Prej andej u kthye pas dhe i doli nga syri i djathtë. Ama

lëkurën nuk e preku fare. Vetëm se goditi strucin pranë tij, i cili vështronte me kërshtëri. Struci tjetër iku nga vdekja natyrale. Pa lejlekun që rrinte me një këmbë dhe u mundua të rrinte edhe ai në të njëjtën mënyrë. Meqë nuk mundi, u vra shpirtërisht, e zuri marazi, siç thuhet, u përpoq përsëri e përsëri dhe, pasi i pa të gjitha, ndaloi së ngrëni derisa e gjetën shakull.

Çfarë po ju ndodh, shkëlqesi? Ju lutem, merreni veten! Sigurisht, është e vërtetë, që në ndonjë periudhë kohore në këto vende kishte edhe sera ngrohëse, por askush nuk do ta besonte se xhami do të digjej dhe pemët e palmës do të digjeshin dhe do të rrëmbenin madje edhe kaktusët e shtrenjtë. Unë i pashë me sytë e mi, shkëlqesi dhe nuk e besoj...".

Në parkun e fermës së Nezdiosovskit vizitori sheh shumë shpesh që të kalojë mbi rrugicat e shtruar bukur edhe një zotëri plak, i cili hap duart dhe i thotë vetes: "Në rregull. Gjithçka në rregull". Mjekët konkluduan se kjo shprehje nuk do t'i ikë kurrë derisa të jetë gjallë. Dhe ky nuk është kush tjetër, veçse konti Lorenc.


(Përktheu: Iliaz Bobaj. Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia")





FJALIM I PRITJES NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË BORDOSË

I mbajtur më 1 maj 1716



MONTESQUIEU

Dijetarët e antikitetit i merrnin dishepujt e tyre pa përzgjedhje apo teste: ata besonin se mençuria, ashtu si arsyeja, duhet të jetë e përbashkët për të gjithë njerëzit edhe se, për të qenë filozof, mjafton të kesh sadopak shije për filozofinë.

Zotërinj, sot mes jush ndodhem unë që nuk kam se ç't'ju paraqes tjetër veç një dashuri të madhe për studimet dhe shijen për letërsinë. Nëse, për ta marrë këtë nder, do të mjaftonte t'ia dija mirë çmimin dhe të ushqeja për ju respekt dhe konsideratë të lartë, mund ta mendoja veten plotësisht të denjë dhe mund të krahasohesha me atë trojan i cili meritoi mbrojtjen e një peren-

deshe vetëm sepse iu duk fort e bukur. Po, zotërinj, e shoh akademinë tuaj si stolinë e krahinave tona; e shoh ngritjen e saj si ato lindjet e gëzueshme ku dijet qiellore kryesojnë gjithmonë.

Deri më tash shkencat i kishim parë jo vetëm të lëna pas dore, por të përbuzura, shijen tërësisht të prishur, letërsinë të struktur në errësirë të plotë dhe vjershat krejt të huaja në atdheun e Paulinve dhe Ausoneve.

Gabojmë kur mendojmë se ishim të njohur te fqinjët tanë për mprehtësinë e mendjes tonë. Pa dyshim, kemi qenë për barbarinë e gjuhës sonë.

Po, zotërinj, ka qenë një kohë ku ata që iu dhanë me mish e shpirt studimeve u konsideruan si njerëz të çuditshëm, të cilët nuk ishin të një brumi me njerëzit e tjerë. Ka qenë një kohë ku shihej si diçka qesharake e aspak e natyrshme të çliroheshe nga paragjykimet e popullit dhe ku secili e shihte verbërinë e tij si një sëmundje fort të dashur, shërimi i së cilës përbente rrezik.

Në një kohë aq kritike për

dijetarët nuk mund të ishe më i ndriçuar se të tjerët pa u ndëshkuar: nëse dikush merrte guximin të dilte nga një sferë e ngushtë që kufizon njohuritë njerëzore, një pafundësi insektesh që ngriheshin përnjëherësh formonin një re për ta errësuar atë; edhe ata që e çmonin në heshtje revoltoheshin në publik dhe nuk mund t'ia falnin fyerjen që ua bënte duke mos u ngjarë atyre.

Vetëm juve ju takonte t'i jepnit fund këtij mbretërimi apo kësaj tiranie të injorancës: dhe ju e bëtë, zotërinj; kjo tokë ku jetojmë nuk është më dhe aq e thatë; dafinat rriten aty, për fat të mirë; po i këpusim ato nga të gjitha anët; studiuesit e të gjitha viseve ju kërkojnë kurora: Manibus data lilia plenis.

Është pak për ju që kjo akademi t'ju detyrohet si për krijimin ashtu dhe për zhvillimin e saj. e shoh më tepër si një trofe të madh, i ngritur për lavdinë tuaj, sesa si një kompani e cila duhet t'i përsosë shkencat: më duket sikur dëgjoj secilin prej jush të shqiptojë këto fjalë të poetit lirik: Exegi monumentum ære

perennius.

U gjallëruam në këtë sipërmarrje të madhe nga ky mbrojtës i shquar, mendja edhe syri vigjilent i tij kujdeset gjatë gjithë kohës për ne. E kemi parë t'i lë mënjanë kënaqësitë e oborrit mbretëror dhe të ndihet i pranishëm deri në skajet më të largëta të krahinave tona. Pikërisht kështu na i paraqesin dhe rrefenjat ato perëndi të dobishme që nga rehatitë e vendbanimeve të qiellit zbresin në tokë për t'u dhënë dritë popujve të egër ku të lulëzojnë në mes tyre shkencat dhe artet.

A do të guxoja t'ju rrëfeja, zotërinj, atë që modestia ime e ka mbajtur përbrenda deri tani? Kur shihja se si po ngrihej Akademia juaj aq e dashur, ndjeva një gëzim të madh thellë brenda vetes dhe, ose një instinkt miklues dukej sikur më kumtonte atë që po më ndodh në këto çaste, ose një ndjenjë vetëvlerësimi ma bëri ta shpresoja, gjithnjë i shihja dokumentet e themelimit tuaj (institucional) si të ishin pronë e vyer e familjes sime.

I lidhur me shumë prej jush nëpërmjet hireve të miqësisë,

shpresoja që një ditë, me anë të këtyre të fundit, të bëhesha pjesë e një angazhimi të ri dhe t'u bashkoja atyre edhe marrëdhënien e letrave, meqë isha tashmë në mesin tuaj falë lidhjes më të fortë që ka ekzistuar mes njerëzve. Dhe, nëse ajo që thotë njëri prej poetëve tanë më gazmorë nuk është aspak marrëzi, që duhet të kesh prirje për të qenë njeri i ndershëm, a nuk mund të besoja se zemra, të cilën këto prirje e kanë zotëruar, do t'u shërbente si garanci për mendjen dhe shpirtin tim?

Ndiej sot, zotërinj, se nuk jam mburrur aspak me tepricë. Dhe, qoftë që ju më keni dhënë hakun, qoftë që unë kam ditur t'i josh gjykesit e mi, jam njësoj i kënaqur me veten: publiku do të verbohët me këtë zgjedhje tuajën dhe nuk do të shohë më mbi kokën time veçse duart mjeshtërore që më kurorëzojnë.

(Shkëputur nga libri "Ligjërata akademike", i cili është në proces botimi nga shtëpia botuese "Logos-A". Përktheu: Verjon Fasho. Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia")



Bisedë me prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha, kryesuese e Këshillit të Librit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe sportit

Misioni i librit është i shenjtë dhe i pazëvendësueshëm në jetët tona

Ajete ZOGAJ

Znj. Keçmezi-Basha, jeni kryesuese e Këshillit të Librit, organ këshillëdhënës i ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës. Detyrat e këtij këshilli, sa dimë, nuk janë publike, prandaj do të donim të dinim çfarë bëni?

Keçmezi-Basha: Ditë më parë patëm mbledhjen e fundit për këtë vit dhe në të diskutuam për punën e bërë gjatë 12 muajve. Dua të theksoj se librat janë gjërat më me vlerë në jetët tona dhe askush nuk di të na mësojë më mirë sesa një libër. Prandaj, nëse duam t'i realizojmë ëndrrat, dëshirat e synimet tona, atëherë duhet të mësojmë nga librat se si të përballemi jetën e përditshme dhe me atë që na pret. Edhe angazhimi ynë i shtuar, për përkrahjen e financimit të librave tek ne, është i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Dhe sa hedhim një shikim në historinë e librave dhe të librarive, përfundojmë në vitin e largët 1732, te libraria më e vjetër në botë që vazhdon të funksionojë edhe sot, Libraria Bertrant në Lisbonë. Me logon e vet që shfaq vitin 1732, demonstron se shpëtimi ka qenë i mundur falë librit, në dyqanet e librit dhe ende vazhdon. Pra, kjo dëshmon se sa i rëndësishëm është libri. Amos Ozin, shkrimtarin izraelit, i cili ishte kandidat për çmimin Nobel, më 2008 e kishin pyetur gazetarët: "Po mos të ishe njeri, çfarë kishe dashur të ishe?" Ai, pa hezituar, ishte përgjigjur: "Sigurisht, se kisha dashur të isha libër ngaqë çdo gjë humbet e tretet, por libri dikur, në ndonjë qoshe të ndonjë biblioteke apo familjeje, ngel dhe nuk zhduket kurrë...". Pra, kjo dëshmon se sa i rëndësishëm është libri për jetën e njeriut.

Çfarë pune kryen Këshilli i Librit?

Keçmezi-Basha: Unë jam kryesuese e Këshillit të Librit i cili ka 11 anëtarë. Ky është një këshill këshillëdhënës, i përbërë nga: përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave të Kosovës, nga Universiteti i Prishtinës, Instituti Albanologjik, Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, nga Shoqatat e Botuesve e Kosovës, nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës, nga Ministria e Arsimit dhe nga katër anëtarë që i ka zgjedhur Ministria e Kulturës e Kosovës. Të gjithë anëtarët janë njohës të mirë të fushave prej nga vijnë, prandaj e kemi punë më të lehtë. Botimet shqiptare te ne duhen edhe më shumë të stimulohen



prej institucioneve shtetërore. Ministria e Kulturës respekton vlerat dhe cilësitë e mirëfillta kulturore. Ajo është e vetëdijshme se libri nuk është koniunkturë tregu dhe duhet t'i respektojë ligjet e veta. Kudo në botë, me shekuj, ekzistojnë mekanizma të shtetit që e mbrojnë jetën e librit dhe identitetin e botuesve. Shteti, për shembull Ministria e Kulturës, nëpërmes institucionit të vet - Këshillit të Librit - stimulon botimin e librave të autorëve kombëtarë, por edhe ata të ndërkombëtar, natyrisht me vlera të padiskutueshme.

Znj. Keçmezi-Basha, sa është punuar në Këshillin e Librit këtë vit?

Keçmezi-Basha: Unë që dy vjet jam kryesuese e Këshillit të Librit, andaj do të ndalem për një moment vetëm në vitin 2019. Këshilli i Librit ka mbajtur 13 takime. Në takimet e Këshillit janë trajtuar tema të ndryshme dhe janë bërë propozime me vlerë nga ana e anëtarëve të Këshillit. Kemi punuar e përpunuar ligjin, pjesën për Këshillin e Librit. Kemi bërë propozime për hapjen e konkurseve për financimin e botimit, për blerjen dhe financimin e revistave që botohen në Kosovë, por duhet theksuar se kemi bërë ndryshime të dukshme, sidomos në shpalljen e konkurseve për financimin e botimit të librit, blerjen dhe financimin e botimit të revistave. Anëtarët e Këshillit të Librit kanë marrë pjesë aktive

në takimet e grupeve punuese për Plotësimndryshimin e Ligjit për veprimtari botuese të Këshillit të Librit që janë mbajtur më 15-16 maj 2019 në Prishtinë. Gjithashtu, është punuar gjatë në Rregulloren për Punën e Këshillit të Librit. Do të punojmë edhe në të ardhmen ngaqë ka ende punë të papërfunduara. Të gjitha mbledhjet që janë mbajtur në Këshillin e Librit kanë pasur kuorum dhe të gjitha vendimet që janë marrë, janë marrë me shumicë votash. Deri më tani nuk ka ndodhur të kemi ndonjë konflikt interesi brenda Këshillit të Librit.

Mund të na thoni se çfarë ka financuar këtë vit Këshilli i Librit?

Keçmezi-Basha: Investimi në librin shqip dhe blerja e shpërndarja e tij nga ana e Ministrisë së Kulturës mund të themi se tashmë ka një traditë të konsoliduar. Por, duhet shtuar se edhe më tej duhet të punohet vazhdimisht për promovimin e kësaj veprimtarie. Këtë nxitje mund ta bëjmë vetëm nëpërmjet trajtimit të dinjitetshëm të librit. Duhet theksuar se Ministria e Kulturës nëpërmes propozimeve të Këshillit të Librit ka financuar botimin e librave të autorëve shqiptarë të të gjitha trevave, orientimeve politike, shoqërore, letrare e estetike, duke u treguar e hapur ndaj prirejeve e preferencave të ndryshme stilistike e të tjera, si edhe letërsi botërore të vendeve e gjuhëve të ndryshme

të të gjitha periudhave letrare - nga antika e deri në ditët e sotme. Ministria e Kulturës gjatë vitit që po e lëmë pas ka financuar 13 revista letrare me karakter kombëtar dhe regjional, me shumën 41.500 euro; ka financuar botimin e 97 librave të autorëve të ndryshëm, me shumën financiare prej 76.700 eurosh; ka bërë blerjen e 112 titujve të librave nga shtëpitë botuese, me shumë në të holla prej 34.524 eurosh nga autorë kombëtarë e të huaj. Totali i investimeve ka qenë 152.724 euro. Të gjitha këto që i ceka më lart janë propozime nga anëtarët e Këshillit të Librit, ndërsa buxheti i ndarë për përkrahjen e librit për 2019-m ka qenë 160.000 euro. Ministria e Kulturës më 12 korrik 2019 ka organizuar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ceremoninë e pranimdorëzimit të 137 titujve/librave për pasurimin e 37 bibliotekave komunale dhe ndërkomunale në të gjithë territorin e Kosovës. Në shikim të parë fitohet përshtypja se nuk janë shumë, por mos të harrojmë se jemi shteti më i ri në botë dhe kemi objektiva që, krahas kësaj, duhet ranguar edhe prioritetet e tjera. Duke e ditur rëndësinë që ka libri, Ministria e Kulturës, përveç që financon botimin e librit, merr përsipër që edhe ta blejë atë dhe ta shpërndajë në bibliotekat e komunave të Kosovës. Po ashtu, edhe blerja e librit dhe financimi i revistave letrare është bërë në bazë të këtyre parimeve.

Zonja Keçmezi-Basha, po në panairë të librit, merrni pjesë?

Keçmezi-Basha: Që nga dita e krijimit të Këshillit të Librit anëtarët e saj kanë marrë pjesë rregullisht në panairë kombëtare e ndërkombëtare të librit. Ta zëmë se sivjet për herë të parë disa anëtarë të Këshillit të Librit kanë marrë pjesë në Panairin e Librit në Leipzig, duke promovuar autorët shqiptarë në botë si dhe duke shpërndarë veprat e tyre kudo që ka shqiptarë. Unë kujtoj që çdo shtet ka nevojë të ketë institucione përmasash të tilla, të ketë përkrahje të drejtpërdrejtë. Kujtoj se shkrimtarët e mirëfilltë dhe të rinjtë preferojnë më shumë që t'i botojnë librat nën logon e Ministrisë së Kulturës e cila di ta vlerësojë librin, ta proklamojë e ta shpërndajë atë. Para se gjithash, Ministria e Kulturës ka sjellë një kulturë për financimin e botimit të librit shqip; ka sjellë një numër të madh titujsh; ka sjellë një kulturë për shpërndarjen e

librit. Ministria e Kulturës shquhet më së shumti për ndihmën e madhe që i jep botuesit, autorit dhe bibliotekave, duke e dëshmuar në këtë mënyrë se sa e kujdesshme është ndaj librit dhe pranimit të tij te qytetarët. Ky është një nga kontributet më të mëdha që ndërmerr Ministria e Kulturës dhe kalon përtej një kontributi të thjeshtë, duke shkuar te një nismë fisnike, atë të financimit të botimit dhe blerjen e librit.

Po me përhapjen e librit në Shqipëri?

Keçmezi-Basha: Ne shqiptarët, në histori, kemi qenë një kohë të gjatë të flijuarit më të mëdhenj në Evropë prej ndarjes absurde të kufijve. Një kohë të gjatë edhe librave u ndalej depërtimi më shumë sesa njerëzve prej njerit te tjetri kufi ku jetojnë shqiptarët. Sot Ministria e Kulturës ka misionin e vet të shenjtë që të na kompensojë kohën e humbur. Besoj se Ministria e Kulturës në këtë drejtim ka arritur rezultate të lakmueshme, megjithëse ka ende punë që duhet të rregullohen në mes dy ministrive.

Për fund, zonja Keçmezi-Basha, çfarë urimi keni për fundvit?

Keçmezi-Basha: Uroj që Ministria e Kulturës të investojë më shumë në libër, ta financojë sa më shumë botimin e librit, përkthimet cilësore dhe ta mbajë hapësirën kulturore të Kosovës të lidhur me hapësirën gjithëbotërore. Uroj që, ashtu siç ka qenë deri më tani, të jetë një shtëpi ku krijuesit kanë një mbështetje, me të cilën me dëshirë bashkohen për t'i botuar dorëshkrimet e veta. Uroj gjithçka që do të donte një krijues në veprimtarinë e vet e për të qenë gjithnjë në avangardë të botimeve shqiptare të realizuara e të propozuara nga Këshilli i Librit. Për të gjitha këto arsye, uroj Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që ta vazhdojë këtë ndërmarrje me sukses; ta vazhdojë veprimtarinë e saj që bazohet në financimin e botimeve dhe në shpërndarjen e librit në gjuhën shqipe dhe gjuhën e komuniteteve; që është jo vetëm një punë, jo vetëm një veprimtari botuese, por që është, njëkohësisht, një mision. Një mision kombëtar, kulturor, artistik dhe shkencor. Dhe, krejt në fund, inkurajoj komunitetin krijues, që në vitin 2020 të bëhet pjesë e këtyre financimeve të botimeve, si me financimin e revistave, librave dhe ofrimin e blerjeve të tyre. Ministria është e hapur për të gjithë dhe ju mirëpret në veprimtarinë e saj.



1

Autor: GAZMEND MORINA	BURGU KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA	ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER	BARI PATASH	KAMPIONE	KËNGËTARJA NË FOTO 2
PARADHËNIE					
VENDESI					
TAKON					
GURRA				ZANORE ARKËTARËT	
FUTBOLLISTI BALOTELLI					
ALUMIN			DY BASHKËTINGËLLORE NDERPRES		
AKTORJA KURTI					



2

EPOKA ERE	PJESË E SIPËRME KOSTUMIT, ME MËNGË E ME JAKË TË KTHYER	FUTBOLLISTI FETAHU (shq.)	AKTORJA E FAMSHME WILSON	NOTË MUZIKORE	KËNGËTARJA OKSA	ZANORE AKTORI MUÇAJ (shq.)	DITËRO AGOLLI ISH FUTBOLLISTI ALTIN	HIT NGA GRUPI "NRG BAND"	FUTBOLLISTI ITALIAN ALESANDRO	AMPER, TONI, ERBIUM	EPOKA ERE	ERMELINDA MEKSI	FLOTA DETARE	PËREMËR VETOR
FUTBOLLISTI NË FOTO 1 SHAQIRI						FUTBOLLISTI FRANCEZ DIARRA					SOLISTJA BYTYQI			
JONI ME NGARKESË NEGATIVE						FJALË E RËNDË DHE E PAHIJSHME BASKETBOLLISTI KURAJA					MUAJ I VITIT KËNGËTARJA VALENTINA			
NGJITËS I XHAMAVE				BAR PËR TË DALË JASHTË DIREK I ÇATISË				KËNGËTARI GJINOVCI			"ROMA" PËRFUNDIM NË SHAH			
PIKTORI VALLA					DHOMA E BURRAVE "URUGUAI"			BASHKËT. SHKRONJA XIX	LLOJ ANIJE E VOGËL (shq.) NDRERSHMËRI					ILION LIKA
TITAN			FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN BASHKËT.				ËMA KRYEHOXHA			HUQ, VES BASHKËT.				
ZANORE		KRYEQYTETI EVROPIAN I MODËS						DY BASHKËTINGËLLORE SHPIRTI (Lat.)		VDEKJEPRURËS				



3

EPOKA ERE	MARK ANTONI FUTBOLLISTI NË FOTO 3 ADNAN	ZANORE PAGJAKËSI
MUAJ I VITIT		
"ASHTU QOFTË" (fet.)		KËNGËTARJA NË FOTO 4
BEREQET		
ZANORE	AMERICAN MILITARY UNIVERSITY AKTORJA E FAMSHME MENDES	
ZAMBIA, ESTONIA		INDIUM KYÇ
ISH AKTORJA HOLLYVUDIANE GARDNER		ZANORE ISTRES
RILINDËSI VRETO		EPOKA ERE



4

KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!


BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqtë tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobalarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN

Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përftuar nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiency të energjisë.